

# Hyrje në përgatishmëri gjatë katastrofave



**Trajnim për përgatitshmëri gjatë katastrofave**



## Hyrje

Ky modul është një prej moduleve të cilat janë përgatitur nga ana e Njesisë për përgatitje gjatë katastrofave të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në Gjenevë. Ky modul mund të përdoret si studim i pavarur, si udhëzim i temës dhe për sigurimin e trajnimit për pjesëmarrës në seminare me temë përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave.

Qëllimi i këtij dokumenti është ta përdorin planifikuesit dhe profesionistët nga sfera e përgatitjes dhe veprimit gjatë katastrofave dhe situatave emergjente në Federatë dhe në shoqatat nacionale. Këto module gjithashtu mund të jenë interesante edhe për organizatat joqeveritare të interesuara për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave, për agjencitë qeveritare për menaxhim me situata në krizë, komisione lokale për përgatitje gjatë katastrofave dhe për njësitë për trajnim me temë mbrojtja civile.

Materiali mund të përdoret si:

- Material i përgjithshëm referent për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave
- Për trajnim të trajnuesve dhe për pjesëmarrësit në seminare me temë përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave.
- Si mjet për zbatimin e trajnimit orientues për delegatë dhe nëpunës për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave.
- Si udhëzim për vlerësim apo planifikim të aftësive për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave.

Ky material bazohet në qasjen për mësimin e rreziqeve dhe katastrofave të ndryshme, dhe para se gjithash ka për qëllim të zbatohet në fushën e përmirësimit të përgatitjes gjatë situatave të ndryshme të rrezikshme. Megjithatë, në çdo vend mund të ketë kontekste të ndryshme specifike prandaj pjesë të ndryshme të moduleve duhet të zbatohen sipas kontekstit specifik dhe situatës në situatën e dhënë.

Modulet dhe vërejtjet për trajnuesit janë të dedikuara që të përdoren gjatë zbatimit të trajnimeve dhe seminareve për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave po trajnuesit nxiten ta përdorin dhe adaptojnë materialin në pajtueshmëri me nevojat lokale në shtetet e tyre.

Nëntë modulet të cilat e përbëjnë këtë doracak janë:

1. Hyrje në përgatitjen gjatë katastrofave
2. Planifikim të aktiviteteve për përgatitje gjatë katastrofave
3. Ulje të rreziqeve
4. Ngritja e vetëdijes për katastrofat në bashkësi.

5. Vlerësim i nevojave emergjente gjatë katastrofave
6. Informim dhe lajmërim në katastrofa
7. Përmirësim të koordinimit
8. Përmirësim të aftësive elementare për trajnim
9. Planifikim të projekteve

## **Hyrje në përgatitje gjatë katastrofave**

### **Qëllimi dhe grupi qëllimor**

Ky modul paraqet pikën fillestare në bazë të asaj se si ti kuptojmë dhe diskutojmë katastrofat, menaxhimi me katastrofa dhe përgatitshmëria gjatë katastrofave si pjesë e misionit të shoqatave nacionale. Këtu gjithashtu diskutohet edhe vëllimi potencial i masave për përgatitshmëri gjatë katastrofave.

Ky modul është adekuat për secilin që ka përgjegjësi gjenerale lidhur me menaxhimin me katastrofa dhe implementimin programor. Personeli tjetër i cili është i interesuar për hasjen e aftësive dhe diturive shtesë në bazë të aktiviteteve për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave gjithashtu mund të ketë dobi nga ky dokument.

### **Aspekte kryesore**

- Përgatitshmëria dhe veprimi gjatë katastrofave në kuadër të aktiviteteve të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe shoqatave nacionale;
- Qëllimet e aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave;
- Definicione për terme siç janë rreziqet, katastrofat dhe mjerueshmëria;
- Identifikimi i llojeve të ndryshme të katastrofës;
- Vëllimi i masave për përgatitshmëri gjatë katastrofave;
- Koncepti i përgatitshmërisë gjatë katastrofave në nivel të bashkësive lokale.

### **Prezantim i përgjithshëm i përgatitjes gjatë katastrofave**

#### **1.1 Përgatitje gjatë katastrofave dhe Lëvizja e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe**

Qëllimi kryesor i punës së Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, në pajtueshmëri me atë që është theksuar në statutin dhe në parimin e humanitetit është që të ndalohet dhe ulet vuatje e njerëzve në të gjitha sferat e jetës, mbrojtja e jetës dhe shëndetit dhe respektimi i dinjitetit të njerëzve. Kjo është një prej përcaktimeve esenciale edhe në Strategjia 2020.

Shumë njerëz dhe agjenci marrin pjesë në operacione për përgjigje në situata emergjente nëpërmjet aktiviteteve në organizata lokale, mbrojtjen civile, agjenci për menaxhim me kriza, shoqata nacionale të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, organizata ndërkombëtare etj. Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe shoqatave nacionale janë të vetëdijshëm se përgatitshmëria gjatë katastrofave, posaçërisht përgjigja pasi të ndodhë katastrofa është përgjegjësi primare e qeverive por shoqatat nacionale, si zbatues të rolit ndihmës të pushteteve në shtet, gjithashtu mund të japin kontribut të rëndësishëm.

Për këtë, shoqatat nacionale duhet t'i komunikojnë dhe koordinojnë planet e tyre me planet e agjencive qeveritare dhe organizatat joqeveritare të kyçura në aktivitetet e planit të veprimit dhe përgjigjes gjatë katastrofave. Kjo do ta përmirësojë planifikimin, do ta ulë dyfishimin e orvatjeve dhe resurseve, do t'i bëjë planet më real dhe do ta rrisë efikasitetin e përgjithshëm të shoqatave nacionale në planin e zbatimit e aktiviteteve në fushën e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave.

## **1.2 Qëllimet e përgatitshmërisë gjatë katastrofave**

**Përgatitshmëria gjatë katastrofave** ka të bëjë me masat të cilat ndërmerren për uljen e efekteve nga katastrofat. Këtu nënkuptohet, parashikimi i tyre – kur ka mundësi, ndalim të katastrofave, dhe lehtësim të efekteve nga katastrofat e popullatës së mjeruar, dhe sigurim të përgjigjes efektive për menaxhim me pasojat nga katastrofat.

Përgatitshmëria gjatë katastrofave më së miri mund të përcjelllet nga perspektiva më e gjërë dhe në të më së miri është të shikohet si në qëllim, në vend të programit apo fazës së specializuar të udhëheqë në përgjigjen gjatë katastrofave.

Përgatitshmëria gjatë katastrofave është proces i vazhdueshëm dhe i integruar që rezulton me spektër të gjërë të aktiviteteve dhe resurseve dhe nuk është diçka e posaçme më vete. Përgatitshmëria gjatë katastrofave inkorporon spektër të trajnimeve dhe logjistikës, dhe aspekte lidhur me kujdesin shëndetësor dhe zhvillimin institucional. Shikuar nga kjo perspektivë më e gjërë, përgatitshmëria gjatë katastrofave ka për qëllim:

- Ta rrisë efikasitetin, efektivitetin dhe impaktin e mekanizmave për përgjigje urgjente gjatë katastrofave në bashkësi, në nivel nacional dhe ndërkombëtarë. Këtu nënkuptojmë:
  - Përgatitje dhe testim të rregullt të sistemeve për paralajmërim (lidhur me sistemet për meteorologji) dhe plane për avkuim apo masa tjera të cilat duhet të ndërmerren gjatë periudhës së paralajmërimit për katastrofë me qëllim që të minimalizohen humbjet potenciale të jetës dhe pasurive të njerëzve.
  - Edukim dhe trajnim të shërbimeve dhe popullatës së rrizikuar.

- Trajnim për ekipet nga ndihma e parë dhe ekipet për përgjigje gjatë katastrofave
  - Sjellje të politikave dhe standardeve për përgjigje gjatë katastrofave si dhe përgjigje organizative dhe plane operative të cilat duhet të përcillen pasi të ndodhë një katastrofë e caktuar.
- Përforsim i përgatitshmërisë gjatë katastrofave në bashkësitë lokale nëpërmjet programeve për zhvillim të shoqatës nacionale apo nëpërmjet përkrahjes së drejtpërdrejtë të aktiviteteve të bashkësive lokale. Kjo mund të jetë në formë të edukimit, përgatitjes dhe përkrahjes së popullatës lokale dhe bashkësive në orvatjet e tyre të përditshme për uljen e rreziqeve dhe përgatitje të mekanizmave të veta lokale për përgjigje për adresim të situatave emergjente gjatë katastrofave në rrethimin e tyre.
  - Përgatitje të aktiviteteve të cilat janë të dobishme për adresim të rreziqeve të përditshme me të cilat ballafaqohen bashkësitë dhe përgatitje të përgjigjes adekuate në katastrofa – për shembull, programe shëndetësore, programe për ndihmë të parë dhe programe sociale të cilat kanë komponenta të cilat janë të dobishme për uljen e pasojave dhe sigurim të përgjigjes efektive gjatë katastrofave.

## 2. Rreziqe, katastrofa dhe mjerueshmëri

Termet në vijim dhe definimi i tyre janë të rëndësishme që të kuptohet përgatitshmëria gjatë katastrofave.

**Katastrofa** është shkatërrim ekstrem i funksionimit të shoqërisë që shkakton humbje të mëdha njerëzore, materiale dhe pasoja për mjedisin jetësor të cilat i tejkalojnë kapacitetet e bashkësisë shoqërore të goditur që të ballafaqohet me ato me resurse personale. Ndodhitë siç janë tërmetet, vërshimet dhe ciklonet, vetë më vete nuk llogariten për katastrofa. Ato bëhen katastrofa kur pa dëshirë dhe seriozisht ndikojnë në jetën e njeriut, pasurinë dhe bagëtinë e tyre.

**Përgatitshmëria gjatë katastrofave**, ka për qëllim të bëjë përgatitje për menaxhim me katastrofat dhe uljen e këtyre efekteve të padëshirueshme.

**Rreziku**, nga ana tjetër, ka të bëjë me dukurinë potenciale, në periudhë të caktuar kohore dhe në fushë të caktuar gjeografike, në dukuri natyrore e cila mundet pa dëshirë të ndikojë në jetën e njerëzve, pasurinë apo aktivitetin në byzë të vëllimit që mund të shpie në katastrofë. Ndërsa rreziku (për shembull tërmeti, vërshimet apo cikloni) bëhet katastrofë nëse rezulton me lëndime, humbje të jetës së njerëzve, shpërngulje dhe humbje të shtëpive shkatërrim të infrastrukturës dhe pasurisë.

Cikloni i cili godet ishull të pa banuar nuk është katastrofë, megjithatë cikloni kategorizohet nëse për shembull e godet bregun e Banglladeshit dhe shkakton humbje të mëdha të jetës së njerëzve dhe dëm material.

**Mjerueshmëri strukturale dhe fizike** është shkalla deri në të cilën një strukturë e caktuar mund të dëmtohet apo shkatërrohet si rezultat i ndodhisë së caktuar të rrezikshme. Për shembull, shtëpi e caktuar me konstrukt të drurit me shtylla të mëdha të hekurta dhe shtrafa sigurie për ngjitje kah bazamenti dhe me themele solide më shumë besohet se do të dëmtohet më pak nga cikloni krahasuar me shtëpi të ngjajshme sipas formës e cila nuk ka siguri strukturale.

**Mjerueshmëria e njeriut** mund të definohet si mungesë relative e kapacitetit të personit apo bashkësisë që të parashikojë, të ballafaqohet, të ketë rrezistim dhe të rimëkëmbet nga ndikimi i rrezikut. Faktorët të cilët e rrisin mjerueshmërinë e njeriut të katastrofave janë urbanizimi i shpejtë, rritja e numrit të popullatës, mungesa e diturive për përgjigje efektive në efektet e katastrofës dhe varfëria. Të gjithë këto faktorë, e varfëria me siguri shkaku kryesor për mjerueshmërinë e njerëzve, kontribuojnë për rritjen e nivelit të mjerueshmërisë nga rreziku i caktuar.

Geohazards Interneshënell, organizatë joprofitabile e cila punon në planin e uljes së mortalitetit dhe lëndimeve të shkaktuara nga katastrofa në bashkësitë më të mjeruara në botë, ka llogaritur se në shekullin 20, katër nga 5 raste të vdekjes së shkaktuar nga tërmeti kanë ndodhur në vendet në zhvillim.

Tërmeti në Armeni në vitin 1988 dhe tërmeti në Lloma Prieta në Kaliforninë veriore në vitin 1989 nuk janë ekuivalent me magnitudën e tyre krahasuar me numrin e njerëzve në rajonet e goditura. Për shembull në Kaliforni numri i të vdekurve është 63 njerëz përderisa në Armeni numri i njerëzve të vdekur është 25.000. kjo mund të sqarohet me mjerueshmërinë e lartë strukturale dhe njerëzore në Armeni.

Burimi: *GHI internet faqja <http://www.eohaz.org/ginfo/atperil.htm>*

**Kapacitetet njerëzore** janë kualitetet dhe resurset të cilat mund t'i shfrytëzojnë apo përgatisin individët apo bashkësia për parashikim, menaxhim, mbrojtje dhe rimëkëmbje nga ndikimi i rrezikut të caktuar. Sipas Kornizës për planifikim të orientuar për njerëzit të përgatitur nga ana e UNHCR, kapacitetet njerëzore kyçin rurse materiale (p.sh. ushqim, kafshë, mjete financiare, mjete); kapacitete sociale dhe organizative (udhëheqësi, përvojë paraprake organizative, organizata qytetare dhe rrjete); ndërsa kapacitete lidhur me besimet dhe sjelljen (besim, motivim, vlera pune, ide, kreativitet, efikasitet) (Anerson 1994). Të gjithë njerëzit dhe bashkësitë kanë rurse dhe kapacitete dhe ato janë bazë për përgatitje dhe ulje të rreziqeve të cilat mund t'i përkrahin dhe mbindërtojnë shoqatat nacionale.

### 3. Klasifikimi i katastrofave

Ka mënyra të ndryshme për klasifikimin e katastrofave. Klasifikimet janë të rëndësishme për shkak se përgatitshmëria, përgjigja dhe masat për uljen e rreziqeve si dhe angazhimi special i agjencive varet nga lloji i katastrofës. Katastrofat shpesh herë klasifikohen sipas shkakut të tyre, dhe shpejtësisë së tyre të ndodhjes (menjëherë apo ngadalë) dhe varësisht nga fakti se a është nxitur katastrofa nga dukuria natyrore apo është nxitur nga njeriu – klasifikim i cili shpesh herë konbtestohet, për shkak se ekzistojnë qëndrime se në fakt aksionet dhe procedurat e njeriut iu paraprijnë (i inicojnë) katastrofat natyrore.

#### 3.1 Rreziqe të cilat nxisin katastrofa

Katastrofat e klasifikuara sipas shkakut emërtohen sipas rrezikut që rezulton me pasoja katastrofale sociale dhe ekonomike. Prandaj, në këtë klasifikim janë përmbajtur tërmete, vërshime, ciklone, tornado, rrëshqitje të dheut, vërshime me lloç, thatësira, shpërthime kimike etj.

#### 3.2 Shpejtësia e ndodhjes së katastrofës

Shpejtësia e ndodhjes së katastrofës është mënyrë tjetër që të bëhet dallimi mes llojit të katastrofave – si dhe lloji i përgjigjeve të cilat ndoshta do të jenë të nevojshme për menaxhim me situatat.

**Veprim i shpejtë në katastrofa** ka të bëjë me ndodhi apo rrezik që ndodh menjëherë, me shumë periudhë të shkurtë për paralajmërim, që rezulton me humbjen e jetës së njerëzve dhe shkatërrim të strukturave ekonomike dhe resurse materiale. Katastrofat të cilat ndodhin shpejtë mund të jenë të nxitura nga tërmeti, vërshimi, era, tornado apo rrjedhje e lloçit. Tërmetri i cili e goditi Turqinë në gusht në vitin 1999 është shembull për katastrofë të tillë.

#### Tërmet në Turqi

Në gjysmën e dytë të vitit 1999, dy tërmete të mëdha të cilat ndodhën në periudhë më të shkurtë se tre muaj e goditën Turqinë veri – perëndimore, fushë me popullsi më të dednuar dhe zonë industriale në vend. Tërmeti i parë ndodhi më 17 gusht të vitit 1999 në ora 03:02 sipas kohës lokale, me intensitet 7.4 dhe 7.8 shkallë sipas Rihterit dhe zgjati 45 sekonda. Izmiti, qytet industrial me një milion banorë në Turqinë perëndimore, ishte më afër epiqendrës.

Numri i njerëzve të cilët humbën jetën ishte mbi 17 100 dhe mbi 44.000 persona të lënduar, me mbi 300.000 shtëpi të shkatërruara apo të dëmtuara, dhe mbi 40.000 firma të goditura në mënyrë të njëjtë nga katastrofa. Në ditën e katastrofës, Qeveria e Turqisë shpalli gjendje emergjente dhe kërkoi ndihmën ndërkombëtare.

Pas katastrofës vijuan më shumë se 1.300 dridhje të vazhdueshme, me kulminim të situatës me dridhjen e dytë të madhe në ora 18:57 më 12 nëntor të



vitit 1999 me intensitet prej 7.2 shkallë sipas Rihterit që goditi pjesët e Duzce dhe Kajnasli në provincën Bollu veri – perëndimore, rreth 100 kilometra në lindje nga Izmiti. Dridhja u ndje edhe në Stamboll (260 kilometra në perëndim) dhe në Ankara, kryeqyteti i Turqisë, 300 kilometra në lindje. Sipas të dhënave të fundit së paku 845 persona humbën jetën pothuajse 5000 njerëz janë lënduar gjatë katastrofës.

*Burimi: Federta ndërkombëtare, Turqi: Tërmete, Raport për gjendjen nr. 37, 14 shkurt 2000.*

**Veprim i ngadalshëm në katastrofë** ka të bëjë me ngjarjen apo rrezikun i cili ngadalë e godet shoqërinë dhe kapacitetin e popullatës që të mbrohet nga efektet e rrezikut apo kërcënimit. Rreziqet të cilat i nxisin këto gjendje katastrofale mund të ejnë thatësira, uria, degradimi i mjedisit jetësor, prerja pa kontrollë e pyjeve dhe shtimi i dëmtuesve. Dukuria El Ninjo është shembull i katastrofës së tillë.

### **1997-1998 El Ninjo**

Dukuria klimatike El Ninjo e cila ndodhi në vitin 1997 – 1998 kishte efekte serioze në disa vende, para se gjithash ndikim të madh në Azi dhe në Amerikën qendrore / jugore që nga prilli i vitit 1997. Vërshimet goditën 41 vende, ndërsa 22 vende plotësuese u goditën nga thatësitat e dy vende nga zjarret në pyje. El Ninjo kishte pasoja të mëdha në prodhimtarinë e drithërave, në gjendjen e ushqimit, bagëtisë dhe peshkut, dhe pyje e e vegetacionin natyror në disa pjesë të botës, sipas z. Abdur Rashid. Shef i Sistemit informativ global dhe sistemit për paralajmërim të hershëm të FAO.

Përskaj humbjes së bagëtisë si rezultat i të rreshurave të mëdha të shiut dhe vërshimeve që rezultuan nga El Ninjo në Afrikën lindore, u krijuan edhe rrethana ideale për parqitjen sëmundjeve ngjësore të cilat goditën njerëzit dhe kafshët. Për shembull, Etnet e lëndinës Rift (në Kenia, Somali dhe Etiopi) rezultoi me numër të madh të rasteve të vdekjes dhe sëmundjeve.

Si rezultat i kësaj kemi pasoja serioze për peshkimin për shkak se El Ninjo shkaktoi dëme serioze në pjesët e peshkimit në perëndim të Afrikës jugore, që loogaritet si një ndër rajonet më të pasura me peshk në botë. Si rezultat i El Ninjo kishte kërcënim serioz nga zjarret në pyje dhe në vegetacionin natyror si rezultat i thatësirave në disa rajone.

*Burimi: Organizata për ueshqim dhe bujqësi (FAO), 31 korrik 1998.*

### **3.3 Vepër e natyrës apo vepër e njeriut**

Ndonjëherë katastrofat klasifikohen sipas faktit se a janë katastrofa “natyrore”, apo katastrofa “ të shkaktuara nga njeriu”. Për shembull, katastrofat e shkaktuara nga vërshimet, thatësitat, valët e larta nga batica apo dridhja e

tokës në mënyrë gjenerale llogariten për “katastrofa natyrore”. Katastrofat e shkaktuara nga fatkeqësitë kimike apo industriale, ndotja e mjedisit jetësor dhe trazirat politike klasifikohen si katastrofa “të shkaktuara nga njeriu” për shkak se ato janë pasojë e drejtpërdrejtë e aktiviteteve të njeriut.

Megjithatë, pikëpamjet më moderne dhe shoqërore në bazë të katastrofave llogariten se kategorizimi në këtë mënyrë është artificiale për shkak se shumica e katastrofave rezultojnë nga aktivitetet dhe veprimi i njerëzve dhe strukturave, politike, sociale dhe ekonomike. Me fjalë të tjera, njerëzit me vetëdije dhe pa menduar krijojnë kushte sociale, politike dhe ekonomike të cilat çojnë në katastrofa të caktuara.

Kjo ndodh si rezultat i mënyrës së jetesës së njerëzve që e degradon mjedisin jetësor, zhvelimin dhe mbipopullsimin në mjediset urbane, krijimin e sistemeve ekonomike. Politike dhe sociale të cilat çojnë në pabarazi në krahasim me qasjen në toka dhe resurse.

Bashkësitë dhe popullata janë të detyruara të shpërngulen në pjesë të nënshtruara në vërshime nga lumenjtë që i shpie në situatë të jenë shumë të mjeruar si rezultat i gjendjes së tyre ekonomike apo mungesës relative të fuqisë politike.

#### 4. Masa për përgatitje gjatë katastrofave

Përgatitshmëria gjatë katastrofave, siç u përmend, është koncept më i gjërë i cili përshkruan një komplet të masave për minimalizimin e efekteve të ndryshme të rreziqeve duke kështu humbjen e jetës dhe pasurisë apo shkatërrimin e bagëtisë. Përgatitshmëria gjatë katastrofave realizohet nëpërmjet masave për përgatitshmëri të cilat ndihmojnë dhe përkrahin përgjigjen në situatën emergjente, rehabilitimin dhe rimëkëmbjen, që pastaj rezultojnë në ndihmë të shpejtë, në kohë dhe të caktuar.

Përgatitshmëria gjatë katastrofave gjithashtu realizohet nëpërmjet qasjeve të ndryshme të cilat mbështeten në përkrahjen lokale dhe fokusin e bashkësive dhe aktiviteteve për mbindërtimin e kapaciteteve të njerëzve dhe bashkësive që të ballafaqohen dhe t'i minimalizojnë efektet nga katastrofa në bazë të jetës së njerëzve.

Për këtë duhet të vijmë në përfundim se strategjia e caktuar gjithëpërfshirëse për përgatitshmëri gjatë katastrofave duhet t'i përmbajë elementet si në vijim:

Vlerësimi i rreziqeve dhe mjerueshmërisë	Koordinim	Mobilizimi i resurseve
Mekanizma dhe strategji për përgjigje	Menaxhimi informativ	Trajnime dhe ushtrime për edukim dhe ngritje të vetëdijes publike
Plane për	Sisteme për paralajmërim	Përgatitje gjatë

përgatitshmëri	të hershëm	katastrofave të bazuar në bashkësitë lokale
----------------	------------	---

Elementi i fundit, “Përgatitshmëri gjatë katastrofave bazuar në bashkësitë lokale” nuk duhet të shihet si masë e cila është e ndryshe nga elementet tjera. Përkundrazi, përgatitshmëria gjatë katastrofave bazuar në bashkësitë lokale është proces i cili i përfshin të gjitha tetë elementet tjera në tabelë të integruara në strategjinë lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe uljen e rreziqeve. Në këtë pjesë do të diskutohen aspekte të tetë elementeve të para. Në pjesën 5 është paraqitur aspekti i logjikës së përgatitshmërisë gjatë katastrofave bazuar në bashkësitë lokale.

#### **4.1 Vlerësimi i rreziqeve dhe mjerueshmërisë**

Të gjitha planifikimet dhe implementimi i masave për përgatitshmëri gjatë katastrofave duhet të bazohen në vlerësim dhe në rreziqet me të cilat ballafaqohen njerëzit, si dhe aftësia e tyre që të ballafaqohen dhe të jenë rezistent në efektet e këtyre rreziqeve. Ky vlerësim duhet:

- T’i identifikojë karakteristikat, frekuencën dhe intensitetin potencial të rrezikut me të cilin ballafaqohet bashkësia;
- Të identifikojë pjesë të caktuara gjeografike dhe bashkësi të cilat janë të nënshtruara dhe të mjeruara në këto rreziqe;
- T’i identifikojë sektorët kryesorë të bashkësisë (popullata, infrastruktura, strehimi, shërbimet etj.) të cilët mund të goditen nga një lloj i caktuar i rrezikut dhe të parashikohet se në cilën mënyrë ato mund të goditen nga këto rreziqe;
- Ta vlerësojë aftësinë e sektorëve se sa mund të qëndrojnë dhe të ballafaqohen me efektet e këtyre dukurive të rrezikshme.

#### **4.2 Mekanizma dhe strategji për përgjigje**

Ekzistojnë shumë mekanizma dhe strategji për përgatitshmëri të cilat mund ta forcojnë efektivitetin e përgjigjes në përgjigjen emergjente. Ato mund të jenë si në vijim:

- Përgatitja e procedurave për evakuim (si dhe procedura për diseminimin e këtyre procedurave në opinion)
- Formimi i ekipeve për kërkim dhe shpëtim dhe veprim në rast të katastrofave (si dhe plane për zbatimin e trajnimeve për këta persona)
- Formimi i ekipeve për vlerësim (si dhe plane për zbatimin e trajnimeve për këta persona)
- Përgatitje të procesit të vlerësimit dhe prioriteteve informative për masa për përgjigje emergjente për aktivizimin e instalimeve të specializuara, siç janë për shembull siptalet mobile;
- Përgatitja e procedurave për aktivizimin e sistemeve distributive;

- Përgatitje të qendrave për praninë dhe strehimore për situata emergjente;
- Përgatitja e procedurave për aktivizimin e programeve emergjente në aeroporte, porte dhe transportin tokësor;
- Përgatitje për skladimin dhe menaxhimin e furnizimeve të shpejta të mallërave dhe pajisjeve për situata emergjente.

Moduli “planifikimi i përgatitshmërisë” i mbulon këto masa dhe ato të cilat vijojnë në më shumë detaje.

### **4.3 Planifikimi i përgatitshmërisë**

Koncepti i planifikimit të përgatitshmërisë është shumë i rëndësishëm për personat të cilët janë të kyçur në menaxhimin me katastrofa. Gjatë vetë krizës, gjithmonë ka nevojë për aksion të shpejtë dhe efektiv. Ky aksion shpesh herë varet nga fakti se a janë përgatitur dhe implementuar plane për përgatitshmëri.

Nëse nuk ndërmerret aksion adekuat apo nëse përgjigjja anulohet, mund të vije deri në humbjen e panevojshme të jetës së njerëzve. Në planin preliminar, edhe pse detajet për katastrofën janë mjaft të pasigurta, mund të identifikohen burime për ujë gjatë situatave emergjente, të përcaktohet sistemi komandues dhe procedurat komunikative, të trajnohet personeli për përgjigje gjatë katastrofave dhe të edukohen njerëzit se çka të bëjnë në rast të situatave emergjente.

Të gjitha këto masa japin kontribut për përmirësimin e kualitetit, efektivitetit dhe sigurimin e përgjigjes në kohë për katastrofën. Planifikimi i përgjigjes në katastrofë nënkupton identifikimin e resurseve organizative, vërtetimin e roleve dhe përgjegjësisë. Përgatitja e rreguloreve dhe procedurave dhe planifikimi i aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave dedikuar për sigurimin e përgatitshmërisë në kohë për katastrofën dhe përgjigje efektive në situatën emergjente.

Vetë vlersimi i planifikimit është preliminarë sipas natyrës së vet dhe është i pa sigurtë deri sa situata emergjente apo katastrofa me të vërtetë nuk ndodh. Qëllimi i planifikimit të aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave është që të identifikohen detyra dhe aktivitete specifike që të përfshihen pyetje e nevojshme organizative dhe teknike që të sigurohet sistemi për përgjigje të funksionojë me sukses në rast të katastrofës.

Qëllimi përfundimtarë nuk është që të shkruhet plan por të stimulohet interaksioni i përhershëm mes vepruesve përgjegjës, që më pas mund të rezultojë me përgjigje të shkruara, të dobishme. Plani i shkruar është instrument por jo edhe qëllim kryesor i procesit të planifikimit. Në Ankesin 2 është paraqitur shembull i plan programit për përgatitshmëri gjatë katastrofave.

#### 4.4 Koordinim

Planet e shoqatave nacionale në rrethana ideale do të duhej të jenë të koordinuara me planet dhe intencat e organizatave dhe agjencive tjera. Përgjigjja efektive në katastrofa obligon nevojë për kuptim dhe koordinim reciprok të përpjekjeve dhe resurseve mes më shumë agjencive dhe njerëzve të cilët janë të involvuar në përgjigjen e situatës emergjente – duke kyçur edhe popullatën e goditur dhe organizatat qytetare në bashkësitë lokale, mbrojtjen civile dhe strukturat qeveritare për situata emergjente, brigadën e zjarrfikëse, njësitë shëndetësore, shoqatat nacionale të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, agjencitë ndërkombëtare, organizatat joqeveritare etj.

Shpesh herë ndodh që agjenci dhe organizata tjera të kenë mandat të ngjajshëm me atë të shoqatës nacionale. Për shembull, edhe shoqata nacionale e Kryqit të kuq, dhe ndonjë organizatë fetare e ndonjë organizatë ndërkombëtare, mund të sigurojnë ndihmë të parë, strehim dhe ushqim për popullatën e goditur nga një katasrofë e caktuar. Në këtë rast, ka nevojë për koordinim të qartë të aktiviteteve me qëllim që të sigurohet përkrahje për numër maksimal të njerëzve në afat më të shkurtë kohor dhe me qëllim që të tejkalohet dyfishimi i panevojshëm i shërbimeve.

Nga një person nga secila agjenci duhet të ketë përgjegjësi për secilin aktivitet individual për marrjen e përgjegjësisë. Nëpërmjet koordinimit të drejtëpërdrejtë, agjencitë mundet qartë t'i ndajnë përgjegjësitë për operacione të ndryshme dhe në mënyrë adekuate t'i planifikojnë aktivitetet e veta.

Përfaqësues të agjencive të ndryshme të cilat punojnë në një sektor (sigurimi i përkrahjes shëndetësore, strehimit dhe ushqimit) mund të organizojnë nën – grupe dhe sisteme. Puna në fushën e planifikimit të përgatitjes gjatë katastrofave para se të ndodhë katastrofa iu ndihmon agjencive të kyçura që më mirë mes veti t'i kuptojnë qëllimet dhe kapacitetet e veta.

Dituritë e tilla dhe komunikimi rezultojnë me qasje më të koordinuar dhe punë, dhe ndihmon në tejkalimin e dyfishimit të ndihmës dhe identifikimin e mungesave dhe dobësive në sfera të ndryshme të veprimit gjatë operacionit të sigurimit të përgjigjes në situatë emergjente.

Memorandumet për bashkëpunim, politikat institucionale dhe planifikimi i përbashkët i orvatjeve për sigurimin e përgatitshmërisë gjatë katastrofave mund të shërbejë si bazë për koordinim më të mirë. Shoqatat nacionale duhet të jenë të njoftuara me legjislativën apo politikat nacionale me qëllim që të jenë të informuara për të drejtat, obligimet dhe raportet mes institucioneve publike dhe private dhe mundësinë për qasje në resurset qeveritare.

Përskaaj kyçjes në trupat nacional dhe local për menaxhim me kriza, shoqatat nacionale duhet vazhdimisht të punojnë në përparimin e raporteve dhe bashkëpunimin me ministritë dhe agjencitë adekuate qeveritare. (Shikoni në tekstin më poshtë).

## **Kryqi i kuq i Ugandës Koordinim me qeverinë**

Është shumë me rëndësi puna në planin për përgatitshmëri gjatë katastrofave të Kryqit të kuq të Ugandës të jetë në drejtim të sigurimit të përkrahjes së orvatjeve qeveritare (menaxhim me katastrofa). Kjo do të thotë se Kryqi i kuq i Ugandës patjetër duhet të zbatojë lidhje me institucionet adekuate me qëllim që të sigurohet puna që të jetë e koordinuar dhe të jetë në kornizë të planeve të qeverisë me qëllim që të mos dyfishohen orvatjet e institucioneve qeveritare.

Koordinimi do të zhvillohet nëpërmjet sekretarit gjeneral të Kryqit të kuq të Ugandës. Koordinimi ditor mund t'i delegohet udhëheqësit të programit për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave nëse ashtu mendon sekretari gjeneral. Kryqi i kuq i Ugandës ndërmerri iniciativë të caktojë mbledhje dy herë në vit me ministrinë e punës dhe politikës sociale, me organizatat joqeveritare dhe agjencitë tjera qeveritare të cilat janë aktive në fushën e përgatitjes dhe veprimit gjatë katastrofave.

*Burimi: Kryqi i kuq i Ugandës: Politika për përgatitshmëri gjatë katastrofave.*

### **4.5 Menaxhimi informativ**

Përgatitshmëria dhe përgjigjja gjatë katastrofave varen nga grumbullimi, analiza dhe veprimi në bazë të informacioneve të grumbulluara në kohë para katastrofave (informacione për rreziqe dhe paralajmërim të hershëm), gjatë katastrofave (vlerësimi i nevojave) edhe pas ndodhjes së katastrofave (rimëkëmbje nga katastrofat).

Për këtë qëllim është e nevojshme që shoqatat nacionale të vërtetojnë se cilat informacione u nevojiten, si do të grumbullohen, kush do t'i analizojë dhe si do të integrohen në procesin e sjelljes së vendimeve.

Përderisa shoqatat nacionale dëshirojnë të përgjigjen në kohë në katastrofë, nevojitet që të kenë të përgatitura procedura dhe mekanizma për marjen, analizimin dhe ërgjigje në informacione lidhur me paralajmërimin e hershëm me detektimin e rreziqeve, parashikim të alarmimit për rreziqe. (shiko pjesa 4.6 për sisteme për paralajmërim të hershëm).

Pasi të ndodhë katastrofa, shoqata nacionale patjetër të zbatojë vlerësim fillestar, që duhet të jetë në kohë me qëllim që të sigurohen informacione për institucionet të cilat sigurojnë përgjigje dhe përkrahje në bazë të nevojave esenciale të popullatës së goditur para se gjithash, që të shpëtohet jeta e njerëzve të popullatës më të rrezikuar nga katastrofa.

Vlerësimi i nevojave pas katastrofës duhet të sigurojë pasqyrë në bazë të asaj se ku janë njerëzit, në çfarë gjendje janë, çka bëjnë për momentin, cilat janë nevojat dhe resurset e tyre dhe cilat shërbime akoma janë të kapshme. Pas vlerësimit fillestar, duhet të ndërmerret vlerësim më i thellë për grumbullimin e

informacioneve plotësuese për sektorët kritik dhe fushat teknike të cilat janë me interes të posaçëm.

Dy modulet në këtë seri që kanë të bëjnë më shumë me informacionet për katasrtofat dhe vlerësimin dhe lajmërim janë: “Informacione për programin për katastrofa”, dhe “Vlerësimi i nevojave emergjente gjatë katastrofave”.

#### **4.6 Sisteme për paralajmërim të hershëm**

Qëllimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm është që të detektohen, parashikohen, dhe kur është patjetër, të jepen paralajmërimet lidhur me ndodhi të rrezikshme të cilat do të ndodhin drejtpërsëdrejti.

Megjithatë, me qëllim që të plotësohet funksioni për uljen e rreziqeve, nevojat për paralajmërim të hershëm duhet të përkrahen me informacione për rreziqet aktuale dhe potenciale të cilat i shpie rreziku, si dhe masat të cilat i ndërmarrin njerëzit për përgatitje dhe lehtësim të ndikimit të rrezikut.

Informacionet lidhur me paralajmërimin e hershëm duhet të komunikohen në mënyrë e cila ndihmon sjelljen e vendimeve dhe përgjigje në kohë të organizatave të cilat sigurojnë përgjigje në interes të popullatës së mjeruar (Maskri 1997).

Informacionet për paralajmërim të hershëm vijnë nga më shumë burime: p.sh. Zyra meteorologjike; Ministria e shëndetësisë (për shembull, paraqitja e sëmundjeve ngjitëse); Ministria e bujqësisë (p.sh. parashikime dhe informacione për bujqësinë); burime lokale informative; media dhe shërbimet për paralajmërim të hershëm të kapshme në internet.

Shpesh herë, ata të cilët duhet të kenë kujdes në shpalljet në kuadër të paralajmërimit të hershëm kanë shumë pak besim në paralajmërimet. Kjo ndoshta del si rezultat i tendencës së njerëzve të injorojnë punë të cilat për momentin iu duken të papranueshme, e deri në keqkuptime të përgjithshme lidhur me porositë e sistemit për paralajmërim apo frustracion si dyshim i alarmeve të gabueshme.

Kur përgatiten sisteme publike për paralajmërim të hershëm, planifikuesit patjetër duhet të llogarisin në perceptiionin e publikut në krahasim të paralajmërimeve, përvojave të tyre lidhur me reagimin e njerëzve në paralajmërimet në të kaluarën, dhe besime të përgjithshme tek opinioni si dhe qëndrime lidhur me katastrofat dhe paralajmërim të hershëm të opinionit.

#### **Paralajmërim për ciklonin, Andra Pradesh, Indi**

Agjencitë qeveritare ishin në gjendje të implementojnë program paraprakisht të instaluar për evakuimin e mbi 600.000 njerëzve nga rruga e ciklonit i cili duhej të arrijë për 40 orë. Kjo ishte e mundur si rezultat i parashikimeve



meteorologjike dhe paralajmërimeve të cilat ishin të komunikuar nëpërmjet kombinimit të kanaleve të përparuara dhe tradicionale, por njerëzit në pajtueshmëri me planin për përgatitshmëri gjatë katastrofës që prapakisht u trajnua në bashkësitë lokale.

Numri i njerëzve që humbën jetën ishte më i vogël për dhjetra persona nga më shumë se 10.000 njerëz të cilët humbën jetën në ciklon të ngjajshëm para 13 viteve. Atëherë në lokacionin e njejtë nuk kishte sistem për paralajmërim, komunikime, por as kapacitete për përgjigje gjatë katastrofës (Kombet e bashkuara, viti 1995).

Edhe pse qeveritë nacionale e bartin përgjegjësinë përfundimtare për krijimin e paralajmërimeve në kohë të opinionit, shoqatat nacionale mund të luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e përkrahjes në këtë plan. Shoqatat nacionale mund të ndihmojnë të ngritet vetëdija e popullatës për rreziqe ku janë të shfaqura bashkësitë dhe t'ju ndihmojë organizatave lokale dhe popullatës së mjeruar në bazë të interpretimit dhe kuptimit të informacioneve për paralajmërim dhe ndërmarrje të aktiviteteve adekuate dhe në kohë për minimalizimin e humbjeve dhe dëmeve.

Orvatjet e shoqatave nacionale për ndërtimin e këtyre kapaciteteve duhet t'i kompensojnë kapacitetet dhe njohuritë lidhur me paralajmërimin e hershëm për katastrofa dhe alarmim të popullatës.

Për shembull, në Shtator të vitit 1994, në Papua Guine e Re, në ishullin Britani e Re, liderët në bashkësi të cilët e kishin mbijetuar erupsionin vullkanik të vitit 1937, vërejtën dhe ndërmorrën aktivitete të cilët në një farë mënyre e luajtën rolin e paralajmërimit të hershëm për shkak se ishin të ngjajshme me ndodhitë të cilat ndodhën para erupsionit të vullkanit në vitin 1937.

Atë që ata e vërenë ishte: “toka dridheshte vertikalisht në vend se horizontalisht, zogjtë iknin nga strolat në fundin e vullkanit, qentë nuk ndaluan së lehuri dhe t'i marin erë tokës, ndërsa gjarpërinjtë e detit iknin nga uji”. Kjo përvojë, e kombinuar me aktivitetet e ngritjes së vetëdijes për rreziqe nga vullkani dhe trajnimet për evakuim të cilat zbatohen tani më një dekadë pa dyshim kontribuuan për numrin e vogël të njerëzve të cilët humbën jetën në Shtator të vitit 1994 (3000 njerëz humbën jetën gjatë evakuimit), kur vullkani përsëri eruptoi dhe shkaktoi dëme në qytet nga hiri i cili binte nga vullkani.

#### **4.7 Mobilizimi i resurseve**

Shoqatat nacionale duhet të përgatisin strategji, marrëveshje dhe procedura për mobilizimin e gondeve emergjente, mallërave dhe pajisjeve në rast të katastrofës. Në planin e përgatitshmërisë duhet të vërtetohen rregullat për sigurimin dhe disponimin me mjete financiare, përdorimin e pajisjeve dhe shërbimeve, dhe strategji për sigurimin e mjeteve financiare për veprim në rast të situatave emergjente.



Qysh para se të ndodhë katastrofa shoqatat nacionale duhet të kenë procedura për aktivizimin e procesit të dërgimit të apelit për kërkimin e përkrahjes financiare nga Qeveria dhe Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Apelet ndërkombëtare për ndihmë përgatiten nga ana e Federatës ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Ky lloj i apeleve përgatiten në pajtueshmëri me kushtet e theksuara në formatin për përgatitjen e apelit, i kapshëm në internet faqen e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në pjesën e apeleve për ndihmë emergjente.

#### **4.8 Edukimi i opinionit, trajnime dhe ushtrime**

Përgatitshmëria në rast të katastrofave patjetër të jetë e përkrahur nga fushata për ngritjen e vetëdijes, trajnime për ekipet për përgjigje gjatë katastrofave dhe trajnimeve të cilat do të ushtrohen skenare të ndryshme për përgjigje në situata emergjente. Pjesa esenciale e planit për përgatitshmëri gjatë katastrofave është edukimi i njerëzve jeta e së cilëve është nën kërcënim nga një katastrofë e caktuar. Edhe pse televizioni, radio dhe mediat e shtypit asnjëherë nuk mund t'i zëvendësojnë instruksionet e drejtpërdrejta, porositë e përgatitura mirë mund të paraqesin shtesë të dobishme në të gjithë procesin.

Gjatë përgatitjes së planit për përgatitshmëri është me rëndësi të trajnohen elementet kryesore. Trajnimet tregojnë mangësi të cilat në rrethana normale nuk mund të vërehen. Trajnimet janë më efektive kur janë sistematike dhe kur angazhohen një pjesë e madhe e veprimtarëve të cilët kanë obligime dhe përgjegjësi në planin e sigurimit të përgjigjes adekuate në katastrofë.

Trajnimet gjithashtu mundësojnë që planet të ripërtrihen, kur në periudha më të gjata nuk ka katastrofa të pranishme. Trajnimet mund të simulojnë operacione për kërkim dhe shpëtim, sigurimin e ndihmës së parë, vlerësim të nevojave, mbledhje koordinative mes organizatorëve kryesorë dhe liderëve në bashkësi, ushtrim të aktiviteteve transportuese dhe logjistike, dhe shumë aspekte tjera të sigurimit të përgjigjes emergjente në katastrofë.

#### **5. Përgatitshmëri gjatë katastrofave bazuar në bashkësitë lokale**

Përgatitshmëria dhe përgjigja gjatë katastrofave nuk janë vetëm punë të ekspertëve dhe personave përgjegjës të shoqatave nacionale dhe agjencive qeveritare për menaxhim me kriza. Vullnetarët lokal, qytetarët, organizatat dhe kompanitë kanë rol aktiv dhe të rëndësishëm para, gjatë dhe pasi të ndodhë situata emergjente dhe katastrofa. Prandaj, siç u tha më parë, përgatitshmëria gjatë katastrofave në bashkësitë lokale është proces i cili obligon përgatitje dhe implementim të strategjisë lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe uljen e rreziqeve.

Popullata lokale në pjesët e goditura nga katastrofat është e para e cila siguron përgjigje në katastrofë. Popullata zakonisht është e kyçur në aktivitetet për

kërkim dhe shpëtim si dhe sigurim të kujdesit emergjent dhe ndihmës humanitare për familjet, miqtë dhe fqinjët e tyre.

Shoqatat nacionale në partneritet me organizata dhe rrjete të bashkësisë, mund të luajë rol të rëndësishëm në përmirësimin e aftësive dhe diturive e këtyre personave “spontan” të cilët sigurojnë përgjigje në katastrofë nëpërmjet edijukimit të tyre dhe trajnim me teknikat elementare për shpëtim, ndihmë të parë, dhe masa tjera për përgatitje gjatë katastrofave. Dy shembujt në vijim e ilustronjë këtë koncept.

### **Partneritete lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave në Xhamajka**

Kryqi i kuq i Xhamajkës është involvuar në iniciativë të numrit sa më të madh të hoteleve dhe kompanive të sigurimit. Shoqata nacionale zbaton trajnime për të punësuarit në hotele, përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe veprim në rast të tërmeteve. Për kthim, hotelet sigurojnë donacione të njëjta si parapagesë javore për dhomë hoteli – në formë të donacionit në të holla për Kryqin e kuq.

Hoteli do të ketë dobi me atë që do të ulen premitë për sigurim për shkak se të punësuarit e tyre janë të trajnuar, dh në mënyrë teorike kompania e sigurimit do të ketë fitim, si rezultat i kërkesave më të vogla për kompensim të dëmit nga hoteli si rezultat i kësaj iniciative.

Burimi: “Mësim nga e kaluara”: raporti: Evaluime dhe revidim të planit për përgatitshmëri gjatë katastrofave përgatitur nga Xhon Miçell – njësia për përgatitshmëri gjatë katastrofave, Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Nëntor 1999.

### **Program për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësitë lokale, Bangladesh**

Në vitin 1996, Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit, bëri revizion në prioritetet organizative dhe solli përfundim se ka nevojë për organizatë nacionale të centralizuar që të rritet në organizatë proaktive për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave me kapacitete të fuqishme operative në nivel lokal. Për këtë qëllim, me përkrahjen e Kryqit të kuq të Gjermanisë, Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit implementoi program lokal për përgatitshmëri gjatë katastrofave që t’i mundësohet bashkësive lokale në fushat e larta të mjeruara që të ballafaqohen me ndikimin e cikloneve, me qëllim që të ulet humbja e jetës dhe pasurisë dhe të ulet vuajtja e njerëzve.

Nëpërmjet përdorimit të qasjes participative programi për përgatitshmëri gjatë katastrofave të Gjysmëhënës së kuqe të Bangladeshit formoi komitete të fshatit për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe zbatoi vlerësim participativ për nevojat në bashkëpunim me liderë të ndryshëm dhe persona tjerë profesional në Çdo

bashkësi. Aktivitetet programore të cilat ishin implementuar nga bashkësitë ishin:

- Mobilizimi dhe organizimi i bashkësisë
- Përgatitja e materialeve adekuate për diseminim dhe trajnim (postere dhe doracakë për trajnim) në bashkëpunim me bashkësinë.
- Fushatë për ngritjen e vetëdijes së opinionit me përdorimin e mediave audio – vizuale dhe të shtypit, si dhe komunikime personale
- Trajnim të popullatës për përgatitshmëri gjatë katastrofave, ndihmë të parë, sinjale për paralajmërim për ciklon.
- Edukim për përgatitshmëri gjatë katastrofave në nivel të familjes (përforcimi i shtëpive për rezistencë nga cikloni, instalimi i kapaciteteve për të pirë ujë, mbjellje të drunjve).
- Ndërtimi i strehimoreve për strehim nga cikloni dhe mirëmbajtja e tyre.
- Ngritja e vetëdijes në bashkësi dhe promovimi i mbrojtjes së popullatës më të mjeruar posaçërisht në bazë të mbrojtjes së fëmijëve, grave dhe personave të moshuar.

*Burimi: Raport i programit lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave, Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit, Kryqi i kuq i Gjermanisë*

## **6. Integrimi i përgatitshmërisë gjatë katastrofave me aktivitetet tjera të shoqatës nacionale**

Paraprakisht në këtë dokument u përmend se përgatitshmëria gjatë katastrofave është qëllim e jo program i specializuar. Prandaj, përgatitshmëria paraqet rezultat të shumë aktiviteteve të cilat implementohen në sektore të ndryshme duke kyçur përgjigjen në situata emergjente, kujdesin primar shëndetësor, zhvillimin instiucional, ndihmën e parë, dhe ndërtimin e kapaciteteve. Kjo do të thotë se përgatitshmëria gjatë katastrofave duhet të trajtohet si proces i vazhduar dhe i integruar në të cilin kyçen edhe komponenta zhvillimore dhe aktivitetet për sigurimin e ndihmës humanitare.

Për shkak se përgatitshmëria gjatë katastrofave varet nga qëllime dhe aktivitete të ndara në sektorë të ndryshëm, është shumë me rëndësi koncepti të jetë i integruar në të gjitha projektet vijuese. Në Afrikën lindore, për shembull, bëhen tentime të bëhet lidhja mes përgatitshmërisë gjatë katastrofave dhe programeve lokale nëpërmjet ndihmës së parë të bazuar në bashkësi. Në raste tjera përgatitshmëria gjatë katastrofave është e konceptualizuar në kuadër të kujdesit primar shëndetësor dhe iniciativave për sigurimin e përkrahjes nutritive.

Kjo siguroi lidhje të dobishme mes strukturave institucionale në nivel lokal dhe aktivitetet vijuese për sigurimin e shërbimeve. Ekipet e Kryqit të kuq të përbërë nga vullnetarë ishin mekanizmi kryesor për zbatimin e aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave në organizatat komunale.

## **Aneksi 1: Përgatitshmëri dhe planifikim për shoqata nacionale**

Është shumë me rëndësi të identifikohet niveli kyç, ku ndodh menaxhimi i përgatitshmërisë gjatë katastrofave. Përgatitshmëria dhe planifikimi efektiv në nivel lokal janë shumë të rëndësishme, por zhvillimi i përgjithshëm strategjik dhe menaxhimi sigurisht do të zhvillohen në nivel racional në vendet më të vogla dhe vendet me madhësi mesatare, përderisa në vendet më të mëdha kjo do të zhvillohet me siguri në nivel regjional apo provincial. Në këtë nivel do të sjellen vendimet, kontrolli, koordinimi dhe menaxhimi informativ.

Në nivel lokal

- Zbatimi i bazës informative nëpërmjet vërtetimit:
  1. Cilat rreziqe mund të godasin një pjesë të caktuar?
  2. Kush dhe çka do të shfaqen në rrezik si rezultat i situatës së dhënë?
  3. Cilat janë shkaqet kryesore për mjerueshmërinë e tyre nga rreziku i dhënë?
  4. Cilat resurse dhe kapacitete janë të kapshme për sigurimin e aktiviteteve efektive për përgjigje gjatë katastrofave?
- Identifikimi dhe implementimi i programeve për uljen e mjerueshmërisë dhe edukimi i opinionit dhe sigurimi i trajnimit nëpërmjet të punësuarve dhe vullnetarëve të shoqatës nacionale të cilët veprojnë në bashkëpunim të ngushtë me popullatën lokale të mjeruar në fushat e shfaqura në katastrofa.
- Vërtetimi i mënyrave për uljen e rreziqeve lidhur me rreziqet lokale. Shpesh herë kjo mund të jetë kombinim i metodave tradicionale dhe bashkëkohore.
- Njohja me mënyrën në të cilën popullata lokale angazhohet në përgatitshmëri gjatë katastrofave, e pastaj dizajnimi i mënyrave për përkrahjen e tyre në ato orvatje. Bëjeni të njëjtën në bazë të sigurimit të përgjigjes efikase.
- Mobilizimi dhe trajnimi i vullnetarëve për sigurimin e aktiviteteve efektive për përgjigje gjatë katastrofave.
- Planifikimi i furnizimit të shpejtë të ndihmës dhe pajisjeve për përdorim në situata emergjente. Theksimi dhe sigurimi i mallërave në depo. Sigurimi dhe vërtetimi i drejtimeve rrugore për shpërndarjen e ndihmës humanitare në pjesë të vështira për të kaluar.
- Zbatimi i komunikimit të sigurt dhe adekuat me pushtetet përgjegjëse lokale dhe organizatat lokale si dhe me qendrën e shoqatës nacionale. Këto linja komunikimi janë me rëndësi thelbësore për koordinim adekuat të aktiviteteve për përgjigje gjatë katastrofave.

## **Në nivel rajonal**

- Në vende të mëdha, niveli rajonal është lidhja kryesore mes nivelit lokal dhe qendrës së shoqatës nacionale. Për këtë është me rëndësi të zbatohet lidhje komunikimi mes nivelit lokal, rajonal dhe nacional që të sigurohet përgjigje efektive në katastrofa.
- Gjatë katastrofës, mund të ketë situatë kur përfaqësuesit e pushteteve në nivel rajonal dhe lokal patjetër duhet të veprojnë në mënyrë autonome/ në mënyrë të posaçme nga pushtetet nacionale. Prandaj pushtetet nacionale patjetër duhet të sjellin rregulla dhe procedura që kanë të bëjnë me kontrollin e aktiviteteve lidhur përgatitshmërinë dhe veprimin në rast të rrethanave të tilla.
- Ndihamat humanitare dhe pajisjet patjetër duhet të jenë të kapshme (apo duhet të ketë zbatuar sistem për furnizim të mallërave) në nivel rajonal me qëllim që të mundësohet shpërndarja e ndihmës së shpejtë në pjesë të largëta lokale.
- Duhet të ekzistojë plan rajonal për përgjigje gjatë katastrofave që i ka parasysh planet lokale komunale. Kjo do të mundësojë interaksion të mirë me pushtetet lokale dhe mundësi për përkrahje të institucioneve lokale në rast të katastrofave.
- Niveli rajonal gjithashtu duhet të ketë komunikim dhe koordinim të mirë me organizatat tjera rajonale. Kjo do ta ndihmojë koordinimin e aktiviteteve në rast të katastrofave.

## **Në nivel nacional**

- Shoqata nacionale duhet të përgatisë profil për katastrofa të mundshme në vend. Ky profil duhet të përmbajë listën e katastrofave të kaluara dhe të mundshme për vendin dhe t'i identifikojë rreziqet e mundshme, rreziqet e mundshme të cilat mund t'i nxisin, mjerueshmëri ekzistuese të njerëzve dhe bashkësitë të cilat mundësisht mund të jenë të goditura nga katastrofa dhe aftësitë për përgjigje gjatë katastrofave. Informacionet e tilla duhet të bazohen në të dhëna të grumbulluara nga burime të ndryshme duke kyçur të dhëna të grumbulluara në nivel lokal të shoqatës nacionale si dhe të dhëna nga organizata tjera lokale, institucione qeveritare, dhe institucione akademike në vend dhe rajon.
- Shoqata nacionale gjithashtu duhet t'i mer parasysh kërcënimet e mundshme nga vendet fqinje, siç janë epidemitë, insektet, degradimi i mjedisit jetësor, kontaminimi apo lëvizja e popullatës.
- Në bazë të informacioneve të fituara dhe në pajtueshmëri me rolin, shoqatat nacionale duhet të përgatisin programin e vet personal për përgatitshmëri gjatë katastrofave, që do të përmbajë masa për lehtësimin dhe uljen e rreziqeve dhe uljen e mjerueshmërisë së popullatës, si dhe vlerësim të kapacitetit të mjerueshmërisë së popullatës, si dhe vlerësim të kapacitetit të shoqatës nacionale të përgjigjet në katastrofa.

- Përgatitshmëria gjatë katastrofave patjetër duhet të përforcohet me shpërndarjen e informacioneve mes njësisive me role dhe qëllime të ngjashme në vend si dhe me organizata analoge në vendet fqinje.
- Përgatitshmëria gjatë katastrofave duhet të llogaritet si lidhje mes zhvillimit dhe sigurimit të përkrahjes humanitare dhe duhet të kyçet në programet tjera të shoqatës nacionale, siç është ndihma e parë, programi rinor dhe shërbimet shëndetësore, për shkak se përforcimi i strukturave dhe sistemeve ekzistuese është më efektiv se sa zbatimi i strukturave të reja. Kjo lidhje duhet të reflektohet në planin zhvillimor të shoqatës nacionale.
- Trajnimi i të punësuarve dhe vullnetarëve në nivel nacional dhe lokal duhet të llogaritet për prioritet. Organizatat komunale duhet të trajnohen për hasjen e aftësive i cili do t'ju ndihmojë të punojnë me popullatën lokale për mbulimin e situatave të mjeruara si dhe për përparimin e aftësive për përgjigje gjatë katastrofave.
- Kur ka mundësi, shoqatat nacionale duhet të kenë rezerva në mallëra dhe pajisje afër lokacioneve të cilat mund të jenë të goditura nga katastrofa (apo duhet të kenë zbatuar procedura për furnizim publik). Përskaj kësaj duhet të ekzistojë fond nacional për situata emergjente si dhe plan për mobilizimin e resurseve në këtë fond i cili duhet të funksionojë në bazë të përhershme.
- Aktivitete për mobilizimin e fondeve dhe formim të fondit emergjent për katastrofa duhet të organizohet në nivel nacional.
- Duhet të zbatohen procedura të sakta të cilat do t'i rregullojnë përgjegjësitë dhe sjelljen e vendimeve.
- Shoqata nacionale duhet të ketë marrëdhënie të mira me organizatat tjera të cilat punojnë në fushën e përgatitshmërisë dhe përgjigjes gjatë katastrofave në nivel nacional dhe ndërkombëtar.
- Plani medial gjithashtu luan vendim të rëndësishëm në situata emergjente. Shoqata nacionale duhet të emërojë person përgjegjës i cili do të sigurojë informacione për mediat nacionale dhe ndërkombëtare.
- Përgatitshmëria gjatë katastrofave duhet të trajnohet, mundësisht nëpërmjet trajnimeve dhe ushtrimeve simuluese.

### **Bashkëpunim në nivel ndërkombëtar**

Shoqata nacionale duhet të ketë raporte të mira me Federatën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe shoqata tjera nacionale në rajon. Shoqatat nacionale patjetër të jenë të gatshme të pranojnë ndihma ndërkombëtare në rast të katastrofave. Shoqatat nacionale kanë rol të rëndësishëm ta bartin porosinë tek popullata, mediat dhe qeveritë në vendet e tyre, për sigurimin e përkrahjes humanitare për vende tjera, posaçërisht për vendet fqinje, si përgjigje në katastrofa.

## Ankesi 2

### Shembull në planin e përgatitshmërisë gjatë katastrofave të shoqatës nacionale

Hyrje	Qëllimi i planit për përgatitshmëri gjatë katastrofave. Lidhje me plane tjera për përgatitje, organizim dhe zhvillim. Përshkrim i procesit të planifikimit dhe njerëzit / shërbimet të cilët do të jenë të kyçur.
Politikë për përgatitshmëri gjatë katastrofave të shoqatës nacionale	Shoqata nacionale duhet të miratojë politikë e cila e rregullon kornizën për veprim në planin e përgatitshmërisë gjatë katastrofave të shoqatës nacionale.
Roli dhe qëllimet e përgatitshmërisë gjatë katastrofave të shoqatës nacionale	Role dhe qëllime të përgjithshme të shoqatës nacionale në sferën e përgatitshmërisë gjatë katastrofave.
Qëllime	Lista e qëllimeve programore të cilat përshkruajnë se cilat janë pritjet dhe rezultatet të cilat duhet të realizohen në fushën e përgatitshmërisë gjatë katastrofave.
Profili i vendit në bazë të katastrofave: historia e katastrofave, llojet dhe efektet.	Përshkrimi i katastrofave të cilat përpunohen në planin, si dhe kthim i shkurtë në historinë e tyre dhe në pjesët gjeografike dhe popullatës të cilat janë më të mjeruara nga këto katastrofa.
Politika nacionale për menaxhim me katastrofa	Deklaratë e shkurtë e cila i sumon politikat dhe planet në fushën e menaxhimit të katastrofave në vend, dhe roli i shoqatës nacionale në kudër të politikës qeveritare apo planin për përgatitshmëri gjatë katastrofave.
Struktura për përgatitshmëri gjatë katastrofave të shoqatës nacionale.	Struktura e shoqatës nacionale dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq.
Ndarja rajonale dhe rolet në fushën e përgatitshmërisë gjatë katastrofave	Rolet dhe përgjegjësitë e zyreve rajonale për përgatitshmëri gjatë katastrofave
Koordinim me Federatën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe KNKK.	Marrëveshje për koordinim dhe komunikim me Federatën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe KNKK gjatë periudhave dhe situatave lidhur me veprim emergjent gjatë katastrofave.
Koordinim me qeverinë	Përshkrim i lidhjeve dhe marrëveshjeve koordinative me ministritë dhe njësitë qeveritare në periudhën para katastrofës, gjatë katastrofës dhe pasi të ndodhë katastrofa
Koordinim me organizata joqeveritare dhe ndërkombëtare	Koordinim dhe komunikim me organizata joqeveritare dhe ndërkombëtare në fushën e përgatitshmërisë dhe veprimin gjatë



	katastrofave.
Aktivizimi i sistemit për përgjigje gjatë katastrofave të shoqatës nacionale	Përshkrimi i procedurave për aktivizimin e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe në cilën mënyrë do të realizohet.
Aktivitete dhe resurse për përgjigje gjatë katastrofave të shoqatës nacionale.	Përshkrimi i llojeve të aktiviteteve për përgjigje gjatë katastrofave në të cilin do të kyçet shoqata nacionale dhe resurset dhe personeli me të cilin disponon.
Sistemi për paralajmërim të hershëm	Përshkrimi i llojit të sistemit për paralajmërim të hershëm dhe procedurat e shoqatë nacionale për aktivizimin e përgjigjes.
Vlerësimi i nevojave	Politika dhe procedura operative për zbatimin dhe lajmërimin e vlerësimeve të nevojave gjatë katastrofave.
Angazhimi dhe trajnimi i vullnetarëve	Përshkrim se si do të angazhohen dhe trajnohen të punësuarit dhe vullnetarët në fushën e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave.
Ngritja e vetëdijes së opinionit për katastrofa	Aktivitete dhe qëllime për ngritjen e vetëdijes së opinionit për rreziqet nga katastrofat të cilat do t'i zbatojë shoqata nacionale
Furnizim, renditje dhe shpërndarje të ndihmës humanitare	E përshkruan mënyrën në të cilën kryhet furnizimi, renditja dhe shpërndarja e ndihmës humanitare.
Aranzhmane financiare dhe procedura kontabiliste	I përshkruan procedurat dhe politikat lidhur me aranzhmanet financiare dhe procedurat kontabiliste në kohën gjatë katastrofave.
Donacione, apele ndërkombëtare	I përshkruan politikat dhe procedurat lidhur me pranimin e donacioneve, sigurimin e mjeteve financiare në shtet dhe dërgim të apleit.
Procedura për lajmërim	I përshkruan rregullat dhe procedurat për dërgimin e raporteve për operacione emergjente për ndihmë humanitare, në nivel të terrenit, nga depo, nga qendra dhe njoftim për donatorë lokal.
Punë me media	I përshkruan politikat, procedurat dhe personeli i cili do të punojë me mediat para, gjatë kohës dhe pas katastrofës.
Implementimi i planit dhe qëndrueshmëria	Përshkruan se në cilën mënyrë do të mobilizohen resurset, planet për trajnim dhe nushtrime për përgatitshmëri dhe procedura për revidim dhe ripërtirje të planit.
Përgatitshmëri gjatë katastrofave bazuar në bashkësitë lokale	I përshkruan politikat dhe qëllimet për përkrahjen e përgatitshmërisë gjatë katastrofave në nivel lokal.
Anekse	Harta, buxhete, resurse, mallëra, rezerva, pajisje.



## **Planifikimi i përgatitshmërisë gjatë katastrofave**

### **Qëllimi dhe grupi qëllimor**

Ky modul siguron kontrollimin e shkaqeve dhe parimeve për përgatitjen e planeve për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe diskuton elementet kryesore të cilat duhet të përfshihen me këto plane. Ky modul përshtatet në nevojat e delegatëve të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe personelit të shoqatave nacionale të cilat janë të interesuara dhe përgjegjëse për përgatitjen e planeve për veprim në rast të situatave emergjente dhe katastrofave të shoqatave nacionale.

### **Pika kryesore**

- Planifikimi si proces
- Komunikim dhe koordinim të planeve
- Elemente dhe prioritete në planin
- Aktivitete për implementimin e planit
- Shembull i planit për përgatitshmëri gjatë katastrofave të shoqatës nacionale
- Shembull i planit lokal për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave

#### **1. Kthim i shkurtë në procesin e planifikimit të aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave**

Planifikimi i procesit për përgatitshmëri gjatë katastrofave nënkupton identifikimin e resurseve organizative, vërtetimin e roleve dhe përgjegjësive, përgatitje të politikave dhe procedurave dhe planifikim të aktiviteteve me qëllim të arrihet nivel i caktuar i përgatitshmërisë që të sigurohet përgjigje në kohë dhe efikase në katastrofë të mundshme. Prosesi i planifikimit është preliminar sipas natyrës dhe bëhet në kushte kur gjërat akoma nuk janë të qarta gjegjësisht para ndodhjes së situatës emergjente apo katastrofës. Pasi të ndodhë katastrofa, plani patjetër duhet të adaptohet në pajtueshmëri me situatën aktuale.

Informacionet të cilat ofrohen në këtë modul duhet të shërbejnë si udhëzim në vend të diçkaje që përfundimisht duhet të bëhet patjetër me qëllim që të sigurohet planifikim i mirë i aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave. Prioritetet në plan janë të ndryshme varësisht nga organizimi specifik dhe niveli organizativ në të cilin përgatitet plani.

Plani për përgatitshmëri më së mirë është të përgatiet në konsultim dhe bashkëpunim me ato që do ta implementojnë apo lejojnë. Shoqatat nacionale duhet të kenë nivele të caktuara të përgatitjes me nivel adekuat të planifikimit.

Agjencitë me resurse të ndryshme mund të zgjedhin se si do të jetë planifikimi varësisht nga nevojat e tyre. Në nivel komunal, Kryqi i kuq mund të luajë rol të dobishëm në sigurimin e përkrahjes për organizimin e komiteteve për

përgatitshmëri gjatë katastrofave të cilat do të jenë përgjegjëse për përgatitjen e planeve lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave.

Anekset në këtë modul paraqesin shembuj të planeve lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave të cilat mund të modifikohen me qëllim që të përdoren në nivel nacional dhe lokal si dhe mjete të cilat mund të përdoren gjatë përgatitjes së planit.

## **2. Nevojë për procesin e planifikimit të përgatitjes gjatë katastrofave**

Koncepti i planifikimit të përgatitshmërisë është shumë me rëndësi për personat të cilët janë të kyçur në menaxhimin me katastrofa. Gjatë situatës emergjente, nevojitet aksion i shpejtë dhe efektiv. Megjithatë, ky aksion shpesh herë varet nga fakti se a ka përgatitur plane adekuate para se të ndodhë katastrofa. Nëse nuk ka ndër marrë aktivitete adekuate apo nëse përgjigjja në katastrofa prolongohet, pa nevojë do të humben shumë jetë.

Në planin preliminar edhe pse detajet për katastrofën ngelen të pa qarta, mund të identifikoni lokacione për strehimin e popullatës, të përgatitet plan me rrugë për evakuim i cili do të diseminohet në opinion, të identifikohen burime të ujit në rast të situatës emergjente, të vërtetohet sistemi i komandës dhe procedurave të komunikimit, të sigurohet trajnim i personelit dhe të edukohen njerëzit se çka duhet të bëjnë në rast të situatës emergjente. Të gjithë këto masa kontribuojnë për përmirësimin e kualitetit, dhe përgjigjes në kohë dhe efikase në katastrofa.

Planifikimi i aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave është më e vështirë se sa planifikimi i operacionit emergjent për përgjigje në katastrofa e cila tani më ka ndodhur. Vështirësitë janë:

- Rrefuzim ndaj planifikimit për shkak se e kthen vëmendjen dhe i merr resurset nga puna vijuese që të planifikohet ngjarja e cila ndoshta nuk do të ndodhë.
- Shtypja politike e personave të cilët sjellin vendime të mos adresojnë apo njohin ekzistimin e skenareve të ndryshme për katastrofën.

Rrefuzimi i tillë mund të tejkalohet nëpërmjet promovimit të rëndësisë dhe zbatimit të procesit të planifikimit për përgatitshmëri gjatë katastrofave si proces vijues i vazhdueshëm, bile edhe në kohën kur situatat janë relativisht normale.

Mënyra më e mirë për promovimin e përgatitshmërisë apo revidimit të planit të tillë është që pas ndodhjes së katastrofës së madhe në vend apo në pjesë tjetër të botës ku përgjigja do të ishte e dobët apo jo efektiv që ka rezultuar me numër të madh të rasteve me vdekje dhe vuajtje të cilat nuk kanë pasur nevojë të ndodhin – nëse ka pasur aktivitete adekuate për përgatitshmëri.

### **3. Procesi i planifikimit**

Planifikimi i aktiviteteve për situata emergjente është proces. Kjo nuk është diçka që bëhet vetëm një herë. Edhe pse në plan theksohen qëllime dhe aktivitete specifike për përgatitshmëri, ato duhet të korigjohen dhe përparohen gjatë situatës emergjente.

Planifikimi mund të jetë jo efektiv nëse të gjitha palët e interesuara nuk janë të kyçur në proces. Ata të cilët janë të obliguar për implementimin e aktiviteteve për përgatitshmëri dhe verpim emergjent më mirë do t'i respektojnë procedurat përdorura pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre janë të inkuorporuara në procesin e planifikimit.

Përvojat tregojnë se planet të cilat janë të krijuara nga personi i jashtëm apo individ i izoluar apo agjencioni zakonisht nuk kanë vlerë dhe nuk përdoren. Prandaj është duhet qasje ekipore. Qasja ekipore mundëson shqyrtimin e pikëpamjeve të ndryshme të cilat ndahen gjatë fazës planifikuese.

### **4. Komunikim dhe koordinim të planeve**

Në procesin e formulimit dhe ripërtirjes së qëllimeve specifike, shoqatat nacionale duhet t'i komunikojnë dhe koordinojnë planet e tyre me atë të agjencive qeveritare dhe organizatave joqeveritare të kyçur në sigurimin e përgjigjes gjatë katastrofave. Në këtë mënyrë planifikimi do të përmirësohet, do të ulët dyfishimi i mundimeve, planet do të jenë më reale dhe do të rritet efikasiteti i përgjithshëm i përgjigjes gjatë katastrofave.

Nëpërmjet korrordinimit të drejtpërdrejtë, agjencitë qartë mund t'i ndajnë përgjegjësitë për operacione të ndryshme dhe në mënyrë adekuate t'i planifikojnë aktivitetet e tyre. Ngjajshëm me këtë përfaqësuesit e agjencioneve të ndryshme të cilat punojnë në fushë të njëjtë (për shembull: shëndetësia, strehimore dhe shpërndarja e ushqimit), mund të organizojnë nëngrupe për planifikim. Përgatitja e përbashkët dhe ripërtirja e planeve për përgatitshmëri mund të shërbejnë si bazë për koordinim mes agjencive.

Përskaj Kyrqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, agjencitë të cilat mund të jenë të kyçur në operacione për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave janë:

- Ministritë dhe agjencitë për menaxhim me kriza dhe mbrojtje civile
- Shërbimet zjarrfikëse
- Shërbimet shëndetësore, ministritë apo agjencitë
- Policia
- Agjencitë ndërkombëtare (për katastrofa më të mëdhaja)
- Pushtete lokale dhe popullata e goditur

Në kuadër të shoqatës nacionale, është shumë me rëndësi që shoqata nacionale dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq të kenë bërë shpërndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësive në planin e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katstrofave me mekanizëm të zbatuar komunikativ dhe koordinues në nivele të ndryshme.

Plani mund të jetë dokument i gjallë dhe planifikuesit duhet të nxisin revidimin e tij të sërishëm, kritika dhe diskutime me qëllim që të përtrihet në bazë të rregullt. Plani duhet të diseminohet gjërësisht dhe të komunikohet tek anëtarët e këshillit ekzekutiv, bashkëpunëtorët profesional dhe njësi në qendër, organizatat komunale të KK, vullnetarët dhe agjencitë apo organizatat relevante të jashtme. Plani i cili do të mbetet i shkruar dhe do të qëndrojë në ormanë është plan i cili më mirë do të ishte të mos jetë i shkruar.

## **5. Elementet e planit**

### **5.1 Menaxhimi, organizimi dhe koordinimi**

Shumë agjenci marrin pjesë në operacione gjatë situatave emergjente: mbrojtja civile, menaxhimi me kriza, shërbimet zjarrfikëse, shoqata e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe, agjencitë ndërkombëtare etj. Ka mundësi që disa agjenci të kryejnë detyrën e njëjtë. Për shembull Kryqi i kuq, organizata fetare dhe organizata ndërkombëtare, të gjithë mund të sigurojnë ndihmën e parë apo aktivitete për strehimin e popullatës apo sigurimin e ushqimit. Në këtë rast nevojitet koordinim i qartë që të sigurohet se do të përfshihen dhe ndihmohen numër maksimal i njerëzve në periudhë sa më të shkrutë që mundet dhe që të tejkalohet dyfishimi i panevojshëm i shërbimeve.

Plani për përgatitshmëri duhet të përmbajë emra, përgjegjësi gjatë situatës emergjente, dhe numra e adresa për kontakt të personave përgjegjës për koordinimin e përgjigjes gjatë situatës emergjente, si dhe të anëtarëve të ekipeve në çdo nivel operativ dhe njerëzve përgjegjës për:

- Aktivizimin e shërbimeve për përgjigje
- Komunikime me qendrën
- Menaxhim të bashkëpunimit të jashtëm dhe apeleve për ndihmë nga burime tjera, duke kyçur fondet qeveritare, ndërkombëtare dhe publike
- Komunikim me media, koordinim dhe raporte me agjenci dhe shërbime tjera
- Menaxhim të punës administrative

Kur përgatitet plan për përgatitshmëri gjatë katastrofave secili agjencion duhet të identifikojë aktivitete të cilat do të nënshtrohen nën përgjegjësinë e tyre si niveli i paraparë i kyçjes në ngjarje gjatë situatës emergjente. Agjencioni gjithashtu duhet të vërtetojë se kush është përgjegjës për secilin funksion në kuadër të agjencionit.

Nëse 2 grupe kryejnë funksione të ngjajshme është me rëndësi të sqarohet roli i tyre që të mos dyfishohen mundimet. Për shembull, shërbimi zjarrfikës dhe mbrojtja civile janë përgjegjës për operacione për kërkim dhe shpëtim, përderisa, Kryqi i kuq kryen rol ndihmës. Aneks 3 i paraqet rolet dhe përgjegjësitë organizative. Në diagramin tuaj mund t'i kyçni entitetet në vijim:

- Mbrojtja civile dhe strukturat për menaxhim me kriza
- Shërbimi zjarrfikës
- Sektori shëndetësor
- Policia
- Kryqi i kuq
- Agjencitë publike
- Popullata lokale

## **5.2 Vlerësimi i nevojave të mundshme**

Aspekti tjetër i planifikimit për përgatitshmëri është planifikimi i nevojave të mundshme gjatë situatës emergjente. Në bazë të katastrofave të mëparshme, planifikuesit duhet të përpilojnë listën e nevojave të mundshme dhe resurseve të kapshme. Nëse planifikuesit parashohin zbrazëtitë të caktuar në bazë të nevojave dhe resurseve të kapshme, paraprakisht duhet të parashikojnë mënyra se si të kompensohet kjo.

## **5.3 Aktivizimi i sistemit për notifikimin e popullatës për situatë emergjente dhe sistemit për përgjigje gjatë katastrofave**

Plani duhet të definojë mënyra për sigurimin e sistemit për paralajmërimin e popullatës dhe për njerëzit të cilët janë përgjegjës për këtë funksion. Agjencitë duhet të identifikojnë bashkëpunëtorë profesional (të mos jetë bashkëpunëtori profesional për informim) i cili do të jetë përgjegjës për këmbimin e informacioneve me mediat. Personi duhet të ketë përvojë dhe të ketë kontakte të mira me qeverinë, sektorin korporativ dhe rrethin shoqëror. Bashkëpunëtori profesional për informim duhet të sigurojë sqarim se cilat persona e kanë të lejuar t'i komunikojnë të dhënat përsituatat emergjente me mediat.

Anëtarët tjerë të ekipit për përgjigje, për të gjitha çështjet tjera lidhur me komunikime dhe marrëdhënie me publikun, të interesuarit duhet t'i drejtojnë deri te ky bashkëpunëtor profesional.

Përskaj sigurimit të lajmërimit të opinionit për katastrofën e drejtpërdrejtë, patjetër të ekzistojë edhe sistem për iniciimin e përgjigjes gjatë katastrofave në rast të situatës emergjente. Kush dhe si përcillet dhe komunikohen porosi në bazë të lajmërimit të hershëm?

Plani gjithashtu duhet të sigurojë mënyra për kyçjen e vullnetarëve dhe të punësuarve në operacion. Nëse agjencioni juaj është agjenci udhëheqës, plani

duhet të përmbajë udhëzime se cilat struktura do të jenë të lajmëruara dhe kush është përgjegjës për komunikime në rast të situatës emergjente.

#### **5.4 Vlerësimi i nevojave gjatë situatës emergjente**

Është e pamundur të ketë operacione efektive për përgjigje pa vlerësim të saktë të situatës emergjente apo të katastrofës si dhe pa evaluim themelor të ndihmës së nevojshme humanitare dhe tjetër ndihme. Që të jetë efektiv vlerësimi para se të zbatohet duhet të planifikohet dhe organizohet mirë. Në të shumtën e rasteve vlerësimi i nevojave duhet të zbatohet menjëherë pasi të ndodhë situata emergjente dhe pastaj informacionet duhet vazhdimisht të azhurohen. Në rrethana normale njerëzit të cilët i vlerësojnë nevojat dhe dëmet emergjente duhet të kenë kaluar trajnim adekuat dhe të jenë të përshtatshëm në bazë të standardeve të cilat do t'i përdorin. (Për më shumë informacione në këtë temë shikoni modulën “Vlerësimi i nevojave gjatë situatave emergjente dhe katastrofave”).

Kur planifikoni vlerësimin e nevojave emergjente, vërtetoni këtë në vijim:

- Kush dhe kur (shembull: menjëherë, pas 3 ditëve, pas 2 javësh etj.) është përgjegjës për vlerësimin. Normalisht vlerësimi duhet të zbatohet nga më shumë ekipe funksionale dhe sektore.
- Cilat informacione janë të nevojshme në secilën fazë të situatës emergjente.
- Si dhe ku do të formohen dhe trajnohen ekipet për vëzhgim
- Cilat standarde përdoren për vërtetimin e seriozitetit të situatës emergjente

Standarde humanitare minimale për përgjigje gjatë katastrofave të definuara në Projektin Sfera mund t’ju ndihmojnë në prioritetizimin e grumbullimit të informacioneve në bazë të vërtetimit të nevojave dhe planifikimit të përgjigjes adekuate. Projekti Sfera nënkupton sistematizimin e informacioneve në sektorët në vijim:

- Furnizim me ujë dhe kanalizim
- Të ushqyerit
- Ndihmë në ushqim
- Strehim dhe planifikim të lokacioneve për strehim
- Shërbime shëndetësore

#### **5.5 Mobilizimi dhe alokacioni i resurseve**

Që të përgjigjet në situatën emergjente dhe të implementohet plani për përgatitshmëri, nevojiten resurse. Prandaj plani për përgatitshmëri duhet t’i përpunojë elementet në vijim:

- Cilat resurse tani më janë të kapshme dhe në çfarë sasive?
- Cilët të punësuar dhe vullnetarë mund të merren nga programe tjera gjatë situatës emergjente?
- Cilat resurse do të jenë të nevojshme, e që nuk i kemi?
- Plani për furnizim të resurseve të cilat nuk janë të kapshme për momentin

## **5.6 Komunikim mes agjencive**

Shpërndarja dhe këmbimi i informacioneve mes përfaqësuesve të agjencive të ndryshme është me rëndësi esenciale gjatë situatave emergjente. Që të sigurohen komunikime të qarta dhe efektive në situatë të caktuar emergjente, plani duhet të definohet se si do të zhvillohen komunikimet dhe nëpërmjet cilave media (për shembull: e-mail, radio, telefon, personalisht etj.).

Nëse përdoren radio komunikimet, me rëndësi është që të përcaktohet radio frekuenca në planin për përgatitshmëri. Kjo do të mundësojë që agjencitë të cilat sigurojnë përgjigje të përdorin radio frekuenca të sakta në rast të situatës emergjente. Plani gjithashtu duhet të prezantojë se kush do ta ketë dhe mirëmbajë pajisjen dhe kush do të ketë qasje në radio sistemin.

## **5.7 Komponente të sektoreve**

### **5.7.1 Shpëtim dhe ndihma mjekësore për popullatën e goditur**

Situatat emergjente dhe katastrofat më të mëdhaja shpesh herë rezultojnë me raste të vdekjes dhe lëndime të njerëzve. Plani për përgatitshmëri gjatë katastrofave duhet të definojë:

- Kush do të jetë përgjegjës për organizimin e operacioneve për kërkimin dhe shpëtimin e njerëzve?
- Si do të veprohet me trupat e njerëzve që kanë humbur jetën?
- Kush do të sigurojë ndihmë të parë?
- Cilat sisteme do të përdoren për shpërndarje dhe regjistrim?
- Kush do të jetë përgjegjës për evakuimin mjekësor dhe hospitalizimin?

### **5.7.2 Ujë dhe kanalizim**

Shpesh herë gjatë situatave emergjente, ka mungesë të ujit të pijshëm, që mund të shkaktojë probleme serioze shëndetësore. Për shkak se njerëzit mund të jetojnë pa ushqim më gjatë se sa pa ujë, sigurimi i ujit të pastër për pije paraqet një ndër gjërat më primare gjatë situatës emergjente. Sanitacioni nënkupton sigurimin e ujit të sigurt, mënjanimin e fekaleve të njerëzve, veprim me ujë të sigurt, mënjanim të ujit të papastër dhe mbeturinave, kontrollim të insekteve dhe dëmtuesve, veprim me ushqim të sigurt dhe sigurim të kanalizimit



në lokacion. Plani gjithashtu duhet të përmbajë dispozita për ujë dhe sanitacion gjatë situatës emergjente.

Për ujë duhet të theksohen gjërat në vijim:

- Rregullore për shfrytëzimin e resurseve të ujit. Cilat kapacitete infrastrukturore dhe teknike ekzistojnë? Kush është përgjegjës për sistemin e ujësjellësit?
- A është instaluar sistemi për furnizim me ujë?
- Masa të cilat duhet të ndërmerren në dimër, në verë apo në rast të kontaminimit të ujit.
- Pajisja e cila nevojitet dhe a janë të nevojshme rezervoare për ujë (në rast se nuk ekzistojnë burime për ujë për sanitacion).

Për sanitacion duhet të theksohen gjërat në vijim:

- Kush është përgjegjës (institucioni publik apo sektori privat)?
- A ka nevojë që të zbatohet program për trajnim për sanitacion?
- Niveli i planifikimit për aktivitete të sanitacionit

### **5.7.3 Ushqim dhe të ushqyerit**

Sigurimi i ushqimit ka për qëllim t'i kënaqë nevojat e popullatës së goditur gjatë situatës emergjente. Plani për përgatitshmëri duhet të definojë, llogaritë dhe vërtetojë se në cilën mënyrë do të sigurohet ushqimi gjatë situatave emergjente me intensitet të ndryshëm dhe me ndikim të ndryshëm. Gjatë fazës së përgatitshmërisë, duhet të jepet përgjigje në pyetjet në vijim:

- Kush është përgjegjës për vlerësimin e nevojave për ushqim dhe koordinimin e këtij elementi në kuadër të operacionit për sigurimin e përgjigjes në situatë emergjente?
- Cili ushqim është i kapshëm në nivel lokal, në rajon, dhe në vend? Cilat janë kapacitetet dhe çmimet në tregjet lokale?
- Cili ushqim në mënyrë tradicionale është i pranueshëm dhe që e përdor popullata e cila ka mundësi të jetë e goditur nga situata emergjente?
- Prej çka duhet të përbëhet shporta me ushqim?
- Cilat norma kalorike janë të nevojshme në mjedise të ndryshme klimatike (për shembull: në mjedise të ftohta malore)?
- Cilat janë nevojat elementare për fëmijët e vegjël?
- Cilat sisteme për shpërndarjen e ushqimit përdoren në atë rajon, vend? Si mund ato të përdoren në rast të situatës emergjente?
- Popullata e cila gjendet afër lokacionit ku ka ndodhur situata emergjente a do të ndihmohet me ushqim? Kjo pyetje paraqitet kur popullata që nuk



është e goditur gjithashtu është e shfaqur dhe e mjeruar, bile edhe në rrethana normale).

- Kush është përgjegjës për komunikime me donatorët për ushqim qeveritar dhe ndërkombëtar (për shembull: Programi Botëror për Ushqim), organizatat joqeveritare dhe asgjenci tjera?
- Si janë normat për renditjen e ushqimit? Çfarë kapacitete për renditje janë të kapshme?

#### **5.7.4 Logjistikë dhe transport**

Operacionet për sigurimin e përgjigjes gjatë situatave emergjente obligojnë edhe transportin e ndihmës humanitare, personelit dhe pajisjes në vendin e katastrofës. Prandaj çështjet për logjistikë dhe transport janë të rëndësishme për sigurimin e përgjigjes së suksesshme. Aspektet në vijim për logjistikë dhe transport duhet të merren parasysh gjatë procesit të planifikimit.

- Definimi i rrugëve normale për dërgimin e ndihmës së rajoneve të parashikuara të goditura nga katastrofa dhe popullata e goditur.
- Vërtetimi i porteve dhe aerodromeve të cilat do të shfrytëzohen
- Vërtetimi i vendeve për skladim
- Specifikimi i mënyrës së transportit (rrugë tokësore, hekurudhë, komunikacion ajror) dhe çështje siç janë qasja e tyre dhe çmimi.
- Vërtetim se sa ka karburant dhe garazhe. A ka kufizime të caktuara?
- Definimi i bashkëpunimit të zbatuar me shërbime qeveritare dhe ministri përgjegjëse për procedura doganore; Arritja e marrëveshjes me struktura adekuate qeveritare për sigurimin e kushteve për importin e ndihmës humanitare.
- Përgatitja e listës së pjesëve rezervë të cilat mund të jenë të nevojshme për automjete; Sigurimi i marrëveshjeve preliminare me furnizues.
- Definimi i ndikimit të mundshëm në rrethana kohore të punës logjistike.
- Definimi dhe zbatimi i trajnimit për personelin dhe njësitë përgjegjëse për logjistikë gjatë situatës emergjente.

#### **5.7.5 Nevoja tjera**

Plani gjithashtu duhet të përmbajë veçori për plotësimin e nevojave elementare lidhur me strehimin, ujin dhe ushqimin. Gjëra tjera të cilat duhet të jenë të kyçur në planin janë për shembull: sapun për higjienë dhe preventivë nga sëmundjet ngjitëse, batanie, rezervoare për ujë dhe shkrepsa. Për shkak se situatat mund të dallohen, lista e punëve elementare duhet të përpilohet në bazë të popullatës e cila do të jetë e goditur nga katastrofa. Plani duhet t'i ketë parasysh pyetjet në vijim:

- Gjëra të cilat do të nevojiten dhe cilat janë të kapshme
- Norma për skladium – cilat janë kapacitetet lokale për skladium?
- Rezerva të kapshme të batanieve, rezervoare për ujë, karburant për përgatitjen e ushqimit, shporetë, pajisje për ushqim dhe rroba.
- A ekziston sistem për shpërndarje?
- Kush është përgjegjës për menaxhim me këto mallëra dhe për vlerësimin e nevojave?

### 5.7.6 Shëndet dhe të ushqyerit

Qasje në ujë të sigurt, kushte të mira sanitare në vendbanime dhe të ushqyerit adekuat ndihmojnë të shmangen sëmundjet. Këto çështje duhet të shqyrtohen para se të fillojë program i caktuar mjekësor. Pyetjet në vijim lidhur me shëndetësinë dhe të ushqyerit duhet të merren parasysh në procesin e planifikimit:

- Kush është përgjegjës për plotësimin e nevojave në sferën e shëndetësisë dhe të ushqyerit?
- Si është sistemi lokal për kujdes shëndetësor dhe në cilën mënyrë funksionon gjatë situatës emergjente?
- Ku mund të bëhet vaksinimi për sëmundje ngjitëse?
- Cilat janë nevojat për të ushqyerit plotësues (fëmijë, gra shtatzëna dhe lehona) apo programe të posaçme për ushqim?
- Cilat agjenci qeveritare apo joqeveritare janë përgjegjëse për kujdesin shëndetësor, preventivë nga sëmundje dhe fushata për shëndet publik? Çfarë roli luan agjencioni juaj?
- A është ndryshe në dimër mbrojtja shëndetësore? Në cilën mënyrë? Cilat masa speciale duhet të merren parasysh gjatë situatës emergjente në dimër?
- Cilat masa duhet të ndërmerren për grupe të ndryshme të popullatës (fëmijë gra shtatzëna etj)?
- Çfarë ilaçe dhe pajisje mjekësore janë të nevojshme? Çka mund të mungojë? A janë të nevojshme sasi plotësuese për këto gjëra?
- A ka kapacitete të kapshme për skladium? Nëse nuk ka çka duhet të bëhet?

### 5.7.7 Strehimore

Në raste të caktuara ka nevojë për sigurimin e strehimit emergjent për njerëzit shtëpitë e së cilëve janë të shkatërruara apo nuk janë të sigurta për jetesë. Për këtë qëllim mund të ketë nevojë për meremetim emergjent të shtëpive, sigurim të shatorëve dhe mbulesave për strehim të përkohshëm, apo për strehimin e personave të cilët kanë mbetur pa shtëpitë e tyre në ndërtesat publike, siç janë për shembull shkollat.

Pyetjet në vijim duhet të merren parasysh në procesin e planifikimit:

- Kush është përgjegjës për menaxhim dhe vlerësim të nevojave lidhur me strehimoren?
- Cila është politika shtetërore në bazë të strehimit të popullatës së goditur? Cila strukturë shtetërore është përgjegjëse për koordinimin e kësaj pune?
- A janë identifikuar lokacione për strehim në rast të situatave të mëdha urgjente?
- Si identifikohen këto lokacione? A ka vështirësi lidhur me këto lokacione? Cilat probleme potenciale mund të paraqiten në bashkësinë lokale?
- Cilat vështirësi mund të dalin në dimër / verë?
- Çfarë lloji të ndihmës do të nevojitet për njerëzit të cilët do të qëndrojnë tek farefisi apo miqtë?
- Si mund të ndikojë terreni në strehimore? A ka materiale ndërtimore në nivel lokal?
- A ka nevojë për shatorë, material ndërtimor, najlona?

#### **5.7.8 Shërbimi për kërkim dhe bashkimi i familjeve**

Një ndër gjërat prioritare në operacionet për sigurimin e ndihmës është inicimi i shpejtë për kërkimin e njerëzve të zhdukur dhe bashkimi i familjeve. Familja është njësi elementare sociale në të shumtën e shoqatave dhe luan rol kyç në plotësimin e nevojave dhe zgjedhjen e problemeve në bashkësi. Agjencitë përgjegjëse për kërkim dhe bashkim të familjeve duhet të kenë parasysh pyetjet në vijim:

- Kush është përgjegjës për menaxhim me kërkimin e personave të zhdukur dhe bashkimin e sërishëm të lidhjeve familjare?
- Cilat metoda apo qasje do të përdoren për zbatimin e këtyre aktiviteteve?
- Cilat metoda të komunikimit do të përdoren për bashkimin e anëtarëve të ndarë të familjes?
- Cilat agjencione tjera dhe struktura qeveritare janë përgjegjëse për këto operacione? Cili nivel i koordinimit është i nevojshëm me këto struktura?
- Në cilën fazë të përgjigjes duhet të fillohen operacionet për kërkimin e personave të zhdukur (normalisht rreth 24 – 48 orë, për shkak se shumë njerëz kanë sukses të gjenden njëri me tjetrin gjatë kësaj periudhe)?
- Si do të informohet popullata e goditur për këtë shërbim?
- Kush do të punojë në shërbimin për kërkim?
- Cilat metoda dhe forma janë të nevojshme që ky shërbim të jetë më efektiv (për shembull: kartela informative / kartela regjistrimi, formulare për kërkim etj.)?

### **5.7.9 Mbrojtje dhe siguri**

Planet për siguri duhet të caktojnë se kush është përgjegjës për mbrojtje dhe siguri. Përskaj kësaj plani duhet të identifikojë aksione të cilat duhet të ndërmerren për mbrojtjen e popullatës së goditur dhe pasurisë së tyre dhe si sigurimin e njerëzve të cilët sigurojnë përgjigje emergjente. Normal, kjo do të jetë përgjegjësi e policisë lokale

## **6. Sigurimi i implementimit të planit**

### **6.1 Vetëdija publike**

Bashkëpunimi ndërmjet agjensioneve për përgjigje në fatkeqësitë emergjente dhe publikut është thelbësore për sukses të operacioneve për përgjigje të fatkeqësive. Baza e këtij bashkëpunimi mund të krijohet gjatë fazës së gaditshmërisë së gaditshmërisë së fatkeqësive. Agjensionet e përfshira në operacionet për përgjigje duhet ta informojnë publikun në fusha të nënshtruar në katastrofa për planet oficiale dhe marëveshjeve për t'iu përgjigjur katastrofave në ato fusha, si dhe ta edukojnë publikun për masat themelore për përgaditje para fatkeqësive që mund të marrë popullsinë për të reduktuar ndikimin dhe efektet për fatkeqësitë potenciale. Planit duhet të identifikojë cilat masa lokale për përgaditje duhet të ndërmerren si dhe mënyra për paralajmërimin e popullatës në raste të fatkeqësive.

### **6.2 Ripërritja e planit**

Planet me kalimin e kohës vjetrohen si rezultat i ndryshimeve shoqërore, ekonomike, organizative dhe ndryshimeve tjera. Shumë është rrëndë plani të mbetet valid dhe relativ dhe ajo mund të realizohet gjatë shqyrtimeve të rregullta të planit dhe ripërritjeve. Planit duhet të përmbajë dispozita se sa shpesh do të kryhet shqyrtimi i tij (shembull: çdo gjashtë muaj, çdo vit) si dhe njerzitet përgjegjës për ripërritjen e planit.

Informacionet të cilat duhet rregullisht të ripërritohen janë:

- Informacionet për kontakt (shembull: numri i telefonit, faks, e mail adresa etj.) të personalit dhe agjensive për përgjigje urgjente.
- Plane për transporte logjistike
- Struktura për përgaditje gjatë gjendjeve urgjente
- Burimet në dispozicion

### **6.3 Lidhjet me planin nacional**

Detyra dhe përgjegjësia primare e qeverisë është që të siguron siguri dhe përgaditshmërin e qytetarëve dhe ta kordinon punën e organizatave të

ndryshme të cilët janë të përfshirë në sigurimin e përgjigjshmërisë të fatkeqësive. Gjatë fatkeqësisë së caktuar roli i Kryqit të kuq/Gjysmëhënës së kuqe dhe organizatave joqeveritare është që të veprojnë si ndihmës të shërbimeve qeveritare.

Për këtë arsye, personat përgjegjës nga Kryqi i kuq duhet të krijojnë lidhje dhe marrëdhënie me institucionet përkatëse që të sigurohet se plani për përgaditje gjatë fatkeqësive dhe politikat përkatëse janë në pajtueshmëri me kuadrin e përgjithshëm të planeve për përgaditjen gjatë fatkeqësive të qeverisë me qëllim që të mos dyfishohen përpjekjet e qeverisë.

#### **6.4 Stërvitje, trajnime të simulimit dhe rrishikimi i planit**

Mënyra e vetme për të ditur që a funksionon plani është që ai të zbatohet, vlersohet dhe rishikohet sipas nevojës. Kjo mund të bëhet nga dy mënyrat në vijim: stërvitje për ushtrimin e aktiviteteve për përgjigje dhe rishikim të planeve pas ngjares së jashtëzakonshme të caktuar.

Ushtrimet dhe trajnimet testojnë supozimet dhe procedurat në plan. Ushtrimet tregojnë anët e forta dhe të dobëta të planit për përgaditje gjatë fatkeqësive. Në rrethana ideale ushtrimet duhet të jenë sistematike, me pjesëmarrjen e shoqatave kombëtare, agjensioneve qeveritare, organizatave joqeveritare dhe grupe tjera dhe organizata të cilat do të ishin të kyqyra në përgjigjen gjatë fatkeqësive të caktuara. Ushtrimet janë gjithashtu mënyra e vetme që planet të mbesin valide dhe ata paraqesin mjet për kontrollim të planeve dhe sipas nevojës, mundësojnë modifikimin e tyre dhe përshtatjen varësisht nga situata.

Mundësia tjetër për vlersimin e efektivitetit të planit për përgaditjen është pas ndodhjes së ndonjë gjendjeje të jashtëzakonshme. Në bazë të përgjigjes, organizatat mund t'i revidojnë planet e tyre për përgaditje dhe ti rripërtrijjnë planet e tyre për përgaditje dhe ti rripërtrijjnë me qëllim të ballafaqohen me gjendjen reale, mundësitë dhe sfidat në situata të caktuara të jashtëzakonshme. Pyetjet të cilat duhen të parashtrihen gjatë revidimit janë:

- Ç'ka ka shkaktuar më shumë raste të vdekjes dhe dëme? Ç'ka mund të bëjë shoqata nacionale për parandalimin e këtyre gjendjeve në të ardhmen?
- Cilat kanë qenë vështirësitë më kryesore në dërgimin e ndihmës tek popullata e goditur? Si mund që kjo ta përmirson shoqatën nacionale në ardhmëri?
- Si ka funksionuar sistemi për paralajmërim? Cilat përmirsime janë të nevojshme?
- Cilat gabime janë bërë? Cilat ndryshime duhet të bëhen që të tejkalohen këto gabime në të ardhmen?
- Çka është bërë mirë? Si mund të garantojmë se do të vazhdojmë ta bëjmë këtë të mirë?

- Cilat mallëra kanë qenë të mjaftueshme. Cilat jo? Si mund kjo të kompenzohet në të ardhmen?
- Si ka qenë niveli dhe kualiteti i koordinimit të shoqatës nacionale me agjensionet tjera të jashtme? Cili koordinim shtesë është i nevojshëm? Si mund të përmirsohet ky koordinim në të ardhmen?
- Cilat kanë qenë anët e dobëta dhe të forta të planit për përgatitshmëri gjatëkatastrofave? Si mund të modifikohet plani me qëllim që të përmirsohen anët e dobëta?

## Aneks 1

### Shembull për planin për përgatitshmëri gjatë katastrofave në shoqatën nacionale

Hyrje	Qëllimi i planit për përgatitshmëri gjatë katastrofave. Lidhja me planet tjera për përgaditjedhe organizim dhe zhvillim. Përshkrim i procesit të planifikimit dhe njerëzve/shërbimeve të cilat do të kyqen.
Politikë përgatitshmëri gjatë katastrofave të shoqatave nacionale	Shoqata nacionale duhet të miratojë politikë e cila e rregullon kornizën për veprimin në planin e përgatitshmërisë gjatë katastrofave të shoqatave nacionale.
Rroli dhe qëllimi gjatë përgatitshmërisë të katastrofave të shoqatave nacionale	Rrolet e përgjithshme dhe qëllimet e shoqatave nacionale në sferat e përgatitshmërisë gjatë katastrofave
Qëllimet	Lista për qëllime programore të cilat përshkruajnë cilat janë pritjet dhe rezultatet të cilat duhen të realizohen në fushën e përgatitshmërisë gjatë katastrofave
Profili i vendit në marrëdhëniet e katastrofave: Historia e katastrofave, llojet dhe efekti.	Përshkrim i katastrofave të cilat përpunohen në plan, si dhe përqëndrim i shkurtë i historisë së tyre dhe fushave gjeografike dhe popullata e cila është më e mjerueshme nga këto katastrofa.
Politika nacionale për menaxhimin gjatë katastrofave	Deklaratë e shkurtë që i mbledh politikat dhe planet në fushën e menaxhimit të katastrofave në vend, dhe roli i shoqatës nacionale në kornizë të politikës qeveritare ose plani i përgatitshmërisë gjatë katastrofave
Struktura për përgatitshmëri gjatë katastrofave të shoqatave nacionale	Struktura e shoqatave nacionale dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq
Ndarja regjionale dhe rrolet në fushën e përgatitshmërisë gjatë katastrofave	Rrolet dhe përgjegjësitë e zyreve rajonale për përgatitshmëri katastrofale
Koordinimi me Federatën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe	Marrëveshje për koordinim dhe komunikim me Federatën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe KNKK gjatë periudhave dhe situatave lidhur me veprimin emergjent gjatë katastrofave
Koordinimi me qeverin	Përshkrim i lidhjeve koordinative dhe marrëdhëniet me ministritë qeveritare dhe pjesë në periudhën para katastrofave, gjatë katastrofave dhe pas ndodhjes së katastrofave.
Koordinimi me organizatat	Koordinimi dhe komunikimi me organizata

joqeveritare dhe ndërkombëtare	joqeveritare dhe ndërkombëtare në fushën e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave
Aktivizimi i sistemit për përgjigje gjatë katastrofave të shoqatave nacionale	Përshkrim i procedurave për aktivizimin e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe në çfarë mënyre do të realizohet.
Aktivitete dhe resurse për përgjigje gjatë katastrofave të shoqatave nacionale	Përshkrimi i llojeve të aktiviteteve për përgjigje gjatë katastrofave ku do të kyqet shoqata nacionale dhe resurset dhe personeli që është në dispozicion
Sistemi për rekomandim të hershëm	Përshkrimi i tipit të sistemit për rekomandim të hershëm dhe procedurat e shoqatave nacionale për aktivizimin e përgjigjes.
Vlersimi i nevojave	Politikat dhe procedurat operative për informimin e vlersimit të nevojave gjatë katastrofave.
Angazhimi dhe trajnimi i vullnetarëve	Përshkrimi se si do të angazhohen dhe trajnohen të punësuarit dhe vullnetarët në sferën e përgaditjes dhe ndikimit gjatë katastrofave.
Ngritja e vetëdijes të popullatës për katastrofat Подигање на свеста на јавноста за катастрофи	Aktivitetet dhe qëllimet për ngritjen e vetëdijes së popullatës për dëmet nga katastrofat të cilat do ti (sproveduva) shoqata nacionale.
Furnizimi, shpërnadrja dhe distribuimi i ndihmës humanitare.	Përshkruan mënyrën se si kryhen furnizimi Sklladiranjeto, dhe distribuimi i ndihmës humanitare.
Aranzhmanet financiare dhe procedurat kontabilistike.	Bën përshkrimin e procedurave dhe politikave lidhur me aranzhmanet financiare dhe procedurat kontabilistike gjatë përgjigjes gjatë katastrofave.
Donacione apel ndërkombëtar	Përshkruan politikat dhe procedurat lidhur me marjen e donacioneve, mjeteve të siguruar të të hollave në shtet dhe udhëzime për apel.
Procedurat për lajmërim	Përshkruan rregullat dhe procedurat për paraqitjen e raporteve për operacione urgjente për ndihma humanitare, nga niveli i terrenit, nga magacionet dhe depotë, nga centrali dhe informime për donatorët lokal.



Punë me mediat	Përshkruan politikat, procedurat dhe personelin icilidotëpunon me mediat para, gjatë dhe paskatastrofave.
Implementimi i planit dhe mirëmbajtja	Përshkruan në çfarë mënyre do të mobilizohen resursset, planet për trajnime dhe ushtrime për përgaditje, dhe procedura për revidim dhe rripërtrim të planit.
Përgaditje gjatë katastrofave të bazuara në bashkësitë lokale	Përshkruan politikat dhe qëllimet për mbrojtjen e përgaditjes gjatë katastrofave në nivel lokal.
Anekse	Harta, buxhete, resurse, mallra, reyervat e mallrave, pajisje.

## Aneks 2 Nevojat potencialegjatë gjendjeve urgjente

	Tërmete	Поплави	Движење на население	Суша
Kërkime dhe shpëtime	Ч	У	Р	У
Ndihma e shpejtë	У	Р	Ч	У
Evakuimi urgjent	У	У	С	У
<b>Uji dhe kanalizimi</b>				
Distribuimi, ruajtja, përpunimi		Ч	ЧС	Р
Gjetja e burimeve alternative	Р	ЧС	У	Р
Largimi i fecesit		ЧС	Р	Р
Largimi i mbeturinave	Р	Р	С	Ч
Higjiena personale	С		У	Р
Kontrollimi i insekteve dhe dëmtuesve	ЧС	Ч	Р	Ч
<b>Ushqimi dhe të ushqyerit</b>				
Distribuimi afatshkurteë	П	Р	Р	Р
Distribuimi afatgjatë	Р	Ч	Ч	Р
Ushqimi shtesë		П	Р	Р
Bujqësia	П	Р	Ч	Ч
Kontrollimi i ushqimit	Ч	Р	П	П
<b>Strehimi</b>				
Strehimi urgjent	П	Р	П	П
Ndërtesa/strukura	РУ	К	Р	К
Batanie	ПУ	К	Р	П
Mjete për nxemjen e vendbanimeve	К	Р	Р	П
Elemente përkuzhinë	ПС	Ч	Р	П
<b>Shëndeti</b>				
Higjiena personale	ЧС	Р	П	У
Rekonstruimi, transporti, pajisja	К	К	Р	П
Mjekimet	ЧС	Р	С	К
Vaksinimi	П	К	П	У
Kontrolli i diares	У	Р	К	П
Kontrolli për sëmundjet ngjitëse	У	П	С	У
<b>Mbrojtjet sociale dhe kërkesa të shërbimit</b>				
Shërbime sociale	КЧ	КЧ	ЧС	К
Fëmijë në rrugë	Р	П	П	Р
Shkolla / Arsimimi	Р	Р	Ч	КЧ
Kërkesa për shërbim	П	П	Р	ЧК

Nevojat që shpesh paraqiten	Ч
Nevojat që rallë paraqiten	П
Nevojat qërallëparaqiten	Р

Nevojat në mjedise të fshatit	С
Nevojat në mjedise urbane	У
Nevojat lidhur me kushtet klimatike	К

1. Nëse vjen vetëm në ndryshime të rrjedhave nënujore
2. Nëse bunaret dhe burimet normale të ujit janë të ndotura ose nuk janë nëqasje.
3. Nëse janë të prishura sistemet kryesore të ujësjellësit.
4. Vetëm në raste të përmbysjeve të pagjetura.
5. Vetëm disa ditë të para që tju ndihmohet popullatës së goditur

### Aneks 3 Lista e planit përpunë: Nevojat urgjente dhe resursret

Përdoreni këtë formularpër për ti identifikuar nevojat potencijale dhe resursret potenciale për plotësimin të këtyre nevojave.

Lloji i katastrofës \_\_\_\_\_ : (shënojeni )

Nevojat urgjente potenciale	Nevoja tipike?	Resursret urgjente potenciale Rrolet / Përgjegjësitë (po / jo)			
		Popullata lokale/vullne tarë	Shoqata nacionale	Mbrojtja civile	Tëtjera ?
<b>Nevoja urgjente</b>					
Kërkesa dhe shpëtime					
Ndihma eshpejtë					
Evakuim urgjent					
<b>Uji dhe санитација</b>					
Shpërndarje, renditje përpunim					
Largimi i fecesit dhe Kanalizimi urgjent					
<b>Ushqimi dhe të ushqyerit</b>					
Shpërndarjet afatshkurte					
Shpërndarjet afatgjate					
Kontrollimi i ushqimit					
<b>Strehimore</b>					
Strehimore urgjente					
Ndërtimi dhe përmirsimi i strehimoreve					
Shpërndarja e batanieve					
Distribuimi i mjeteve për ngrohjen e vendbanimeve					
<b>Shëndeti</b>					
Shëndetësia personale					
Mjekime					
Kampanja përvaksinim					

Kontrolli i diares					
Përcjellja e epidemive					
<b>Lloje tjera të nevojave urgjente? Numëroni më poshtë</b>					

## Aneks 4 Rrolet organizative

Ky formular mundet gjithashtu të përdoret për identifikimin e rroleve potenciale për përgjigje urgjente.

	Rekomandimi dhe informimi i popullatës	Marrëdhiet me popullatën dhe informimi	Operacione për kërkim dhe shpëtim	Furnizime uje	Kanalizim	Furnizimi me ushqim	Logjistika dhe transporti	Shëndeti dhe të ushqyerit	Strehimore	Sigurime	Kërkesa dhe bashkime familjare	Nevoja tjera	Ndihma e shpejtë
Popullata e goditur													
Personeli i angazhuar lokal													
Personel nga sektori shëndetësor													
Strukturat e mbrojtjes civile													
Policia													
Kryqi i kuq/ Gjysmëhëna e kuqe													
Shërbimi zjarfikës													
Organizatat joqeveritare													
Agjensionet e SHBA së													
Të tjera													

## **Aneks 5: Udhëzime për përgatitje të planit lokal për përgatitje gjatë katastrofave**

1. Qëllimet e planit
2. Vlersimi i shoqatës
  - Cilët janë anët e dobëta dhe anët e forta?
  - Cilët janë resurset dhe gjendjet e mjerueshme të shoqatës (hartimi i baskësisë) ?
3. Marrëdhënia me agjensionet nacionale për menaxhim me kriza dhe agjensione tjera
4. Sistemi për rrekomandim
  - Çfarë lloje të sistemeve përdoren dhe si funksionojnë?
  - Kush çfarë bën kur të rrekomandohet?
5. Procedura të evakuimit
  - Kush dhe kur jep urdhëra për evakuim?
  - Cilat rrugë të qarkullimit duhet të ndjeken?
  - Kush do të kujdeset për njerëzit në bashkësinë të cilët kanë nevojë për ndihmë të veçantë (personat të idnetifikuar si më të mjeruar, të hendikepuarit, personat e sëmurë)?
6. Strehim emergjent
  - Ku do të jenë të vendosur – cilat objekte janë të zgjedhura për këtë qëllim (shembull: shkollat) ?
  - Cilat paisje janë në dispozicion dhe kush është përgjegjës?
  - Kush do të menaxhojë strehimore dhe si ?
7. Kërkesa dhe ndihma
  - Kush është përgjegjës?
  - Cila paisje është në dispozicion dhe ku gjindet?
8. Vlerësimi i nevojave dhe dëmeve-vlersimi fillestar dhe në vijuese
  - Koj e одговорен?
  - Si do të implementohet? (Formati për rraportin )
9. Pastrimi i rrugëve/pastrimi i rrënojave
  - Koj e одговорен?
  - Cila paisje është në dispozicion dhe ku gjindet?
10. Komunikimet
  - Në cilën mënyrë do të realizohet kontakti me bashkësinë me botën e jashtme pas katasrofës?
  - Cilat mjete tjera janë në dispozicion?
11. Rrend dhe qetësi/sigurim
  - Kush është përgjegjës?

## 12. Transporti

- Kush është përgjegjës për transportin gjatë gjendjeve urgjente?
- Cilat automjete janë në dispozicion dhe ku gjinden?
- Çfarë marrëveshje mund të bëhet me poseduesit e automjeteve para katastrofave?

## 13. Rregullim i uslluga komunale (uji, rryma, telefoni)

- Kush është përgjegjës?

## 14. Kujdesishëndetësor

- Kush dota koordinojë ndihmën e parë?
- Cilat spitale, paisje dhe materiale janë në dispozicion?
- Sa persona të trajnuar nga ndihma e parë ka në bashkësinë dhe cilështë rrolli tyre?

## 15. Mbështetja personale për popullatën e goditur nga katastrofat

- Kush ka përvojë ose trajnim?
- Kush dota koordinojë këtë ndihmë?

## 16. Mbështetja sociale

- Çka do të bëhet që të sigurohet strehim, ushqim dhe roba për personat të cilat kanë nevojë për këtë?

## 17. Ndihma humanitare

- Kush do ta identifikojë popullatën më të mjeruar dhe në çfarë mënyre do të bëhet ajo?
- Si mund të sigurohet ndihma urgjente pas katastrofës?
- Kush do të jetë përgjegjës për fitimin dhe distribuimin e ndihmës?

## 18. Mbështetja e jashtme

- Çka ka në dispozicion?
- Në çfarë mënyre duhet të dorëzohen kërkesat për mbështetje?
- Kush është përgjegjës për dorëzimin e kërkesave?

## 19. Testimi i planit lokal

- Si do të zbatohet kjo?

## 20. Revizioni dhe rriparimi i planit lokal

- Sa shpesh do të bëhet kjo?
- Si do të bëhet kjo dhe kushtetë jetë i kyqur në proces?

## 21. Diseminimi i planit lokal

- Si do të kryhet diseminimi?
- Si do të munden anëtarët e bashkësisë të japin të arriturat e tyre për përgaditjen e planit?
- Kush është përgjegjës?

## 22. Zvoglimi i rreziqeve

- Si do të identifikohen aktivitetet për zvoglimin e rreziqeve?

- Kush do ti zbaton këto aktivitete?
- Kush do ti finansojë këto aktivitete ?

### 23. Aneksë

- Tregoni hartat e bashkëisë, të dhënat për mjerueshmëri dhe vlerësimi i kapaciteteve, kontakte, emra dhe adresa, lista për njerëz të përgjegjshëm për aktivitete të posaçëm, formular për vlerësimin e dëmeve/nevojave etj.



## Zvoglimi i rreziqeve

### Qëllimi dhe grupi qëllimor

Ky modul i paraqet konceptet e ndërlidhura mes vete të rreziqeve, mjerueshmërisë, dhe asocimin e tyre me aktivitete dhe strategji për zvoglimin e rreziqeve. Në pjesën e fundit të modulit janë të prezentuara masat e posaqme dhe të përgjithshme për zvoglimin e rreziqeve sipas rreziqeve të caktuara si dhe masa të cilat mund të zbatohen në bashkësitë lokale.

Këtë modul mund ta shfytëzojë cilido që ka përgjegjësitë përgjegjësi të përgjithshme për planifikim dhe program implementues në fushën e zvoglimin të rreziqeve nga katastrofat. Personeli i ngelur jotehnik i cili don të arrin dituri plotësuese në bazë të elemneteve të cilët i bëjnë njerëzit të mjerueshëm nga katastrofat edhe strategjitë dhe masat për zvoglimin e rreziqeve të tyre gjithashtu mund të kenë dobi nga leximi i këtij moduli.

### Pikat kryesore

- Faktorët të cilat ndikojnë në mjerueshmëri
- Pse dhe si individët ndryshe i shikojnë rreziqet
- Rreziqet në të cilat është shfaqur bashkësia dhe hartimi i kapaciteteve
- Raportet mes rreziqeve, mjerimit, kapacitetit dhe rezikut
- Lloje të ndryshme të masave për zvoglimin e rreziqeve
- Strategjitë për të zvogluar rreziqet të cilat janë të veçantë në krahasim me rreziqet e veçanta
- Strategjitë për të zvogluar rreziqet të bazuar në gjendjen në bashkësinë të cilat janë specifike në bazë të rreziqeve të veçanta.

### 1. Hyrje

Katastrofat ndodhin kur rreziqet natyrore apo teknologjike kanë ndikim tek njerëzit dhe mjedisin jetësor. Njerëzit me resurse më të mëdha – ekonomike dhe sociale- shpesh herë kanë kapacitet më të madh të ballafaqohen me efektet e rreziqeve se sa njerëzit të cilët janë më të varfër në rrethin shoqëror.

Rritja e shpejtë e numrit të popullatës, migrimin urban apo masiv përtej kufijëve, posedimi i padrejtë i truallit, mungesa e arsimit dhe vetëdijes dhe mungesa e punës bujqësore të tokave të caktuara të marginalizuara sjell në situata të mjerueshme siç janë strehimi i pasigurtë në ndërtesa dhe vendbanime tjera, shkatërimi i pyjeve, mos ushqimi i popullatës, papunësia, punësimi i vogël në mjediset ku ekzistojnë mundësi për punësim, analfabetizmi etj.

Individët dhe organizatat të cilat janë përgjegjës për planifikimin e uljes së rreziqeve dhe masat për përgjigje urgjente për situata urgjente duhet të fillojnë para së gjithash me kuptimin e natyrës dhe mundësitë e ndodhive të rreziqeve të caktuara me të cilën mund të ballafaqohen njerëzit. Ata duhet ti vlerësojnë

elementet sociale të cilët janë subjektë të rreziqeve të caktuara (njerëz, struktura, shërbime dhe aktivitete) si rezultat i rreziqeve nëse dhe kur të ndodhin.

Planifikuesit gjithashtu duhet të kenë kuptim solid të gjendjeve të mjeruara specifike e gjithë popullatës si dhe kapaciteti i mbështetjeve efektive të tyre dhe hartimin e masave të rëndësishme për të zvogëluar rreziqet të cilët i ndërtojnë anët e forta të popullatës qëllimore njëkohësisht zvogëlojnë gjendjen e tyre të mjerueshme. Ata gjithashtu duhet të kuptojnë se si shoqëria ose popullata qëllimore sheh në rreziqet e veta dhe çfarë domedhënie vendosin në zvogëlimin e rreziqeve specifike.

Konceptet e mjerueshmërisë dhe rreziqeve janë të lidhura në mënyrë dinamike. Marrëdhënia e këtyre elementeve mund të shprehet me një formulë të thjeshtë e cila e ilustron konceptin se sa më e madhe që është paraqitja potenciale e rrezikut dhe sa popullata është më e mjeruar, aq më i madh do të jetë dhe rreziku. Gjithashtu me rëndësi është të theksohet se mjerueshmëria njerëzore ë katastrofave është e lidhur në mënyrë reciproke me kapacitetin njerëzor për tu përballuar me efektet nga katastrofat.

### **rreziqe = rreziqe x gjendje të mjeruara**

Definicionet në vijim shërbejnë si orientim për këto koncepte të ngjajshme.

**Mjerrueshmëria:** Mjerueshmëria njerëzore paraqet mungesë të kapacitetit të njeriut ose grupit shoqëror ta parasheh, të merret, të përballojë dhe të shërohet nga ndikimi i rreziqeve.

Mjerrueshmëria ka dy komponente: ekspozimi ndaj rreziqeve ( p.sh. thatësira, tërmet, etj.) dhe vështirësia në përballimin dhe shërimin nga ato (si rezultat i mungesës së resurseve). Për shkak se mjerueshmëria njerëzore është e lidhur me konceptin e kapacitetit njerëzor, më poshtë ne japim definicion për atë koncept.

Mjerueshmëria strukturore ose fizike paraqet shkallën në të cilën struktura ose shërbimi është mesiguri i dëmtuar apo dëmtohet nga ngjarjet e shkaktuara nga një rrezik i caktuar. Për një ndërtesë mund të thuhet se është i ndijshëm në goditjet e tërmetit në qoftë se në ndërtimin e tij mungojnë elementet të cilët do të mund të jenë rezistente ndaj efekteve të goditjeve të tilla.

**Kapacitetet:** Kapacitetet njerëzore janë cilësitë dhe resurset të **poedinec** apo bashkësisë të parashohin, të përballohen, të jenë rezistente, dhe të shërohen nga ndikimi i rreziqeve të caktuara. Sipas Meri Anderson, kapacitetet njerëzore përmbajnë resurse materiale të njeriut apo bashkësisë (ushqim, kafshë, mjete); kapacitetet sociale dhe organizative (udhëheqësia, grupet në bashkësinë); dhe kapacitetet motivuese (ide, vlerat e punës, efikasiteti).

**Rreziku** definohet si paraqitje potenciale, në periudhë të caktuar kohore dhe sipërfaqe gjeografike, të një fenomeni natyror që mund të ketë ndikim të madh në jetën e njeriut, në pronën apo aktivitetin në atë shkallë që mund të shkaktojë katastrofa. Metodatat për parashikimin e rreziqeve të ndryshme dhe mundësitë dhe frekuenca e paraqitjes së tyre mjaft ndryshon sipas rrezikut të tyre.

**Rreziku** ka të bëjë me humbjet e papritura apo të parashikuara (jetë të humbura, njerëz të plagosur, pronë e dëmtuar, dhe aktivitete ekonomike të shkatëruara) nga ndikimi i rreziqeve të caktuara si rezultat i rrezikut të caktuar në periudhë të caktuar kohore. Rreziku definohet ndryshe nga ana e njerëzve në situata të ndryshme. Rreziku shikuar nga ana e politikanëve apo menaxhuesit për katastrofa, është i ndryshëm nga rreziku që shkenctarët që e kuptojnë apo kompanitë e sigurimit apo nga ana e familjes e cila jeton në një zonë të priur për tërmete.

## **2. Faktorët që ndikojnë në mjerueshmërinë e njeriut**

Para se të përgatiten programet për zvogëlimin e rreziqeve, me rëndësi është që të kuptohen disa nga faktorët kryesorë të cilët e bëjnë popullatën të mjeruar. Këto mund të jenë faktorët:

- Varfëria
- Banimi i tepërt
- Urbanizimi i shpejtë
- Ndryshime në mënyrën e jetës
- Degradimi i mjedisit jetësor
- Mungesa e vetëdijes dhe informimi
- Lufta dhe trazirat qytetare

Në diskutimet e mëposhtme, do të shihni se këta 7 faktorë shpesh herë ndërlihen mes vete. Për shembull varfëria shpesh herë rezulton në migrimin e njerëzve në vendet urbane në kërkim të punës. Resurset e kufizuara dhe mundësitë në vendet urbane rezultojnë shpërnguljen e njerëzve në vende të pasigurta që mund të shkaktojë tensione në popullatë.

### **2.1 Varfëria**

Një numër i madh i studimeve të cilët kanë të bëjnë me katastrofat tregojnë se anëtarët më të pasur të vendit ose e mbijetojnë katastrofën pa pasoja ose janë në gjendje që shpejtë mund të përmirësohen. Varfëria në përgjithësi i bën njerëzit të mjeruar nën ndikimin e rreziqeve. Varfëria tregon se pse njerëzit në vendet urbane janë të detyruar të jetojnë në kodrat që janë të nënshtruar në rrëshqitje të tokës ose pse njerëzit shpërngulen afër vullkaneve apo lumenjëve të cilët një ditë do të shkaktojnë vërshime. Varfëria gjithashtu shpjegon se pse uria paraqitete si rezultat i mungesës së fuqisë blerëse të blehet ushqim se sa mungesa e ushqimit.

## **Ballafaqimi ndaj thatësirës: situata të mjeruara dhe kapacitetet**

Njerëzit të cilët jetojnë në vende të nënshtruara nga thatësitat siç është vendi Sahell, presin thatësira për rreth çdo 7 vjet. Në këtë periudhë ata ndonjëherë ballafaqohen me mungesën sezonale të ushqimit para çdo korrjes. Të gjitha këto elemente paraqesin gjendje urgjente“ të pritura”. Njerëzit shesin rezervat të caktuara, mbikqyrin të korrurat që janë rezistente ndaj thatësirës dhe në përgjithësi arrijnë të përballohen me situatën. Megjithatë ata nuk janë në gjendje të zhvillohen si familje apo bashkësi si rezultat i këtyre situatave urgjente. Megjithatë, kur janë 2 vite të vështira njëra pas tjetrës, atëherë njerëzit nuk janë në gjendje të ballafaqohen me situatën. Ata patjetër duhet të shesin artikuj të caktuar për prodhim, madje edhe toka. Të varfërit ngelin edhe më të varfër përderisa njerëzit e pasur fitojnë nga ky proces me anë të blerjes së pronave nga të varfërit.

Nga: Doracaku për mjerueshmëri dhe kapacitete të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

## **2.2 Mbipopullata**

Ka një lidhje mes numrit dhe vëllimit të humbjeve nga katastrofat dhe numri i popullatës. Në qoftë se ka më tepër njerëz dhe struktura në vendin ku ka ndodhur katastrofa, atëherë mundësia është më e madhe që ndikimi i katastrofës do të jetë më i madh.

Rritja e popullatës dhe të thotë se njerëzit do të jenë të detyruar të jetojnë dhe punojnë në vende të pasiguruara dhe se më shumë njerëz konkurojnë për numër të caktuar të resurseve (siq janë vende të punës dhe tokës), e cila mund të çojë në konflikte.

## **2.3 Urbanizimi i shpejtë**

Rritja e madhe e popullatës dhe migrantëve janë të lidhura me fenomenin e urbanizimit të shpejtë. Kjo karakterizohet me popullatën e varfër rurale apo popullatën civile në fushë të ndeshjeve që lëviz nga pjesët e qytetit në kërkim të mundësive ekonomike dhe sigurisë. Si rezultat i kësaj, ka aq më pak mundësi për qasje. Garimi për resurset e kufizuara, që është pasojë e urbanizimit të shpejtë, mund të sjell deri në katastrofa të shkaktuara nga vetë njeriu.

## **Tërmetet dhe mjerueshmëria në Kairo, Egjipt: tërmeti i vitit 1992.**

Më 12 Tetorë të vitit 1992, tërmet me fuqi prej 5.6 sipas shkallës së Rihterit e dridhi Kairon, Egjipt dhe pjesët periferike. Tërmeti i cili mund të llogaritet mesatar, bile edhe i vogël, sikur të ndodhte në Japoni apo në Bregun perëndimor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shkatëroi qindra ndërtesa dhe shtëpi në pjesët rurale dhe rezultoi me mbi 500 të mbytur dhe 4000

persona të lënduar. Pjesa më e madhe e dëmit, rastet e vdekjeve dhe lëndimeve ndodhën në lagjen e qytetit me banim të shpeshtë në Kairo ku u rrënuan qindra objekte të vjetra dhe keq të ndërtuara.

Shumica e objekteve që u rrënuan ishin të ndërtuar në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret për ndërtim. Për shembull, ndërtesa 14 katëshe e cila u rrënuar dhe humbën jetën 61 njerëz në pjesën e pasur veriore periferike Heliopolis, fillimisht ka qenë e ndërtuar si ndërtesë 6 katëshe apo 8 katëshe. Katet tjera kanë qenë ilegalisht të ndërtuara-praksë e cila është e shpeshtë në Kairo. Përskaj shtëpive dhe ndërmarjeve, gjithashtu ishin të dëmtuara edhe shumë shkolla. Në një nga anketat e zbatuara në nivel nacional thuhet se do të mbyllen 1.087 shkolla të dëmtuara serioze, ndërsa një anketë tjetër thotë se 5.870 shkolla kanë nevojë për riparim.

Ndikimet nga tërmeti nuk ishin të kufizuara vetëm në Kairo. 3 prej fshatratrave të goditura serioze në luginën e Nilit perëndimor, mbi 2.600 shtëpi kanë qenë tërësisht të shkatëruara. Shtëpitë e shkatëruara ishin të ndërtuara nga tulla nga balta dhe trarëve, si dhe ndërtimet moderne të cilat nuk kanë qenë të dizajnuara as për tërmetet minimale.

Marrur nga: zyrja për ndihmë nga të huajt gjatë katastrofave – rraporti vjetor 1993, Uashington, Agjencioni për yhvillim ndërkombëtar.

## **2.4 Ndryshimet në mënyrën e jetesës**

Të gjitha shoqëritë vazhdimisht ndyshojnë dhe janë vazhdimisht në fazën e tranzicionit. Këto tranzicione shpesh ndërthuren me ndryshime të mbrendshme dhe jobarazime dhe lënë gjurmë të rëndësishme në lidhje me mungesën e ekzistimit të mekanizmit për ekzistencë. Këto tranzicione përfshijnë popullsinë rurale e cila lëviz në vendet urbane si dhe popullsinë.

Këto tranzicione gjithashtu mund të përfshijnë ndryshime të rëndësishme në drejtim të menaxhimit ekonomik apo sistemit politik të vendit. Shumica e vendeve të ish- Bashkimit Sovjetik janë ballafaquar me këtë tranzicion ekstrem nga një ekonomi të centralizuar në një ekonomi tregu e cila çoi në një rritje të konsiderueshme të popullatës së mjeruar. Për shkak se këta mekanizma tradicionale ndoshta nuk do të ekzistojnë në mjedisin e ri, popullsia në mënyrë të konsiderueshme bëhet i varur nga intervenimii jashtëm me qëllim që të arihet procesi i përmirësimit.

Kur njerëzit shkojnë nga qendrat rurale në qendra urbane, ata mund ta humbin sistemin e tyre mbështetës ose rrjetin që tradicionalisht do tju kish ofruar mbështetje për shërim nga katastrofat e caktuara. Konfliktet dhe praktikatat tranzicionale kulturore mund të shkaktojnë konflikte civile.

## **2.5 Degradimi i mjedisit jetësor**

Shumë katastrofa janë të shkaktuara nga degradimi i mjedisit jetësor. Shkatërimi i pyjeve çon në rrjedhjen e shpejtë të ujit nga shirat e cila sjell vërshimet. Kompanitë të cilat janë të angazhuara në nxjerrjen e mineraleve nga toka shpesh herë në vendet e grupuara grumbullojnë materiale toksike të cilat mund të sjellin paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme tek popullata.

Thatësira dhe kohëzgjatja e saj është paraqitje primare natyrore, por zhvillimi i bujqësisë dhe sistemit të shpërndarjes së ushqimit mund ta keqësojnë rrethanën. Ngjashëm me të, ndryshimet klimatike për të cilën konsiderohen se janë rezultat i ngrohjes globale mund të rezultojnë në më shumë katastrofa si pasojë e rreziqeve siq janë vërshimet dhe tharja e tokës.

## **2.6 Mungesa e vetëdijes dhe informimit**

Katastrofat gjithashtu mund të paraqiten kur njerëzit janë të mjeruar në atë thjeshtë nuk dinë se si të qëndrojnë larg tyre ato dhe cilat masa mbrojtëse të ndërmeren. Kjo mund të jetë rezultat i mungesës së masave të vetëdijes që duhet marrë siç janë për shembull ndërtimi i objekteve të sigurta në vende të sigurta. Disa njerëz mund të mos dinë rrugët dhe procedurat e sigurta të evakuimit ndërsa të tjerët mund të mos dinë kujt ti drejtohen gjatë katastrofave.

Megjithatë, në shumicën e fushave të cilët janë të nënshtruara në katastrofa, ekziston një kuptim i madh lidhur me kërcënimet dhe përgjigjet të katastrofave. Kjo njohuri duhet të inkorporohet në përpjekjet për sigurimin e ndihmave të jashtme.

## **2.7 Lufta dhe trazira qytetare**

Luftërat dhe trazirat qytetare mund të konsiderohen si rreziqe ose ngjarje ekstreme të cilat krijojnë katastrofa. Luftërat dhe trazirat qytetare shpesh herë rezultojnë me shpërngulje të popullatës e cila është e mjeruar si rezultat i shpërnguljes. Arsyet e luftës dhe trazirave qytetare mund të jenë garë për resurset e kufizuara, jotoleranca fetare dhe etike, dhe ndryshimet ideologjike – faktorët e njejtë të cilët e risin mjerueshmërinë gjatë katastrofave.

## **3. Perceptimi i rrezikut**

Individët dhe organizatat të cilat janë përgjegjëse për dizajnimin dhe implementimin e masave efektive për zvogëlimin e rreziqeve duhet të marrin parasysh se si tërë popullata i shikon këto rreziqe. Vlerësimi i paanshëm, shkencor apo profesional i rrezikut edhe pse mund të jetë teknikisht i vërtet shpesh herë nuk do të merret parasysh perceptimi lokal i rrezikut dhe zgjedhjet në dispozicion për zvogëlimin e tij.

Nëse ekspertët dojnë të mbështeten në të dhënat teknike dhe statistike, popullata e përgjithshme dhe popullata **целната популација** nuk është gjithmonë në harmoni me këto koncepte statistike dhe do të bazon perceptimet e veta në bazë të vlerave të tjera, filozofive, koncepteve dhe llogaritjeve.

Rreziqet nga katastrofat mesiguri nuk do të llogariten si të rrëndësishme tek popullata e cila ballafaqohet më kërcënimet e mëdha të përditshme siq janë për shembull mungesa e ushqimit dhe sëmundjeve. Edhe nëse rreziku nga katasrofa është shumë me rëndësi vështirë se do të mund të krahasohet me rreziqet nga vdekja tek fëmijët në përgjithësi ku ka sistem të vështirë për mbrojtjen primare shëndetësore. Aty ku resurset dhe kapacitetet janë të kufizuara edhe rreziqet e përditshme janë shumë të mëdha, vështirë është të investohen të holla në zvogëlimin e rreziqeve potenciale.

Shumica e njerëzve të cilët janë nën ndikimin e katastrofave, të cilët jetojnë në varfëri, nuk shohin dallim të vërtetë mes nevojave të cilët burojnë nga katasrofat dhe ato që rezultojnë nga problemet e përditshme – ata duhet të përballohen me të gjitha.

### **Problemet e përditshme në Limë, Peru: mungesa e ujit**

Në shumë vende një ndër problemet e mëdha në vendet urbane është heqja e mbeturinave industriale dhe mbeturinave shtëpiake. Një problem tjetër është mungesa e ujit, situatë që ekziston në Limë, Peru. Shumë njerëz në rajonet e varfëra të qytetit përdorin ujin e ndotur për ujitjen e perimeve që e konsumojnë njerëzit. Kjo praktikë shpesh rezulton në tifus, hepatit dhe incidencë të lartë të sëmundjeve të diaries.

Burimi: Programi i trajnimit për menaxhim me katastrofat, UNDP, viti 1995

Popullsia në vendet e ndikuara nga katasrofa mundet gjithashtu ti tejkalojnë rreziqet e mundura me beneficinet potenciale. Të jetuarit rreth fabrikave për përpunimin e materieve kimike mund të paraqet rrezik njëkohësisht edhe përfitim për mundësi të të punësuarit për popullatën që jeon afër. Për ata që kanë zgjedhur të jetojnë afër fabrikës, përfitimet siç janë punësimet mund ti tejkalojnë rreziqet të cilët mund të dalin nga aksidentet kimike.

Në mënyrë të ngjajshme, rreziqet që bashkangjiten në vaksinim dhe udhëtim në punë në përgjithësi llogariten si të pranueshme sepse përfitimi është i dukshëm në shikim të parë. Për shumicën e njerëzve në bashkësinë, ekspozimi ndaj rreziqeve të natyrës dhe mjedisit nuk ka ndonjë përfitim të caktuar – ekspozimi është pasojë e jetesës ose punës në vend të caktuar. Në përgjithësi niveli i rrezikut të pranueshëm zmadhohet në përputhje me përfitimet që rrjedhin nga ekspozimi i rrezikut.



Aty ku kemi nivel të caktuar të arsimit dhe qasje në media dhe burimeve të tjera të informacioneve, njerëzit nuk do të jenë të vetëdijshëm ose nuk do të dinë për rreziqet që ju kërcënohen. Humbja e njohurive tradicionale për kërcënimet lokale gjithashtu mund ta zvogëlon vetëdijen për zvogëlimin e rreziqeve në periudha të caktuara kohore. Perceptimi i njerëzve në raport me rreziqe të caktuara mund të zvogëlohet në periudha kohore të ndryshimeve të shpejta sociale dhe teknologjike ose kur ekzistojnë periudha të gjata kohore midis katasrofave më të mëdha.

Organizatat siq janë Kryqi i kuq/Gjysmëhëna e kuqe mund të japin kontribut të veçantë për ngritjen e vetëdijes së popullatës në rrugë të informimit publik për rreziqet potenciale. Programet për ngritjen e vetëdijes jo vetëm që shfrytëzohen për zmadhimin e perceptimeve në raport me rreziqet, por janë gjithashtu të rëndësishme për edukimin publik se rreziqet mund të parandalohen si dhe për nxitjen e popullatës të mer pjesë në mbrojtjen individuale.

Dëshira e bashkësisë që të bën diçka për rreziqet nuk mvaret nga niveli i përgjithshëm aktual i rrezikut. Shpesh herë kjo është zgjedhje subjektive që bazohet në bazë të gjykimeve. Organizatat dhe personeli përgjegjës për planifikimin e programeve për përgatitje gjatë katasrofave duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë realitet dhe të kenë gjykime të balancuara shkencore dhe profesionale në raport me rreziqet shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të krahasuara nga individi ose bashkësia që ballafaqohen me rreziqet.

#### **4. Hartimi i rreziqeve dhe kapaciteti i bashkësive.**

Një nga mënyrat për ngritjen e vetëdijes dhe ndryshimit të perceptimeve për rreziqet potenciale është gjatë angazhimeve të individëve dhe grupeve për përgatitje të hartave lokale për rreziqe dhe kapaciteteve të bashkësisë. Këto harta mund të jenë të nevojshme për sqarimin e skemave gjenerale të rreziqeve të cilat kërcënohen grupe e popullatës së caktuar si dhe kapacitetet që i posedon popullata për tejkalimin e këtyre rreziqeve.

Hartat për rreziqet e bashkësive mund të përdoren edhe për përcjelljen e situatave të përgjithshme emergjente siç janë papunësia, mungesa e të ushqyerit, banimi i pasigurt dhe qasje e kufizuar në kujdesin shëndetësor. Të gjithë këto elemente bëhen aq më akute gjatë katasrofës natyrore. Këto harta gjithashtu mund të përdoren që të shihet se si janë resurset dhe kapacitetet lokale – siç janë aftësitë, rezervat e ushqimit, mundësitë për strehim emergjent, organizata shoqërore në bashkësi, sektori korporativ, liderët lokal, vlerat kulturore dhe burimet e transportit siç janë autobusët e shkollës apo automjetet për ngarkim – të cilat mund të ndihmojnë që bashkësitë të ballafaqohen me katasrofat. Përfundimisht hartimi i rreziqeve mund të ndihmojë në përgatitjen e planeve të cilat mund ta ulin rrezikun ndaj bashkësisë dhe identifikimin e planeve për evakuim për rajone të rrezikshme.

Mësues, nxënës, punëtorë social dhe shëndetësor, vullnetarë të Kryqit të kuq, dhe të tjerë në bashkësi mund t'i përgatisin këto harta nëpërmjet përdorimit të mjeteve të thjeshta: me ngjyra dhe letër. Informacionet të cilat do të grumbullohen mund të ndihmojnë për planifikimin e masave dhe iniciativave për planifikim në uljen e rreziqeve. Organizata Shëndetësore Panamerikane ka identifikuar 4 hapa kryesore për përgatitjen e hartimit të rreziqeve dhe kapaciteteve në bashkësi.

1. Identifikimi dhe prioritetizimi i listës së problemeve dhe nevojave të përbashkëta.
2. Vizita e rajoneve dhe lokacioneve në bashkësi që janë të shfyqura në rreziqe.
3. Në bazë të këtyre vizitave, përgatitni harta individuale të detajuara të cilat tregojnë rreziqe, njerëz të mjeruar dhe resurse në rast të situatës emergjente. (Në rrethana ideale përgatitet hartë individuale për këto elemente: një për rreziqe, një për kategori të mjeruar të popullatës dhe një për kapacitete dhe resurse në bashkësi).
4. Organizimi i komitetit lokal për katastrofa t'i planifikojë masat për uljen e rreziqeve dhe/apo të formulojë plan lokal për përgatitshmëri dhe veprim gjatë situatës emergjente.

Të gjitha planet të cilat janë të gjeneruara në bazë të këtyre hartave duhet të diskutohen dhe diseminoen në bashkësi – në rrethana ideale nëpërmjet mbledhjeve dhe prezantimeve në bashkësi. Strategjitë për uljen e rreziqeve gjithashtu duhet të jenë reale dhe të realizueshme dhe të mos kenë pritje të cilat nuk mund të plotësohen.

## **5. Ulja e rreziqeve përkundër uljes së mjerueshmërisë**

Në ekuacionin më poshtë mund të shihet se mbrojtja kundrejt rreziqeve mund të realizohet nëpërmjet mënjanimit të shkaqeve (ulje apo modifikim të rrezikut) apo nëpërmjet uljes së mjerueshmërisë.

$$\text{Rrezik} = \text{rreziqe} \times \text{mjerueshmëri}$$

Në rrethana të caktuara, disa rreziqe natyrore mund të ulen. Ndërtimi i kanaleve përkaj brigjeve të lumenjve e ulë gjasën nga vërshimet në pjesët në rrethinë. Gjithashtu ka mundësi të ndalohen rrëshqitje potenciale të njohura të tokës nëpërmjet stabilizimit të shtypjes së tokës, ndërtim të mureve dhe përmirësim të mos ketë rrëshqitje.

Punët inxhinierike mund të përmbajnë elemente destruktive në krahasim me rreziqe të caktuara natyrore apo mund ta kthejnë rrezikun me kanale dhe gropime. Në disa raste mbjellja e drunjve mund të jetë mënyrë efikase për uljen e vërshimeve dhe rrëshqitjeve potenciale të lloçit, apo për ngadalsimin e shkatërrimit të truallit.

Duket qartë, parandalimi i fatkeqësive industriale është metoda më e mirë për parandalimin e këtyre katastrofave. Zjarret, hedhja e hemikaleve, fatkeqësitë teknologjike dhe transportuese, janë rreziqe të cilat në fakt mund të ndalohen. Fokusi i lehtësimit të katastrofave për këto katastrofa të cilat i shkakton njeriu në fakt është që të ndalohet paraqitja e këtyre rreziqeve apo të ulet ndikimi i tyre nëse ndodhin.

Masat lokale për mbindërtimin e kapaciteteve kanë për qëllim ta ulin mjerueshmërinë e njerëzve nëpërmjet mbindërtimit dhe përforcimit të aftësive dhe kapaciteteve në bashkësitë lokale, sistemet organizative dhe aftësitë dhe ofrim të masave stimuluese për uljen e rreziqeve. Ato gjithashtu iu ndihmojnë bashkësive lokale që të përgatiten të përgjigjen në mënyrë efikase në rast të katastrofës.

Për shkak se përfaqësuesit e popullatës lokale të pjesëve të cilat janë të goditura nga katastrofa në fakt janë të parët të cilët do të gjinden në momentin e katastrofës – është e nevojshme për ata që të zbatohen aktivitete për kërkim dhe shpëtim si dhe sigurim të ndihmës së parë për familjet, miqt dhe fqinjët e tyre. Organizatat siç janë Kryqi i kuq dhe Mbrojtja civile luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e aftësive dhe diturive të këtyre vepruesve “spontan” gjatë katastrofës. ofrimi i edukimit dhe trajnimit për masa për përgatitshmëri, teknika elementare për shpëtim, dhe ndihmë të parë dhe trajtim emergjent, duhet të jetë komponentë e rëndësishme në planet për uljen e rreziqeve.

Këto organizata gjithashtu mund të luajnë rol në ndihmë që të organizohet popullata lokale apo lagjet në bazë të aktiviteteve të caktuara për uljen apo lehtësimin e rreziqeve. Fushat lokale shpesh herë e kanë teknologjinë e nevojshme apo diturinë që të ulet mjerueshmëria e tyre, por mund t’ju mungojë strukturë e caktuar kyçe lokale apo shoqërore e cila i pengon t’i implementojnë këto masa me të cilat do të ulet mjerueshmëria.

Qëllimi i organizimit në nivel lokal të aktiviteteve për uljen e rreziqeve është që të përforcohet popullata lokale që të veprojnë së bashku me qëllim që t’i tejkalojë barrierat potenciale për zbatimin e aksionit të suksesshëm.

Tek katastrofat kjo mund të implementohet në fushatë lokale për ngritjen e vetëdijes ku do të veprohet në rreziqet e katastrofave dhe në teknika të caktuara të thjeshta ndërtimore për përforcimin e shtëpive dhe ndërmarrjeve. Për uljen e rreziqeve nga rrëshqitja e dheut, popullata lokale mund të mobilizohet të ndërtojë struktura me baza më të forta, ta përforcojë bazën e ndërtimeve, të mbjellë pyje nëpër shpate dhe të bëjë barriera nga drunjtë të cilat do t’i mbrojnë nga shembja e shkëmbinjëve.

## **6. Masa për uljen e rreziqeve**

Vëllimi i masave për uljen e rreziqeve mund të klasifikohet në kategoritë në vijim, e të gjithë ato individualisht diskutohen më poshtë në tekst:

- Masa shoqërore
- Masa për planifikim fizik
- Masa ekonomike
- Masa për inxhinieri dhe ndërtim
- Masa për menaxhim dhe memorje institucionale

## 6.1 Masa shoqërore

Ulja e rreziqeve do të ndodhë kur ka konsenzues se ajo është diçka e dëshirueshme, se mund të bëhet dhe se për atë ekzistojnë mjete. Planifikimi lishur me uljen e rreziqeve duhet të ketë për qëllim të ndërtojë “kulturë sigurie” ku të gjithë anëtarët e shoqërisë janë të vetëdijshëm për problemet me të cilat ballafaqohen, dijnë se si të mbrohen vetë; dhe do t'i përkrahin orvatjet për mbrojtjen e të tjerëve, të shoqërisë dhe popullatës lokale si tërësi.

Fushatat për edukim publik kanë për qëllim ta krijojnë këtë kulturë sigurie. Vetëdija e publikut mund të ngritet në më shumë mënyra, nga fushata afatshkurte, me profil të lartë me përdorimin e mediave, letërsisë dhe postereve, deri në afatgjate, me profil të ulët të fushatave të cilat zbatohen nëpërmjet edukimit të përgjithshëm.

Planifikimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe përgatitshmërisë gjatë katastrofave nuk mund të bëhet ndaras nga aktivitetet e jetës së përditshme të njerëzve. Prandaj këto programe janë më efektive kur lidhen me nevoja ditore vijuese apo të drejtpërdrejta në bashkësi siç janë kujdesi elementarë shëndetësor, përdorimi i ujit të cekët për pije, sanitacion, ndihma e parë në firma dhe në bashkësitë lokale.

Qëllimi është që të ngritet vetëdija e përditshme për mundësinë për paraqitjen e rreziqeve me çka njerëzit do të kenë mundësi të ndërmarrin masa të vetëdijshme të kujdesit. Ato duhet të jenë të vetëdijshëmse çka duhet të bëjnë në rast të katastrofave; të jenë të vetëdijshëm gjatë zgjedhjes së shtëpisë së tyre, vendosjes së ormaneve apo shporetëve në shtëpi, apo kualitetin e ndërtimit të murit rreth oborrit, që kontribuojnë për siguri më të mirë të njerëzve.

### **Ndalimi dhe trajtimi i diarësë në Bangladesh**

Mënyra më efektive për mbrojtjen e fëmijëve nga sëmundjet dhe epidemitë është që të kyçen nënat e tyre. Në shumë bashkësi, nënat janë siguresit dhe mbrojtësit tradicional të fëmijëve të tyre. Nëse këto fuqi natyrore të fuqishme përkrahen me edukimin elementar shëndetësor dhe nutritiv, nënat do të kujdesenë që fëmijët e tyre të vaksinohen, se do të mbajnë dietë, dhe se do të mund të përgatisin solucione të thjeshta me kripë dhe sheqer (solucion oral për rihidratim) në rast të diarësë – çka do t'i mbrojë fëmijët e tyre nga ndikimi i katastrofave dhe do të shpëtojë shumë jetë të rinjve.

Për shembull, në Bangladesh, fshataret trajnohen me porosi të përpiluara nga 7 hapa për preventivëdhe trajtim të diarësë dhe për mënyrën në të cilën mund të

përgatisin solucion për rihidratim oral në shtëpitë e tyre. Pastaj, ata shkonin prej fshati në fshat, prej dere në derë dhe i mësonin gratë tjera për këtë terapi të thjeshtë e cila mund të shpëtojë jetë. Në këtë mënyrë, u përfshinë 12 milion amvisëri – shumë largë se në cilën do mënyrë mund të përfshihen amvisëritë nëpërmjet shërbimit shëndetësor konvencional. Në këtë mënyrë ata u njoftuan për rëndësinë e terapisë orale për rihidratim dhe trajtimin e diaresë tek fëmijët.

*Rozmari Fejd, stop për katastrofat, numri 24, vit 1995*

Involvimi lokal në procese për planifikimin e uljes së rreziqeve mund të bëhet nëpërmjet mbledhjeve dhe konsultimeve publike, anketave publike; diskutimeve në vendime në mbledhje speciale dhe kyçje në përgatitjen e hartave për rreziqe dhe kapacitete. Në ngritjen e vetëdijes mund të punohet nëpërmjet ushtrimeve të rregullta, trajnimeve simuluese, kuizeve etj. Në spitale, shkolla dhe ndërtesa të mëdha, është patjetër të trajnohet se çka duhet të bëjnë banorët në rast të zjarrit, tërmetit apo rrezikut tjetër. Në këtë mënyrë ngritet vetëdija dhe raporti ndaj katastrofave.

## **6.2 Masa për planifikim fizik**

Rol i rëndësishëm në uljen e mjerueshmërisë është zgjedhja e kujdesshme e lokacioneve për objekte të reja – posaçërisht kur bëhet fjalë për shkolla, spitale dhe objekte tjera infrastrukturore. Në pjesët urbane dekoncentrimi i elementeve posaçërisht në rast të rreziqeve paraqet princip të rëndësishëm. Në fakt shërbimet të cilat sigurohen nga një lokacion qendror gjithmonë janë më të rrezikshme se sa shërbimet të cilat sigurohen nga më shumë objekte të vogla. Ky princip gjithashtu ka të bëjë edhe me dendësinë e popullatës: sa më i madh që të jetë koncentrimi i popullatës aq më të mëdha do të jenë edhe pasojat nga katastrofa.

## **6.3 Masa ekonomike**

Lidhshmëria mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë mund të ketë pasoja më të mëdha nga katastrofat se sa që do të jetë dëmi i infrastrukturës fizike. Llojllojshmëria e ekonomisë është mënyrë e rëndësishme për uljen e rreziqeve. Ekonomia e fuqishme është mënyra më e mirë për mbrojtje nga katastrofa. Tek ekonomitë e fuqishme, qeveritë mund të përdorin stimulime ekonomike për nxitjen e individëve apo institucioneve për të ndërmarë aktivitete për lehtësimin e katastrofave.

## **6.4 Masa për inxhinieri dhe ndërtim**

Masat e inxhinierisë mund të lëvizin nga punët vëllimore inxhinierike për përforcimin e ndërtesave individuale e deri tek projektet e vogla në bashkësi. Kodet për praktikimin e mbrojtjes gjatë katastrofave (siç janë rregullat e ndërtimtarisë) nuk do të jenë efektive vetëm nëse ato nuk pranohen dhe nuk janë të kuptueshme nga bashkësia. Komponenta kryesore e këtyre masave është trajnimi i sipërmarrësve lokal me teknikat të cilat inkorporojnë mbrojtje më

të mirë në strukturat tradicionale – siç janë ndërtesat, rrugët dhe ndërtimi i shtratit të rrjedhojave.

## **6.5 Masa për menaxhim dhe memorje institucionale**

Për ndërtimin e masave adekuate mbrojtëse gjatë katastrofave nevojitet kohë. Kjo bëhet nëpërmjet programit për edukim, trajnim dhe mbindërtim institucional të diturisë dhe kompetencave profesionale.

## **7. Strategji për uljen e rreziqeve**

Kjo pjesë është fokusuar në aktivitete specifike për uljen e rreziqeve lidhur me rreziqet në vijim:

- Tërmete
- Lëvizja e tokës
- Errupcione vullkanike
- Vërshime dhe rreziqe nga uji
- Fortuna (tajfune, uragane, fortuna tropikale dhe tornado)
- Thatësira dhe shkretëtira e tokës
- Fatkeqësi hemikale dhe inustriale

Për të gjitha këto rreziqe më poshtë janë paraqitur strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve dhe masa për uljen e rreziqeve në bashkësitë lokale. Strategjitë e përgjithshme për uljen e rreziqeve shpesh herë kushtojnë shumë para apo për ato nuk nevojiten zgjedhje të mëdha ligjore dhe për ato nevojitet përkrahje nga qeveria, sektori privat apo donatorët. Masat lokale kushtojnë më pak dhe promovojnë nevojën e resurseve dhe kapaciteteve të kapshme lokale.

### **7.1 Tërmete**

#### **Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve**

Ka disa strategji për lehtësimin e rreziqeve nga tërmetet. Strukturat ndoshta më mirë mund të zgjidhen me masa inxhinierike t'i përballojnë fuqitë vibruese dhe qeveritë mund të përgatisin zgjedhje ligjore për ndërtim seizmik dhe standarde më të larta të ndërtimeve konstruktive. Qeveritë gjithashtu të sigurojnë se ndërtesat publike të rëndësishme do të ndërtohen sipas standardeve më të larta seizmike. Masa plotësuese mund të jenë zbatimi i programeve për trajnim për përmirësimin e teknikave ndërtimore në industrinë ndërtimore si dhe zbatim të programeve për edukimin e opinionit për këto teknika.

Përskaj inxhinierisë strkturore, efektet e tërmeteve mund të lehtësohen nëpërmjet implementimit të planifikimit të lokacioneve për uljen e dendshmërisë urbane në pjesët gjeologjike ku ndjehen vibracione të fuqishme të tokës. Përskaj kësaj, duhet të ofrohen masa stimuluese për rrënimin e ndërtesave që

nuk janë të sigurta apo objekte në lokalitete të pa sigurta apo, që është edhe më lehtë, të përmirësohet niveli i sigurisë së tyre.

Fushatat për edukimin e opinionit me përkrahjen e qeverisë gjithashtu janë të rëndësishme. Pothuajse secili vend ka mjete për komunikim me popullatën lokale më të largët, apo nëpërmjet mediave apo nëpërmjet rrjeteve joformale komunikative. Mund të dizajnohen programe për ngritjen e vetëdijes së popullatës që të arrihet deri tek secili person i mjeruar me çka mundet dukshëm të ulen shpenzimet shoqërore dhe materiale të cilat do t'i shkaktonte ndonjë tërmet. Për shembull për informacione të cilat mundet të ndahen janë:

- Shkaqe për tërmete dhe sinjale për paralajmërim
- Ngritje të vetëdijes për rreziqet nga katastrofat dhe mënyra për minimalizimin e mjerueshmërisë të njerëzve
- Mënyra praktike për përforcimin e shtëpive të mjeruara
- Çka të ndërmerret në rast të tërmetit (me pjesëmarrje të mundshme në trajnime simuluese)?
- Si të formohen ekipe për përkrahjen dhe kërkimin e njerëzve të lënduar dhe aktivitete tjera për rimëkëmbje nga katastrofat?
- Trajnim për ndihmë të parë dhe pjesëmarrje të ekipeve për luftë kundër zjarreve

### **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Element kryesor për lehtësimin e pasojave nga tërmetet është ngritja e vetëdijes dhe pjesëmarrja e popullatës në bashkësitë lokale. Njohja e rreziqeve nga tërmetet dhe dëshira që të jetohet në shtëpi të cilat janë të sigurta nga fuqitë seizmike ndihmon në motivimin për ndërtimin e objekteve seizmike. Rëndësia se çka të bëhet në rast të tërmetit mund të përparohet nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime dhe programe për ngritjen e vetëdijes për mbrojtje nga tërmete. Gjithashtu mund të formohen ekipe lokale për luftë kundër zjarreve, kërkim dhe shpëtim dhe ndihmë të parë. Këto ekipe mund të jenë përgjegjëse për përgatitshmëri dhe mirëmbajtje të aparateve kundër zjarrit, mjeteve për ndërtimtari dhe pajisjeve tjera për mbrojtje civile.

Organizatrat dhe shërbimet lokale duhet të përgatisin plane për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave gjatë situatave emergjente. Plani duhet t'i përmbajë elementet dhe aktivitetet në vijim:

- Identifikimi dhe trajnimi i ekipeve për operacione për kërkim dhe shpëtim
- Sigurimi i qasjes në pajisjet për detektim
- Identifikimi dhe trajnimi i ekipeve për vlerësim gjatë katastrofave
- Identifikimi i lokaliteteve dhe strehimoreve të sigurta për situata emergjente ku mund të qëndrojë popullata e mjeruar



- Trajnimi i personelit për dhënien e ndihmës së parë
- Planifikimi i furnizimit alternativ me ujë
- Përgatitja e planeve për pastrimin e rrugëve për qasje emergjente
- Përgatitja e sistemeve dhe porosive emergjente komunikative në opinion lidhur me sigurinë e tyre
- Trajnimi i ekipeve që të vërtetohet se a janë ndërtesat e sigurta për banim
- Përgatitja e planeve për vërshime për fusha të dyshimta
- Kordinimi i aktiviteteve përgatitëse me organizata vullnetare

## 7.2 Lëvizja e dheut (Rrëshqitja e dheut, rrëshqitja e lloçit etj)

### Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve

Strategji primare për lehtësimin e pasojave nga rrëshqitja e dheut është planifikimi i lokaliteteve me qëllim që të tejkalohet shfrytëzimi i pjesëve të rrezikshme për banim apo për targetimin e strukturave të rëndësishme ndërtimore. Përkaj kësaj rreziku nga rrëshqitja e dheut mund të ulët nëpërmjet krijimit të këndeve më të cekëta të shpateve nëpërmjet grupimit të shtresave të sipërta të tokës; nëpërmjet rritjes së rrjedhës së ujit dhe rrjedhës sipërfaqësore; dhe nëpërmjet punëve ndërtimore të mbajtësve mbështetëse në tokë.

Shpatet dhe mbjellja e pyjeve gjithashtu mund ta ndalojë lëvizjen e materialit sipërfaqësor. Nëse pritët, mbeturinat mund të dërgohen në kanale dhe bariera të ndërtuara në mënyrë të posaçme për mbrojtje nga shembja e shkëmbinjëve siç janë rjetet, kanalet, tendat, me qëllim që të mbrohen lagjet.

Shumica e ekspertëve nuk mendojnë se është zgjedhje e mirë që të përforcohen objektet ekzistuese dhe infrastruktura për lehtësimin e dëmit nga rrëshqitja e dheut, për shkak se mjerueshmëria e strukturave të cilat janë të ndërtuara në rrugën ku është rrëshqitja pothuajse është 100 përqind. Përforcimi dhe masat mbrojtëse të këtyre lokaliteteve është e mundshme nëpërmjet kullimit të tokës, modifikimit të shpateve (ulja e këndit në shpate) dhe pylltarizimi i shpateve.

Muret e betonit gjithashtu mund të shërbejnë për stabilizimin e këtyre lokacioneve. Mund të merren edhe punë të mëdha inxhinierike për përforcimin e lokacionit.

Programet për edukimin e opinionit mund të përmbajnë përshkrim të situatave klimatike apo rreziqeve të cilat nxisin rrëshqitjen e dheut si dhe aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren kur ekzistojnë rrethana të tilla. Për këtë qëllim duhet të përgatiten dhe trajnohen plane për evakuim në pjesët të cilat janë në rrezik të madh, posaçërisht kur rreziku për dukurinë e rrëshqitjes së dheut është i lidhur mes veti me kërcënim të aktivitetit apo vërshimit seizmik dhe vullkanik.

## **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Rrëshqitjet më të rezikshme të tokës shpesh herë ndodhin si rezultat i aktiviteteve të njerëzve. Shkaqe të shpeshta për paraqitjen e rrëshqitjes së dheut janë ndërtimi i rrugëve, shtëpive, dhe objektet tjera infrastrukturore. Për këtë masa më efektive për përgatitshmëri janë ato masa të cilat ndërmerren para se të shpërngulen njerëzit në një pjesë të caktuar të ndishme. Programet për edukimin e opinionit ndihmojnë që njerëzit t'i kuptojnë shkaqet dhe efektet e vendeve që rrëshqasin si dhe sigurimi i përkrahjes së njerëzve për identifikimin e pjesëve jo stabile dhe shmangimi i shpërnguljes së tyre.

Bashkësitë duhet të trajnohen që të njohin vende potenciale jostabile, të identifikojnë fusha aktive ku ndodh rrëshqitja e tokës dhe të shmangin ndërtimin e shtëpive në lokalitete të rrezikshme. Përkaj kësaj, bashkësitë mund të ulin rrezikun nga rrëshqitja e tokës nëpërmjet ndërtimit të strukturave me bazamente të forta, në sipërfaqe të fortë, ndaljen e prerjes së pyjeve në shpate, stabilizim të shpateve nëpërmjet ndërtimit të teracave dhe mbjelljen e drunjëve dhe ndërtimin e barrierave me drunj edhe me dhe.

Pjesët për të cilat ekziston dyshim se mund të jenë të goditura nga rrëshqitja e dheut patjetër duhet të vëzhgohen që të mundësohet paralajmërim dhe evakuim në kohë. Metodot për monitorim nënkuptojnë vëzhgimin e terrenit dhe matjen e dridhjeve dhe vendosjen e gardheve apo rrjeteve elektrike për mbajtjen e dheut. Shpërndarja emergjente e informacioneve është shumë me rëndësi në vende të cilat janë të nënshtruara në rrënim apo rrëshqitje të tokës. Në raste të tilla nevojitet përdorimi i mediave apo sistemeve tjera informative.

Sistemet për vëzhgim dhe paralajmërim duhet rregullisht t'i informojnë banorët kur ka të rreshura të shumta të shiut dhe kur ngritet niveli i sistemeve të lumenjëve.

### **7.3 Errupsione vullkanike**

#### **Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve**

Metodat potenciale për uljen e ndikimit të shpërthimeve vullkanike kyçin planifikimin e lokacioneve që të sigurohet se pjesët të cilat janë në afërsi të vullkanit nuk duhet të përdoren për aktivitete të rëndësishme dhe për ndërtimin e kanaleve, tendave apo kahëzim tjetër të lavës dhe rrjedhës së mbeturinave larg vendeve të banuara nëpërmjet përdorimit të punëve inxhinierike. Vëzhgimi i vullkaneve është shumë me rëndësi dhe mund të sigurojë informacione të rëndësishme për aktivitetin vullkanik.

Rreziqet të cilat dalin nga shpërthimet vullkanike gjithashtu mund të ulen nëpërmjet promovimit të strukturave kundër zjarrit si dhe strukturave inxhinierike të cilat do ta përballojnë ngarkesën plotësuese të hirit.

## **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Bashkësitë luajnë rol të rëndësishëm në lehtësimin e rreziqeve nga shpërthimet vullkanike. Anëtarët e bashkësisë duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet vullkanike dhe duhet t'i identifikojnë zonat potenciale të rrezikshme. Përkaj kësaj, bashkësitë dhe familjet mund të përgatisin dhe të ushtrojnë plane për evakuim. Këtu duhet të përmbahen edhe sistemet për monitoring dhe paralajmërim të hershëm që të alarmohet popullata lokale gjatë shpërthimeve.

### **7.4 Vërshime dhe rreziqet nga uji**

#### **Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve**

Strategjitë kryesore për uljen e rreziqeve nga vërshimet dhe rreziqet nga uji kycin kontrollimin e përdorimit të truallit si dhe planifikim të përdorimit të truallit me qëllim që të shmanget targetimi i kapaciteteve të ndishme në fusha të cilat mund të jenë të përmytura. Muret dhe kanalet përkaj lumenjve dhe muret e detit nëpër brigje mund t'i mbrojnë fushat nga përmytjet.

Strukturat të cilat janë të targetuara në fusha duhet të ndërtohen në mënyrë e cila do të mundësojë rrezistencë nga uji i vërshuar dhe të ketë dysheme të ngritura që të ulet dëmi nga përmytjet. Digat janë të rëndësishme për grumbullimin e ujit që të mundes pastaj të lëshohet me shpejtësinë e dëshiruar. Digat mund të dëmtohen nga tërmetet. Prandaj patjetër duhet të ndërtohen me kujdes që të jenë të aftësuara të mbajnë nivele maksimale të ujit për shkak se nëse bëhen gabime ato do të shkaktonin dëm më të madh se sa po të mos ishin aspak.

Rregullimi i ujit (ngadalësim të sasisë së ujit i cili rrjedh nëpër një fushë të caktuar) mund të bëhet nëpërmjet ndërtimit të rezervoareve, rritja e vegjetacionit dhe ndërtimi i sistemeve për rrjedhjen e ujit. Heqja e llumit apo gropimi i kanaleve më të thella dhe ndërtimi i rrugëve alternative për drenazhë (kanale të reja të lumenjve dhe sisteme me gypa) mund të parandalojë derdhjen e lumenjve.

Masat preventive për mbrojtje nga përmytjet mund ta ulin rrezikun nga dëmet. Masa kohore mund të jenë bllokimi apo mbyllja e hyrjeve apo dritareve dhe përdorimi i thasëve me rërë për të ndalë hyrjen e ujit. Masa të përhershme mund të jenë përdorimi i konstruksioneve të dizajnuara rrezistuese në rrezik nga përmytja siç janë ndërtimi i objekteve lartë mbi nivelin e mundshëm të përmytjes.

Shtëpitë mund të ngriten nëpërmjet mjeteve strukturore (platforma) apo nëpërmjet ngritjes së nivelit të tokës me plotësimin e tokës. Ndërtimet duhet të jenë më largë sipërfaqeve të ujit. Toka rreth ndërtimeve dhe infrastrukturës duhet të jetë e mbrojtur nga erozioni. Shtratet duhet të stabilizohen me konstruksione të murit apo vegjetacionit, posaçërisht në afërsi të urave.

## **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Pjesa më e madhe e rasteve të vdekjes dhe destruktimit shkaktuar nga përmbytjet mund të ndalohet me masa për përgatitshmëri. Bashkësitë mundet në mënyrë aktive të kyçen në uljen e rreziqeve nga përmbytjet. Kur ka nevojë ndërtimi i objekteve në fusha të nënshtruara në përmbytje shtëpitë duhet të ndërtohen me materiale të cilat janë rrezistuese nga dëmi i ujit dhe të kenë bazamente të fuqishme.

Ngritja e vetëdijes për rreziqe nga uji mund të reflektohet në praksat e jetës si për shembull ndërtimi i pjesës për të fjetur dhe për renditjen e gjërave ushqimore në shtëpi në nivelet më të larta. Ciklet e mbjelljes së drithërave mund të modifikohen që të shmangen sezonat e vërshimeve dhe duhet të mbjellen kultura të cilat janë rrezistuese në përmbytje. Anëtarët e bashkësisë gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshme se prerja e pyjeve do ta rrisë mundësinë nga vërshimet.

Bashkësitë mund ta ulin rrezikun nga dëmet nëpërmjet përgatitjes së planeve për evakuim në rast të përmbytjeve në të cilat do të përcaktohen kahjet për evakuim si dhe orarin e barkave apo llojit tjetër të transportit dhe pajisjes për shpëtim. Sistemet për monitorim dhe paralajmërim në nivel lokal dhe rajonal gjithashtu janë të komponente të rëndësishme të strategjisë për uljen e rreziqeve.

Popullata në pjesët e nënshtruara në përmbytje zakonisht ka metoda të caktuara tradicionale për ballafaqim me përmbytje. Disa aspekte nga planifikimi dhe veprimi gjatë vërshimeve mund të menaxhohen në nivel të bashkësisë dhe të mbindërtohen me ndihmën e jashtme. Ato janë:

- Shpallja e paralajmërimit në nivel lokal
- Pjesëmarrje në luftën kundër vërshimeve nëpërmjet organizimit të grupeve punuese për meremetimin e pendave apo pastrim të bërllugut, renditje të thasëve me rërë dhe aktivitete tjera.
- Sigurimi i përkrahjes për meremetimin e sipërfaqeve bujqësore të goditura
- Planifikimi i rezervave emergjente me ushqim dhe ujë të pastër për pije
- Identifikimi i masave tradicionale për përgatitshmëri dhe vërtetim të efikasitetit të tyre

Programet për ngritjen e vetëdijes tek opinioni për rreziqe nga vërshimet mund t'i përmbajnë komponentat në vijim:

- Sqarim për funksionimin e lëndinave të cilat mund të përmyten, lokalitetin e tyre dhe skemave për derdhjen e ujit.
- Identifikimi i rreziqeve nga përmbytjet dhe sinjalet për paralajmërim.
- Këshilla për sigurimin e patundshmërisë nga përmbytjet dhe përgatitja e planeve personale për evakuim.

- Sqarim të planeve lokale për evakuim dhe sistemet për paralajmërim, dhe këshilla adekuate në periudhën pasi të ndodhë katastrofa.
- Theksi i përgjegjësisë personale për parandalim të përmytjeve / lehtësim të përmytjeve në praksat e jetës së përditshme. Këtu nënkuptohen praksa adekuate bujqësore, preventivë në shkatërrimin e pyjeve dhe mirëmbajtje të sistemeve për derdhjen e ujit.
- Sigurim të rrugëve për evakuim – në çdo lagje duhet të ketë rrugë të theksuara qartë për evakuim dhe lokalitete të theksuara të sigurta më të larta ku mund të strehoet popullata.
- Procedurat për evakuim duhet të ushtrohen në bazë të rregullt si dhe mënyrat për diseminimin e paralajmërimeve nëpërmjet radios, televizionit, sirenave dhe zileve për alarmim.

## **7.5 Stuhi (tajfune, uragane, stuhi tropikale dhe tornado)**

### **Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve**

Strategjitë kryesore për uljen e rreziqeve nga stuhitë nënkuptojnë opinion mirë të informuar në bazë të rrezikut dhe ekzistimit të sistemit efektiv për paralajmërim. Është shumë me rëndësi të ekzistojnë struktura inxhinierike të cilat do të mund të përbaljnë fuqitë e erës në pajtueshmëri me normat për qëndrueshmëri të erës për elemente strukturore dhe jo strukturore. Përskaj kësaj, është shumë me rëndësi që objektet kryesore të targetohen në pjesë më pak të mjerueshme, mbjellje të drunjëve që të ulet rreziku nga stuhitë.

Gjithashtu është shumë me rëndësi që objektet publike të mund të përballojnë erë të fuqishme dhe në to të mund të ndërtohen strehimore që të ulet rreziku për jetën e njerëzve të cilët jetojnë në shtëpi të pasigurta. Gjithashtu kullosat mund të mbrohen nëpërmjet sjelljes së praksave bujqësore dhe kulturave të cilat janë më rrezistuese në erërat e fuqishme.

### **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Bashkësitë mund të ndihmojnë në uljen e rreziqeve nga ndodhja e dëmeve nga stuhitë nëpërmjet përgatitjes së planeve për evakuim dhe sistemeve për paralajmërim të cilat do të aplikoheshin në rast stuhie; nëpërmjet ndërtimit të objekteve kundër erërave; nëpërmjet sigurimit dhe përforcimit të elementeve të cilat mundet lehtë të fluturojnë dhe të shkaktojnë dëme apo lëndim në vend tjetër, siç janë teneqet, gardhet dhe shenjat e komunikacionit; nëpërmjet ndërtimit të strehimoreve në objekte të fuqishme dhe rrezisatuese ndaj erës; nëpërmjet ndërmarjes së masave mbrojtëse për objektet lundruese, objekteve ndërtimore; dhe nëpërmjet mbrojtjes së objekteve për renditje të ushqimit nga stuhitë.

## **7.6 Thatësira dhe shkretëtimi i tokës**

### **Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve**

Edhe pse nuk mundemi t'i kontrollojmë të rreshurat e shiut, thatësitat dhe shkretëtimin e tokës mund të ulen nëpërmjet praksave më të mira të përdorimit të tokës dhe menaxhimit të resurseve të ujit, siç janë sjellja e praksave për kursimin e ujit, ndërtimin e sistemeve për ujitje, menaxhim me pyjet dhe kontrollimin e përdorimit të tokës si dhe skemat për të kullosur bagëtia.

Strategjia kryesore për uljen e rreziqeve nga thatësitat dhe shkretëtimi i tokës është përdorimi racional i ujit, konservimi i tokës dhe ulja e erozionit nëpërmjet ndërtimit adekuat të pendave, nivelimit, ndërtimit, uljes së prerjes së drunjëve për nxemje, sjellje të skemave fleksibile për bujqësi dhe mbjellje të kulturave, ngritje të vetëdijes për beneficione nga kontrollimi i popullatës, dhe zhvillimi i programeve edukative dhe programeve për trajnim.

### **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Bashkësitë mund të ndërtojnë penda adekuate për kontrollim, rezervoare për ujë dhe të bëjnë tentime për mbjellje adekuate të kulturave dhe pyjeve që të ulen rreziqet nga thatësitat dhe shkretëtimi i tokës. Gjithashtu mund të ndryshohen skemat për mbjelljen e kulturave dhe ruajtjen e bagëtisë adekuate, sjelljen e politikave për kursimin e ujit, ndërtim të puseve më të mira, sjelljen e sistemit të mirë për ujitje dhe sjelljen e industrive alternative jobujqësore.

## **7.7 Fatkeqësi kimike dhe industriale**

### **Strategji të përgjithshme për uljen e rreziqeve**

Katastrofat teknologjike mund të ulen nëpërmjet përmirësimit të standardeve për sigurim në fabrika dhe përdorim të pajisjes më të mirë, me parashikim të rreziqeve të mundshme në pajtueshmëri me dizajnin e fabrikës, nëpërmjet përgatitjes së procedurave adekuate operative, nëpërmjet mënjanimit të sigurt dhe të rregulluar të materieve të rrezikshme, dhe nëpërmjet planifikimit adekuat të masave për përgatitshmëri.

Përskaj kësaj strategjitë për uljen e rreziqeve kyçin edhe përdorimin e materialeve kundër zjarrit, ndërtimin e barrierave kundër zjarrit apo instalimin e pajisjeve për tërheqjen e tymit, përmirësimin e detektorëve dhe sistemeve për paralajmërim, planifikim më të mirë nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve për luftë kundër zjarreve dhe ndotjes, dhe planifikim për sigurimin e ndihmës emergjente dhe evakuimin për të punësuarit në fabrika dhe lagje në rrethin e tyre. Përskaj kësaj rregullisht duhet të aplikohen trajnime në bashkëpunim me shërbimin zjarrfikës lokal dhe shërbime tjera në bashkësi.

Efektet e katastrofave teknologjike mund të ulen nëpërmjet sigurimit të listave dhe hartave të sakta në bazë të lokacioneve ku janë të vendosura materie

toksike / t[ rrezikshme dhe karakteristikat e tyre me qëllim që të njoftohen dhe informohen personat të cilët sigurojnë përgjigje në katastrofat teknologjike.

Për këtë qëllim është e nevojshme që të ketë dituri për natyrën e kemikaleve por nevojitet edhe që të ketë të dhëna për fatkeqësi që kanë ndodhur në të kaluarën. Përkaj kësaj, hapat të cilat ndërmerren për kufizimin apo uljen e kapacitetit për renditjen e kemikaleve të rrezikshme apo që ndizen lehtë do ta ulë mundësinë për katastrofë teknologjike.

### **Masa për uljen e rreziqeve në bashkësi**

Bashkësitë duhet të marrin pjesë në aktivitete për përcjelljen e ndotjes, të ndërprejnë infeksione dhe standarde për siguri dhe të punojnë në planin e përmirësimit të rregullores për siguri. Ato gjithashtu duhet të përgatisin plane për evakuim të cilat duhet të përcjellen në rast të katastrofave teknologjike si dhe për rregullimin e rrugëve transportuese për bartjen e materieve të rrezikshme larg shkollave dhe pjesëve rezidenciale të banuara. Liderët lokal dhe shërbimet gjithashtu kanë rol të rëndësishëm në bazë të fatkeqësive kimike dhe industriale. Ato i përfaqësojnë qytetarët e tyre. Obligimet e tyre janë:

- Komunikim me pushtetet lokale dhe liderët e industrisë në bazë të çështjeve lishur me mirëqenien e popullatës lokale
- Komunikime me qytetarët për programe lidhur me mbrojtjen e shëndetit lokal dhe mjedisit jetësor
- Nxitje të organizatave lokale të marrin pjesë dhe aplikojnë trajnime për siguri dhe përgatitshmëri

## **MODUL PËR NGRITJEN E VETËDIJES PËR PËRGATITSHMËRI GJATË KATASTROFAVE NË BASHKËSI**

### **Hyrje**

Ky modul është një prej dy moduleve të cilat janë përgatitur nga ana e Njësisë për përgatitshmëri gjatë katastrofave të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në Gjenevë. Ky modul mund të përdoret si studim i pavarur, si udhëzim i temës dhe për sigurimin e trajnimit për pjesëmarrës në seminare me temë përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave.

Qëllimi i këtij dokumenti është që ta përdorin planifikuesit dhe profesionistët e sferës së përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave dhe situatave emergjente në Federatë dhe në shoqatat nacionale. Këto module gjithashtu mund të jenë interesante edhe për organizatat joqeveritare të interesuara për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave, agjenci qeveritare për menaxhim me situata në krizë, komisione lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe njësi për trajnim me temë mbrojtja civile.



Materiali mund të përdoret si:

- Material i përgjithshëm referent për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave
- Për trajnimin e trajnuesve dhe për pjesëmarrësit në seminare me temë përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave
- Si mjet për zbatimin e trajnimit orientues për delegatë dhe nëpunës për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave
- Si udhëzim apo planifikim të aftësive për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave

Ky material bazohet në qasjen për studimin e rreziqeve dhe katastrofave të ndryshme, dhe para se gjithash ka për qëllim të zbatohet në sferën e përmirësimit të përgatitshmërisë gjatë situatave të ndryshme në krizë dhe të rrezikshme. Megjithatë, në çdo vend mund të ketë kontekste të ndryshme specifike prandaj pjesë të ndryshme të moduleve duhet të zbatohen sipas kontekstit specifik dhe situatës në gjendjen e dhënë.

Modulet dhe shënimet për trajnuesit janë dedikuar që të përdoren gjatë zbatimit të trajnimeve dhe seminareve për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave por pjesëmarrësit nxiten ta përdorin dhe adaptojnë materialin në pajtueshmëri me nevojat lokale në shtetet e tyre.

Dy modulet që e përbëjnë këtë doracak janë:

1. Hyrje në përgatitshmëri gjatë katastrofave
2. Planifikimi i aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave
3. Ulje e rreziqeve
4. Ngritja e vetëdijes për katastrofat në bashkësi
5. Vlerësim të nevojave emergjente gjatë katastrofave
6. Informim dhe lajmërim në katastrofa
7. Përmirësim në koordinim
8. Përmirësim i aftësive themelore për trajnim
9. Planifikim të projekteve

### **Elemente kryesore të këtij moduli**

- Qasje dhe strategji për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi
- Tema të shpeshta të cilat duhet të merren parasysh gjatë ngritjes së vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi
- Media dhe porosi për komunikim efektiv me opinionin



- Hapa themelore gjatë planifikimit të iniciativave për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave
- Ndhimë për identifikimin dhe analizën e grupeve qëllimore të cilat do t'i marin porositë për katastrofën
- Shembuj dhe ide për ngritjen e vetëdijes së opinionit për katastrofa dhe uljen e rreziqeve

## 1. Hyrje

### 1.1 Çka është ngritja e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi?

Iniciativat për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi të cilat ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e popullatës lokale në bazë të asaj se si të përgatitet për katastrofa natyrore dhe situata emergjente mund ta ulë mjerueshmërinë e popullatës ndaj rreziqeve të caktuara. Këto iniciativa nuk obligojnë nevojë për mjete financiare të mëdha por as që kërkojnë angazhimin e numrit të madh të njerëzimit. Kjo që është e nevojshme është që të ekzistojë strategji për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi e cila është oportunistike në bazë të periudhës dhe e cila është e integruar me strategjitë tjera lokale zhvillimore në bashkësi.

Iniciativat për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi mund të jenë të përpiluara nga aktivitete individuale – siç janë për shembull vizitat në teren nëpër fshatra për mbajtjen e mbledhjeve për ngritjen e vetëdijes për rreziqe nga tërmetet, apo ngjitja e pamfletave për përgatitshmëri gjatë tërmeteve në objektet e bashkësisë.

Qasje tjetër për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi është që të planifikohet mori e aktiviteteve të koordinuara – për shembull, fushatë gjithëpërfshirëse për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi mund të implementohet gjatë një jave të caktuar për aktivitete për ngritjen e vetëdijes për rreziqe nga katastrofat, me çka mediat do të shpallin porosi të ndryshme për katastrofa në radio, TV, dhe në gazeta; mbajtjen e trajnimeve për përgatitshmëri gjatë katastrofave në shkolla; theksimin e postereve në ndërtesat e komunave.

Qasja e tretë, dhe me siguri më efektive në nivelin e bashkësisë. Është strategjia e cila integron ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave në bashkësi në kuadër të qëllimeve më të gjëra shëndetësore dhe zhvillimore të bashkësisë – për shembull në Afrikën lindore bëhen tentime që të ngritet niveli i përgatitshmërisë nëpërmjet programeve për ndihmë të parë në bashkësitë lokale.

## **1.2 Planifikimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për rreziqe nga katastrofat me qëllim që të sigurohet ndikimi maksimal**

Planifikimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofat dhe përgatitjen gjatë katastrofave, izoluar nga kujdesi ditor dhe i përditshëm të njerëzve rrallë do të ketë sukses. Kjo ndodh si rezultat i asaj që interesi i njerëzve për përgatitshmëri gjatë katastrofave ulet nës ka kaluar periudhë e gjetë mes ndodhjes së katastrofave të caktuara.

Prandaj, aktivitetet për ngritjen e vetëdijes për rreziqe nga katastrofat do të kenë ndikim nëse integrohen në strategji më të gjëra programore që kanë për qëllim t'i tejkalojnë problemet dhe rreziqet e përditshme në bashkësi – siç janë kujdesi themelor shëndetësor, mungesa e ujit, mungesa e vendeve sanitare, mosgrumbullimi i bërlllogut, ndihma e parë në bashkësi dhe në vendin e punës.

Edhe pse bashkësia mund të jetë shpesh e shfaqur në rreziqe të ndryshme natyrore dhe teknologjike, shpesh herë në realitet njerëzit mund të mos e shikojnë praksën e rekomandimeve dhe porositë në pjesën e përgatitshmërisë gjatë katastrofave kur mundohen të ballafaqohen së bashku me familjet e tyre në rrethana të rënda ekonomike. Edhe pse ky modul fokusohet posaçërisht në porosi për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri gjatë katastrofave, është me rëndësi që shoqatat nacionale të studiojnë mënyra për integrimin e këtyre porosive në qasje gjithëpërfshirëse për edukimin e bashkësisë.

Për shembull, në Karaibe, disa shoqata nacionale ndihmojnë në formimin e komiteteve për menaxhim në bashkësitë të cilat kanë përgjegjësi për zbatimin e aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe për adresimin e nevojave të tjera të ndryshme në bashkësi – siç është zgjidhja e konflikteve apo grumbullimi i mbeturinave.

Vullnetarët dhe të punësuarit e shoqatave nacionale të cilët kanë përgjegjësi formale për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në bashkësi gëzojnë kredibilitet më të madh tek popullata lokale dhe e kanë më lehtë të diskutojnë në tema lidhur me përgatitshmërinë gjatë katastrofave gjatë angazhimit të tyre në jetën e bashkësisë.

## **2. Tema dhe propozime komunikimi për ngritjen e vetëdijes për katastrofa**

### **2.1 Tema**

Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në bashkësi në përgjithësi lidhen me një rën prej apo më shumë temave në vijim:

- Katastrofa potenciale, situata emergjente dhe rreziqe specifike për rajonin, dhe efektet e tyre
- Masa me buxhet të ulët të cilat mund t'i ndërmerr popullata lokale për ndalimin dhe përgatitje për katastrofa dhe situata emergjente
- Masa të cilat i ndërmerr qeveria dhe shërbimet zyrtare dhe menaxhuesit për katastrofa dhe situata emergjente për ndalim, përgatitje dhe përgjigje në katastrofa

- Sistemet zyrtare për paralajmërim publik dhe informim gjatë katastrofave, rrugë për evakuim, strehimore të përkohshme dhe si e kur këto informacione komunikohen.

## 2.2 Propozime komunikimi

Porositë për ngritjen e vetëdijes për katastrofa varen nga publiku qëllimo dhe media e cila përdoret (shembull: broshurë, poster, reklama në gazetë). Planifikuesit për ngritjen e vetëdijes për katastrofa patjetër duhet ta kuptojnë grupin e vet primar qëllimor – gjegjësisht personat të cilët do t'i pranojnë dhe veprojnë sipas informacioneve lidhur me ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Përskaj kësaj planifikuesit duhet të përcjellin udhëzime të caktuara elementare komunikimi për katastrofat, të cilat përmbajnë:

- Natyrë dhe potencial të rrezikut
- Elementet e njeriut dhe fizike të cilët janë më të mjeruar apo më të shfaqur në rrezik
- Aksione sigurie për ndalimin dhe përgatitje për katastrofë potenciale
- Aktivitete sigurie dhe për mbijetesë të cilat duhet të ndërmerren kur të ndodhë katastrofa
- Aktivitete sigurie dhe për mbijetesë dhe aktivitete për rimëkëmbje të cilat duhet të ndërmerren pasi të ndodhë katastrofa
- Burime zyrtare të cilat duhet të kontaktohen për marjen e informacioneve plotësuese
- Shpalljet për ngritjen e vetëdijes për katastrofa duhet që popullatës t'i sigurojnë ndjenjën e kontrollit. Përskaj kësaj që popullatës do t'i tregohet për rrezikun, me rëndësi është që t'i sigurojnë edhe rekomandime praktike që do t'i ndihmojnë popullatës të ballafaqohet dhe ta ulë ndikimin e rrezikut. Informacionet duhet të jenë të prezantuara në zhargon të thjeshtë, joteknik dhe joshkencor. Porositë duhet të jenë të drejtpërdrejta dhe të shkurta. Duhet të përdoren edhe grafikone dhe fotografi që të ilustrohen pikat kryesore të aksionit. Në rrethana ideale, organizata të ndryshme për përgatitshmëri gjatë katastrofave do të duhej të sigurojnë porosi të ngjajshme për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në bazë të asaj se si popullata duhet të përgatitet dhe çka të bëjë pasi të ndodhë katastrofa.

## 3. Planifikimi i iniciativave për edukimin e opinionit

Planifikimi i drejtë është kyç për fillimin e iniciativave të suksesshme për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Në këtë pjesë janë përfshirë hapat si në vijim për planifikimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa:

1. Definimi i qëllimeve të iniciativës për ngritjen e vetëdijes për katastrofa
2. Selektimi dhe analiza e publikave primare
3. Formimi i ekipit për planifikimin e ngritjes së vetëdijes për katastrofa

4. Formim i partneriteteve për bashkëpunim në bashkësi
5. Organizimi i kohës dhe lokaliteteve për ngjarje për ngritjen e vetëdijes për katastrofa për realizimin e ndikimit maksimal
6. Diskutim i aktiviteteve dhe resurseve potenciale
7. Vërtetim të medias adekuate apo formatit
8. Përgatitje, implementim dhe përcjellje të planit për aksion

Përskaj kësaj në aneksin 1 është paraqitur edhe lista punuese që duhet të përdoret si udhëzim për planifikimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa.

### **3.1 Definimi i qëllimeve të iniciativës për ngritjen e vetëdijes për katastrofa**

Planifikimi duhet të fillojë nëpërmjet vërtetimit të qëllimit kryesor dhe rezultateve të pritura nga iniciativa për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Duhet të vërtetohet se iniciativa a është përbërë nga aktiviteti i izoluar, mori aktiviteteve, apo fushatës koordinuese për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Qëllimi kryesor tregon se çka dëshironi të realizoni deri sa rezultatet e pritura ofrojnë tregues specifik për matje.

Për shembull, nëse qëllimi kryesor është që të rritet rëndësia e fëmijëve për siguri nga zjarret në shtëpi, atëherë rezultat i pritur mund të jetë ligjëratë e mbajtur nga zjarrfikësi në 3 shkolla në afat prej 6 muajve të ardhshëm. Rezultat tjetër që pritet mund të jetë organizimi i përbashkët i garës nga ana e Kryqit të kuq dhe mbrojtjes civile për fëmijë për përgatitjen e postereve për mbrojtje nga zjarret gjatë *Javës për ngritjen e vetëdijes nga zjarret*.

Edhe pse qëllimi kryesor i iniciativës duhet të jetë ngritja e vetëdijes së opinionit, rezultatet e pritura do të varen nga natyra e të gjithë publikut. Në shembullin e mëparshëm nxënësit mund të mësojnë për rreziqet të cilat mund të ndodhin nëse luajnë me zjarr përskaj objekteve të cilat ndizen lehtë. Pronarët e shtëpive, nga ana tjetër mund të nxiten të blejnë detektorë për tym dhe aparate kundër zjarrit. Për secilën publikë, patjetër të pyeten 2 pyetjet në vijim:

1. Çka duhet të kuptojë publiku specifik?
2. Cilat aktivitete mund t'i ndërmarrin?

### **3.2 Selektimi i bashkësive qëllimore dhe publikut primarë**

Secila shoqatë nacionale duhet të dijë se cilat bashkësi dhe rajone në vend janë më të mjerueshme në katastrofa. Atëherë mund të ndërmerren aktivitete për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në bashkësi në këto bashkësi dhe rajone. Selektimi mund të bëhet në bazë të lokalitetit të bashkësisë në zonë shumë të mjeruar të shfaqur në rreziqe, qasja në rast katastrofe, historia e kaluar lidhur me katastrofat dhe resurset lokale. Pasi të identifikohen bashkësitë prioritare, mund të përgatiten strategji specifike për adresimin e nevojave në këto bashkësi.

Ka shumë mënyra për kategorizimin e segmenteve të ndryshme të popullatës. Secila situatë obligon lloj të ndryshëm të segmentimit. Kategoritë e publikave primare mund të jenë:

- Punëtorë me profesione të ndryshme
- Fëmijë
- Mësimdhënës
- Gra, kryefamiljarë
- Liderë të fshatit
- Biznesmenë
- Adolehentë
- Kryefamiljarë
- Persona të moshuar
- Grupe profesionale

Për shkak se resurset janë të kufizuara dhe nuk mund të përfshihen i gjithë publiku, planifikuesit për ngritjen e vetëdijes për katastrofa duhet të vërtetojnë se cili publik është prioritarë në bazë të marjes së porosisë. Për shembull, planifikuesit mund të vendosin që cak të jenë personat të cilët janë më të shfaqur në rrezik siç janë për shembull fëmijët, personat e moshuar, individë fizik dhe të hendikepuar mental, apo persona me arsim të kufizuar.

### **3.2.1 Analiza e nevojave të publikut primar**

Pasi të identifikohet publiku primar duhet të mundohen të gjejnë sa më shumë që mundet se cilat janë nevojat specifike, gjërat të cilat i parashikojnë dhe karakteristikat e publikut qëllimor. Sa më shumë që dihet për publikun qëllimor, aq më mirë mund të dizajnohet dhe në kohë të dërgohet porosia. Që të sigurohet ndikimi maksimal është mirë të dihen gjërat në vijim:

- Çfarë njerëz e përbëjnë këtë grup? A janë ata fëmijë, të rritur, persona të moshuar, studentë, punëtori të ndërtimtarisë, drejtorë, njerëz të arsimuar me fakultet, të vetmuar, persona të martuar?
- Cilat janë karakteristikat dhe nevojat speciale të këtij grupi? Merrni parasysh faktorët siç janë në moshë, arsimim dhe nivel të arsimimit, gjinisë, profesionit, motivimit, interesave kulturore dhe sociale, aktivitete dhe opzione të preferuara për argëtim.
- Çka din grupi për katastrofa?
- Nga cilat burime grupi në mënyrë tipike i merr informacionet: gazeta, televizione, radio, postë, takime publike, nga njeriu prej njeriut?
- Cilët janë personat më me ndikim për këtë grupë: mësimdhënës, prindër, farefis, liderë? A ka njerëz të tjerë në bashkësi të cilët i dëgjin dhe respekton grupin (për shembull: persona të moshuar apo shenjteri)?

Informacionet për publikun primar mund të merren nga burime të ndryshme. Në mënyrë ideale, duhet të organizohen intervista sy më sy apo mbledhje me përfaqësues të grupit qëllimor. Kur nuk është e mundur duhet të përdoren burime sekondare të informacioneve. Për shembull, nëpërmjet iniciativës për ngritjen e vetëdijes për katastrofa është drejtuar kah nxënësit e rinj, planifikuesit për ngritjen e vetëdijes për katastrofa mund të flasim me arsimtarët e fëmijëve.

Burime tjera të informacioneve mund të jenë shërbime lokale sociale, agjenci, shkolla, grupe të fqinjëve apo bashkësisë, organizata fetare, shërbimi zjarrfikës, radio stacionet lokale dhe gazetat, përfaqësues të mbrojtjes civile në bashkësi dhe të tjerë të cilët kanë aplikuar aktivitete për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Publiku primar më mirë do ta pranojë porosinë nëse porosia është e thurur sipas nevojave të situatës së publikut.

### **3.3 Formimi i ekipit për planifikim**

Nëse një person i caktuar merr detyrë të planifikojë iniciativë për ngritjen e vetëdijes për katastrofa, ai/ajo mund ta fillojë më përgatitjen e listës së njerëzve të cilët mund të jenë të interesuar që të kyçen në ekipin për planifikim. Gjëja në vijim, mund të shihet se çka mund të ofrojë secili person si për shembull: ekspertiza, koha vullnetare, aftësitë financiare, kontaktet dhe rrjetet profesionale, sponsorizimi, dhe përkrahja financiare. Përfundimisht ata të cilët do të jenë më së shumti në dobi dhe të cilët do të jenë të përkushtuar për punë të përbashkët, duhet të ftohen që t'i bashkangjiten ekipit.

Individët në ekipën për planifikimin e ngritjes së vetëdijes për katastrofa nuk duhet të jenë profesionistë në rradhën e personave përgjegjës për menaxhim në situata emergjente. Në ekipë mund të kyçen zjarrfikës apo persona përgjegjës për mbrojtje civile, por gjithashtu edhe mësimdhënës, persona të respektuar të bashkësisë, biznesmenë apo liderë, prindër dhe vullnetarë. Kyçja e njerëzve me prapavijë dhe përvojë të ndryshme mund të ketë shumë përparësi mes cilave:

- Qasje në numër më të madh të liderëve
- Ndarje të përgjegjësisë të punës mes njerëzve
- Zgjerim të rrjetit të kontakteve potenciale, përkrahësve dhe sponsorëve

Ekipi patjetër të përbëhet nga entuziastë të cilët mund të ndihmojnë në planifikimin dhe promovimin e orvatjeve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Ideale, dikush prej publikut primar për ngritjen e vetëdijes për katastrofa duhet të jetë në ekipin apo të jetë i kapshëm ta këshillojë ekipin. Në vende të vogla në fillim ka mundësi të jetë e patjetërsueshme të formohet ekip për planifikim në nivel nacional që të sigurohet bashkëpunimi në teren.

Shpesh herë organizatat në bashkësi kanë resurse të kufizuara dhe mundësia është më e madhe se do të garojnë se sa të bashkëpunojnë vetëm nëse procesi i planifikimit sanksionohet në nivel nacional.

Edhe pse është e rëndësishme të ketë së paku dy apo tre njerëz në ekipin kryesor për planifikim të cilët mund të sigurojnë udhëheqësi dhe vazhdimësi gjatë procesit të planifikimit dhe implementimit, anëtarët tjerë mund të ndrohen në ekipë në pajtueshmëri me nevojat. Persona të caktuar të cilët e njohin mirë bashkësinë, mund të angazhohen në fazën e hershme që të ndihmohen në sigurimin e kontakteve dhe përkrahja nga persona të ndikueshëm dhe të njohur në shërbimet shtetërore apo ndërmarrjet.

Qasje tjetër mund të jetë integrimi i planifikimit për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në zhvillimin më të gjërë të bashkësisë dhe qëllimeve edukative në bashkësi.

Në shembullin e paraqitur paraprakisht për Karaibet, disa shoqata nacionale kanë ndihmuar në formimin e komiteteve për menaxhimin e situatave emergjente në bashkësi të cilët e marrin përgjegjësinë për zbatimin e aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe për adresimin e nevojave tjera të identifikuara në bashkësi – si për shembull zgjedhja e konflikteve apo largimi i bërllotut.

### **3.4 Formimi i partneriteteve për bashkëpunim në bashkësi**

#### **3.4.1 Mundësi për bashkëpunim**

Një prej detyrave të para të ekipit është që të identifikohe partneritet potenciale për bashkëpunim në bashkësi me organizata, grupe dhe agjenci tjera. Organizatat e grave, shoqatat e mësimdhënësve, menaxhuesit e operacioneve emergjente, zjarrfikësit, organizatat vullnetare në bashkësi, ndërmarrjet, korporatat, fondacionet dhe mediat mund t'ju ndihmojnë të diseminoni informacione, t'ju sigurohet sponsorizim për ngjarje, të siguroni hapësirë për aktivitet të caktuar, t'i siguroni materialet e nevojshme apo resurset tjera për punën tuaj. Ekipi për planifikim mund të fillojë nëpërmjet përgatitjes së listës së partnerëve potencial ku do të theksohet se çka mund të kontribuojnë ata dhe në cilën mënyrë mund të kontaktohen.

Partnerët potencial duhet të dijnë se çka kërkohet prej tyre. Ata gjithashtu do të jenë të gatshëm të marrin pjesë në këto orvatje nëse dijnë se çfarë dobie do të dalë për ata nga ky partneritet. Beneficionet të cilat mund të dalin për ata mund të jenë:

- Forumi për diskutim dhe zgjidhje të problemeve në bashkësi
- Mundësi për përparimin e marrëdhënieve të mira në bashkësi
- Ngritje e vetëdijes për rrezik të caktuar tek banorët në bashkësi
- Mundësi për përmirësimin e marrëdhënieve të punës mes institucioneve qeveritare dhe shoqërisë qytetare
- Partneritet lokal dhe kolektiv për zgjidhjen e problemeve në bashkësi
- Pasqyrë e përmirësuar në bashkësi
- Mundësi për mbindërtimin e kapaciteteve organizative dhe aftësive tjera
- Mundësi për punë në rrjet
- Mbulim i rritur pozitiv medial, kredibilitet dhe vizibilitet



- Mundësi të kontribuohet për mirëqenien e bashkësisë

### **3.4.2 Lista e partnerëve potencial**

Subjektet në vijim mund të jenë partnerë potencial për përkrahjen e iniciativës për ngritjen e vetëdijes për katastrofa:

- Stacionet televizive
- Shkollat, kolexhet dhe universitetet
- Qendrat lokale dhe grupet në bashkësi
- Organizatat fetare
- Klubet e të rinjve, shtëpitë studentore
- Persona të moshuar në bashkësi
- Klubet e grave, organizatat
- Shoqatat tregtare, asociacionet
- Bankat dhe unionet kreditore
- Qendrat shëndetësore, spitalet, klinikat
- Klubet e sportit
- Bibliotekat, kinematë, teatrot, cirku
- Kompanitë për furnizim me ujë, për rrymë, nxemje, telekomunikacion
- Gazeta, revista
- Shoqata e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe
- Mbrojtja civile
- Organizatat joqeveritare
- Shërbimi zjarrfikës

### **3.4.3 Partneritet me biznese lokale apo korporata**

Të gjitha organizatat kanë interes që t'i mbrojnë të punësuarit dhe objektet e tyre në rast të katastrofës. Bizneset varen nga të punësuarit dhe klientët e tyre me qëllim që të mbijetojnë dhe të realizojnë përfitim. Bizneset dhe industritë lokale mund të jenë të intresuara dhe të dëshirojnë të shpërndajnë informacione për mbrojtjen e të punësuarve dhe klientët e tyre dhe, si rezultat i saj të ulin humbjet potenciale. Kompanitë njohin se të punësuarit të cilët janë të gatshëm për katastrofa në shtëinë e tyre ka mundësi më të vogël që të mungojnë nga puna pasi të ndodhë katastrofa – kur kompanive do tu nevojiten më së shumti.

Kompanitë dhe bizneset e mëdha ndoshta do të dëshirojnë të japin kontributin e tyre në mallëra dhe shërbime, ekspertizë, ndarje të kohës, objekte apo pajisje. Kompanitë gjithashtu mund të japin kontribut për botimin e materialeve apo për organizimin e ndonjë manifestimi të caktuar. Gjithmonë ka mundësi që shoqatat nacionale dhe kompanitë të bëjnë marrëveshje me të cilën do të kenë dobi reciproke nëpërmjet implementimit të aktiviteteve të përbashkëta në bashkësitë lokale.



## **Partneritet lokal të sektorit korporativ dhe Kryqit të kuq të Xhamajkës**

Kryqi i kuq i Xhamajkës merr pjesë në iniciativë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes me disa hotele të mëdha në vend. Idea është që shoqata nacionale të sigurojë trajnim për personelin e hotelit në pjesën e përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë tërmeteve. Për kompensim hotelet janë të gatshme të kontribuojnë për aktivitetet e Kryqit të kuq. Hotelet do të kenë dobi me atë që do t'ju ulen pagesat e premive të sigurimit për të punësuarit e tyre si rezultat i kapaciteteve të përmirësuara të njerëzve nga trajnimi i zbatuar.

*Burimi: Mësim nga e kaluara: Propozim raporti: evaluimi i programeve për përgatitshmëri gjatë katastrofave, përgatitur nga Xhon Miçell për njësinë për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave, Nëntor 1999*

Në vazhdim janë prezantuar ide plotësuese për partneritet me biznese apo korporata lokale:

- Nxitje e kompanive lokale (telekomunikacione, furnizim me ujë, rrymë, nxemje) të kyçin informacione periodike për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave në llogaritë dhe faturat e veta apo letra informatorë.
- Nxitje të kompanive të mëdha të shpërndajnë informacione për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe të mbajnë punëtori për përgatitshmëri gjatë katastrofave për të gjithë të punësuarit e tyre.
- Kërkim tek korporatat për botimin e broshurave dhe fletushkave me masa elementare për përgatitshmëri gjatë rreziqeve dhe katastrofave.
- Dorëzim të kërkesave në shitoret lokale që të ngjeshin posterin tuaj apo të shpërndajnë fletushka për klientët e tyre.

Përfundimisht, kompanitë të cilat janë të kyçura në prodhimtari, renditje dhe largim kemikaleve kanë obligim moral dhe shpesh herë ligjor që ta informojnë bashkësinë më të gjërë në bazë të rreziqeve të cilat dalin nga aktivitetet e tyre të përditshme. Megjithatë, shpesh herë, kompanitë këtë nuk e bëjnë për shkak se figohen nga ankimi i opinionit. Prandaj është me rëndësi të bashkëpunohet me këto kompani dhe të kyçen në procesin e planifikimit për uljen e rreziqeve nga katastrofa për shkak se ka mundësi të vije deri tek zgjidhjet dhe kompromiset reciproke të pranueshme. Teksi i mëposhtëm na paraqet shembull të programit për uljen e rreziqeve nga katastrofat kimike industriale nëpërmjet krijimit të partneriteteve në bashkësi mes qeverisë, industrisë dhe organizatave lokale.

## **Programi për ndalimin dhe lehtësimin e fatkeqësive lokale të qendrës botërore për mbrojtjen e mjedisit jetësor**

Programi për ndalimin dhe lehtësimin e fatkeqësive lokale në qendrën botërore për mbrojtjen e mjedisit jetësor menaxhon ballafaqimin me rreziqe për mjedisin jetësor nëpërmjet sigurimit të përkrahjes së industrisë dhe organizatave lokale për ndalim apo lehtësim të fatkeqësive. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me qeverinë, industrinë dhe liderët në bashkësinë në nivel lokal dhe nacional, kjo organizatë iu ndihmon bashkësive të shfaqura në rrezik ta përmirësojnë

vlerësimin dhe komunikimet në bazë të rreziqeve industriale e të tjera, të përgatisin plane për përgatitshmëri gjatë situatave emergjente, dhe t'i përmirësojnë aftësitë për përgjigje gjatë situatave emergjente. Bashkësitë qëllimore zgjedhen në bazë të rreziqeve nga katastrofat të nxitura nga njeriu ndaj njerëzve dhe pasurisë së tyre. Fokus për shembull jepet në fabrikat ku prodhohen hemikale ndezëse dhe toksike e merren parasysh edhe lokalitete të cilat paraqesin rrezik si rezultat i asaj që renditen dhe transportohen aty këto kemikale.

Pasi të vërtetohen lokalitetet dhe objektet potenciale kjo organizatë e vëmendjen e vet e drejton kah iniciativat lokale dhe realizon bashkëpunim me grupet industriale, nëpunësit shtetëror, agjencitë rregullatore dhe liderët në bashkësi të cilat angazhohen për minimalizimin e rreziqeve nga katastrofat teknologjike. Në Vera Kruz në Meksikë kjo organizatë punon në uljen e incidencës dhe ndikimin e katastrofave të mëdha industriale të cilat dalin nëpërmjet manipulimit dhe transportit të materialeve të rrezikshme në mjedise të caktuara urbane. Aktivitetet në këtë program janë të drejuara në pjesët që vijojnë:

- Vlerësimi i rreziqeve në fabrikat kimike dhe komplekset industriale
- Përgatitshmëri për katastrofa kimike dhe trajnime për ndalimin e fatkeqësive
- Zbatim të seminareve për trajnim dhe ngritje të vetëdijes në bashkësi
- Organizim të trajnimeve për përgatitshmëri gjatë katastrofave
- Trajnim për mbrojtje kundër zjarrit dhe kontrollë të materieve të rrezikshme në objekte industriale

*Burimi: Programi për ndalim dhe lehtësim të fatkeqësive lokale në qendrën botërore për mbrojtjen e mjedisit jetësor – ueb faqja, <http://www.wec.org/jedslamp.htm>*

#### **3.4.4 Partneritet me organizata në bashkësi**

Organizatat lokale të bashkësisë mund të jenë partnerë të rëndësishëm për zbatimin e iniciativave të përbashkëta. Organizata të tilla mund të jenë partnerë të rëndësishëm për zbatimin e iniciativave publike. Organizatat e tilla mund të jenë klubet e të rinjve, organizatat komunale të Kryqit të kuq, organizatat joqeveritare, organizatat për zbatimin e rendit dhe qetësisë, organizata të grave, grupe të veteranëve, organizata fetare etj.

Edhe pse organizatat lokale nuk mund gjithmonë të sigurojnë resurse financiare, shpesh herë ato janë në gjendje të sigurojnë njerëz – që është njëjtë resurs i rëndësishëm. Shpesh herë anëtarët e këtyre grupeve duan të involvohen në sigurimin e përkrahjes në bashkësi në mënyra të ndryshme. Secili grup ka rrjetin e vet i cili mund të ndihmojë në organizim të ndonjë aktiviteti të caktuar për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Në vazhdim ju prezantojmë disa ide për partneritete në bashkësinë lokale:

- Punë me prindër në shkollat lokale për inkorporimin e punëtorisë për përgatitshmëri gjatë katastrofave që mund të mbahet në një rën prej mbledhjeve të tyre
- Punë me mësimdhënësit lokal në shkollat për inkorporimin e porosive për përgatitshmëri gjatë katastrofave në planet e tyre mësimore
- Sponsorizimi i garës për punimin e posterit më të mirë nga ana e fëmijëve ku janë paraqitur hapat për veprim në rast të situatave emergjente apo katastrofave.
- Punë me organizatat lokale për organizimin e punëtorive për përgatitshmëri dhe lehtësim të pasojave nga katastrofat në mbledhjet e këtyre organizatave
- Organizimi i pikave treguese me materiale për përgatitshmëri gjatë katastrofave në festivale të ndryshme, panaire dhe ngjarje tjera të mëdha
- Ekspozimin e postereve dhe broshurave në biblioteka lokale dhe tregje

### **3.4.5 Partneritete me mediat lokale**

Partnerët mediatik mund të diseminojnë porosi për përgatitshmëri gjatë katastrofave nëpërmjet botimit të statuseve nëpërmjet emisioneve në media dhe nëpërmjet hapësirës së dhuruar për reklamim. Kontaktet dhe bashkëpunimi me mediat duhet të mbikqyren dhe rregullisht të azhurohen.

## ***3.5 Renditja e kohës dhe lokacionit të kapaciteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa me qëllim që të realizohet ndikim maksimal***

### **3.5.1 Koha dhe lokacioni**

Kur planifikohet ngjarje për ngritjen e vetëdijes për katastrofa, me rëndësi është që të caktohet koha dhe vendi adekuat që të sigurohet ndikim dhe interesim maksimal i publikut të caktuar qëllimor. Në mënyrë të përgjithshme, ngjarjet për ngritjen e vetëdijes për katastrofa nuk duhet të planifikohen afër apo gjatë kohës së festave që të mos merret vëmendja e nevojshme. Lokacioni ku do të mbahet ngjarja për ngritjen e vetëdijes për katastrofa duhet të përshtatet në vendin ku zakonisht publiku qëllimor shkon, punon apo argëtohet.

### **3.5.2 Ko-organizimi i ngjarjeve**

Në vend se vetë të organizoni ndonjë ngjarje, ngjarjet mund t'i organizoni në bashkëpunim me organizata tjera apo të jeni mysafirë të ndonjë ngjarje tjetër. Për shembull, ekipet për planifikimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa mund të vendosin t'i koordinojnë ngjarjet e tyre në festivale lokale, panaire, mbledhje qytetare, ditë tregu dhe grumbullime në bashkësi. Ekipi për planifikim gjithashtu mund të realizojë kontakte me klinikat lokale shëndetësore dhe të kërkojë prej tyre t'ju shpërndajnë pacientëve fletushka apo broshura.

### **3.5.3 Planifikim të ngjarjeve vjetore**

Nëse dëshironi të jeni të suksesshëm në bazë të ngritjes së vetëdijes për katastrofa do të ishte mirë në këtë organizoni për çdo vit që me kalimin e kohës të rritet në aktivitet vjetor tradicional. Për shembull, në shumë vende dhe

bashkësi organizohet java e ngritjes së vetëdijes për katastrofa nëpërmjet dërgimit të porosive të ndryshme për promovimin e përgatitshmërisë gjatë katastrofave.

### 3.5.4 Sezona të katastrofave

Disa katastrofa ndodhin në mënyrë ciklike dhe ndodhin në kohë të caktuara të vitit. Për shembull, zjarret në pyje shpesh ndodhin në periudhën e verës – vjeshtës. Përmytjet e mëdha zakonisht ndodhin në pranverë. Kur katastrofat potenciale janë sezonale, periudha parasezonale është koha kur njerëzit janë më shumë të interesuar për porosi lidhur me ngritjen e vetëdijes për katastrofa.

### 3.5.5 Aktivitete pasi të ndodhë katastrofa

Vetëdija e publikut është në nivel më të lartë pasi të ndodhë katastrofa. Për shembull, e gjithë bota shprehi interes për rreziqet nga qendrat nukleare pas fatkeqësisë me reaktorin nukleor në Çernobil në Maj të vitit 1986. Shumë bashkësi lokale e shfrytëzuan këtë ngjarje si mjet për ngritjen e vetëdijes për rreziqe dhe ndërtim të masave për përgatitshmëri nga fatkeqësi në qendra nukleare në afërsi të tyre.

### Java e ngritjes së vetëdijes për katastrofa në Fixhi

Fixhi është vend i cili ka përjetuar disa ciklone katastrofale në historinë e vet. Cikloni Oskar në vitin 1983 dhe ciklonet Erik dhe Nigel në vitin 1985, shkaktuan dëm prej 1.2 miliardë dollarë. Në vitin 1993 cikloni Kina rezultoi me humbje prej mbi 300 milion dollarë amerikan. Përmytjet të cilat i shkaktuan këto ciklone lanë mijëra njerëz pa shtëpi, me kullosa të dëmtuara dhe infrastrukturë e pasuri private të shkatërruar. Në vende siç është Fixhi ku resurset për projekte të mëdha për lehtësimin e pasojave nga katastrofat janë të kufizuara, është shumë me rëndësi të ketë përgatitshmëri të mirë gjatë katastrofave dhe strategji për uljen e rreziqeve nga katastrofa.

Prandaj, çdo vit Kryqi i kuq i Fixhi dhe organizata e grupe tjera të interesuara së bashku e organizojnë *Java për ngritjen e vetëdijes për katastrofa* që mbahet para sezonit të cikloneve, që zgjat prej Nëntorit e deri në muajin Prill. Porositë të cilat dërgohen gjatë kësaj jave kanë të bëjnë me gjërat në vijim: shëndet, siguri personale, mbrojtje të ushqimit, ndërtim të struktureve dhe përdorim efektiv të resurseve të kapshme. Gjatë javës në radio emitohen porosi për përgatitshmëri gjatë katastrofave, ndërsa në gazetat ditore botohen statute për efektet e katastrofave të mëparshme. Në shkollat organizohen gara me temë *Si të ulen ndikimet nga katastrofat*, ndërsa organizatat joqeveritare dhe Kryqi i kuq i Fixhi ndihmojnë në shpërndarjen e fletushkave, broshurave dhe kalendareve.

*Adaptuar nga Java për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në Fixhi, nga Rishi Raj, Ministria për infrastrukturë në Fixhi, buletini për ndalimin e katastrofave numër 14, Korrik – Gusht 1993, fq 19*

### **3.6 Shpërndarje të ideve për aktivitete potenciale për ngritjen e vetëdijes për katastrofa**

Në përgjithësi para se të përgatitet iniciativa për ngritjen e vetëdijes për katastrofa, ekipi për planifikim duhet të ndajë kohë për shpërndarjen e ideve në bazë të aktiviteteve të mundshme dhe mediave të cilat do të përdoren për dërgimin e porosive dhe informacioneve të nevojshme. Për shembull, nëse qëllimi është që të ngritet niveli i vetëdijes tek fëmijët të moshës prej 7 deri 10 vjet për siguri nga zjarret në shtëpi ide në bazë të kësaj teme mund të jenë:

- Prezantime në shkolla, prezantuar nga zjarrfikësit
- Kycje në temat për përgatitshmëri gjatë katastrofave në programin mësimor në shkolla
- Organizim të kuizeve në shkolla
- Organizim të garave për përpunimin e posterit më të mirë me temë përgatitshmëri gjatë katastrofave
- Përpunim të fletushkave për ngjyrosje për fëmijë me temë përgatitshmëri gjatë katastrofave
- Inçizim të këngëve të cilat do të emitohen në radio
- Përpunim të filmave vizatimor me temë përgatitshmëri gjatë katastrofave të cilat do të emitohen në televizion
- Ngjitje të postereve në tregje, biblioteka dhe lokalitete tjera publike
- Emisione televizive me temë përgatitshmëri gjatë katastrofave

Pasi të shpërndahen idetë për temën, ekipi për planifikim mund të shqyrtojë se cili opcion është më i kapshëm. Kjo qasje e përgjithshme është më efektive se sa të pranohet idea e parë e cila do të propozohet. Pasi të dëgjohen më shumë ide ato mund të evaluohen sipas morisë së caktuar të kriterëve. Kriteret mund të jenë:

- A mundet aktiviteti të mbarohet në kornizë të caktuar kohore?
- A është çmimi i kapshëm (a mund të gjinden mjete të mjaftueshme)?
- A ka mjaft njerëz dhe vullnetarë?
- A do të arrijë aktiviteti numër të mjaftueshëm të njerëzve tek publiku ynë primar?

### **3.7 Burim të mediave dhe aktiviteteve për komunikim**

#### **3.7.1 Media për komunikim**

Secili publik primar do të përgjigjet ndryshe në prezantime dhe metoda të ndryshme për diseminimin e informacioneve. Nëse resurset mundësojnë më mirë të ketë format të ndryshëm të porosive dhe të komunikojnë në më shumë mënyra dhe më shumë se një herë. Nëse ekipi për planifikim e njeh publikun e vet do të jetë lehtë të zgjedhet mjete më efektive që të arrihet tek ajo. Nëse ekipi për planifikim nuk i din shprehitë dhe preferencat e publikut primar qëllimor, atëherë duhet të bëhet studim që të shihet se cili informacion është më adekuat. Pasi të testohet në shembull reprezentativ të njerëzve të publikut

qëllimor me qëllim që të sigurohen informacione reciproke. Në vazhdim vijon lista e mediave potenciale të cilat mund të përdoren për këtë qëllim:

- Fleta me të dhëna
- Broshura
- Statute apo reklama në gazetë
- Pamflete, fletushka
- Postere
- Bukmejkerë
- Radio dhe televizion
- Fotografi
- Prezantime
- Shfaqje teatrale
- Trajnime për përgatitshmëri gjatë katastrofave
- Torba për shopping
- Fletore për numra telefoni
- Fije shkrepe
- Vitrina në shitore apo biblioteka
- Tubime / mbledhje të ndryshme në bashkësi
- Ligjërata në shkolla
- Inkorporim në programe ekzistuese qeveritare (programe për edukim shëndetësor), ku do të kyçen informacione të shkurta për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave

Teksti në vijim paraqet shembull të fushatës për ngritjen e vetëdijes të organizuar nga Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit.

### **Fushatë për ngritjen e vetëdijes për mbrojtje nga ciklonet në Bangladesh**

Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit i implementon aktivitetet në vijim për ngritjen e vetëdijes për mbrojtje nga cikloni në rajonet bregdetare të cilat janë të shfaqura në ndikimin e cikloneve:

**Ngritje e vetëdijes publike me përkrahje të vullnetarëve:** si pjesë e trajnimit të tyre, vullnetarët e Gjysmëhënës së kuqe të Bangladeshit në bashkësitë e goditura, mësojnë mënyra për kontaktim, motivim dhe diseminim të informacioneve për ngritjen e vetëdijes për përgatitshmëri nga ciklonet në bashkësitë e tyre.

**Trajnime për përgatitshmëri nga ciklonet:** ato mbahen rregullisht nga ana e vullnetarëve në prani të popullatës lokale nga shumë banorë të bashkësive të goditura.

**Shfaqet – Dramat:** me qëllim që të ngritet vetëdija e popullatës në fshatrat të cilat janë të shfaqura në katastrofa nga ciklonet, shoqata nacionale ka angazhuar ekipë profesionale të aktorëve të cilët aktrojnë shfaqje teatrale ku shprehet rëndësia e përgatitshmërisë së popullatës që të ballafaqohet me aktivitetet e cikloneve. Mbi 200.000 njerëz kanë prezantuar në shfaqje të tilla.

**Postere, fletushka dhe broshura:** këto materiale informative shpërndahen rregullisht tek popullata në pjesët bregdetare. Në to janë përmbajtur udhëzime të posaçme në bazë të evakuimit, interpretim të sinjaleve për paralajmërim dhe udhëzime për peshkatarët të cilët jetojnë në bashkësitë të shfaqura në aktivitete të cikloneve.

**Paraqitje të tregimeve të filmuara / video:** Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit në bashkëpunim me shërbimin meteorologjik të Bangladeshit dhe njësinë për film dhe publikime të qeverisë së Bangladeshit përgatisin filma / video dokumentare për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave të cilat paraqiten në fshatrat bregdetare të Bangladeshit.

**Fushatë:** para sezonit të ciklonit organizohet fushatë publike në bashkëpunim me qeverinë, sektorin joqeveritar dhe publik për ngritjen e vetëdijes për mbrojtje nga ciklonet.

**Radio / televizion:** para se të fillojë sezoni i cikloneve, në kanalet radiotelevizive prezantohen dhe emitohen filma dhe programe të posaçme për përgatitshmëri gjatë cikloneve.

*Burimi: PPC, program për përgatitshmëri nga ciklonet, Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit*

### **3.7.2 Aktivitete dhe ngjarje për ngritjen e vetëdijes për katastrofa**

Secila iniciativë dhe aktivitet për ngritjen e vetëdijes për katastrofa është e posaçme dhe duhet të përgatitet për popullatë të caktuar qëllimore dhe për publik qëllimor. Qkipet për planifikim të aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa mund të kenë dobi të madhe nëse i mësojnë përvojat dhe idetë nga personat tjerë të cilët punojnë në këtë problematikë. Lista në vijim mund të përdoret për mendim kreativ të ekipit për planifikim në bazë të përgatitjes dhe diseminimit të porosive dhe informacioneve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa.

- Përgatitja e materialeve të cilat mund të ekspozohen në ndërtesa publike apo vende për tubim që të prezantohen katastrofat e kaluara dhe aktivitetet e ndërmarrura për përgjigje në katastrofa.
- Vërtetim të markerëve për rikujtimin e banorëve për katastrofa të kaluara
- Përgatitje të kërkesës deri tek kompania lokale për telefoni të kyçen informacione për situata emergjente në librin telefonik (për shembull:



harta ku do të paraqiten rajone të shfaqura në katastrofa apo lokacione për qëndrim emergjent).

- Gjatë kohëve të rrezikshme vjetore ndërmarrjet publike komunale me fletpagesat mund të dorëzojnë edhe informacione për rreziqet të cilat mund të shkaktojnë katastrofa ku do të paraqiten se si popullata të mbrohet kur të ndodhë katastrofa.
- Kërkesë për punëdhënësit që të shpërndajnë broshura për rreziqe të mundshme për të punësuarit e vet.
- Shpërndarje të informacioneve sezonale në ambalazhin e prodhimeve të ndryshme për ushqim dhe higjienë.
- Shënimi i ditës apo javës për përgatitshmëri gjatë katastrofave gjatë kohës ku mund të organizohen ngjarje lokale në bashkëpunim me pushtetet lokale.
- Organizim i garës për përpunimin e posterit më të mirë me temë përgatitshmëri gjatë katastrofave me të rinjtë e shkollave.

### ***3.8 Planifikim të strategjive për ngritjen e vetëdijes për katastrofa në bashkësitë lokale***

Planifikimi dhe implementimi i strategjisë për ngritjen e vetëdijes për rreziqet nga katastrofat obligon përdorimin e aftësive elementare për menaxhment projektues. Pasi të vërtetohen qëllimet më të gjëra dhe publiku primar, planifikuesit duhet të planifikojnë detyra dhe hapa në detaje për implementimin e aktiviteteve të parapara. Ekipi për planifikim gjithashtu duhet të identifikojë resurse dhe të përgatisë buxhetin dhe të targetojë mjete financiare për implementimin e iniciativave. Doracaku për përgatitjen e projekteve është mjet i shkëlqyeshëm të cilin duhet të përdorni në procesin e planifikimit.



## **Aneksi 1 – Fletë pune për planifikim**

Kjo fletë punë mund të shërbejë si udhëzim për planifikimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për katastrofa. Kthehuni përsëri në modulën nëse ju nevojiten më shumë informacione që të plotësohen pjesët e kësaj flete pune.

***I. Titulli i aktivitetit apo iniciativës për ngritjen e vetëdijes për katastrofa:***

***II. Bashkësia qëllimore (apo bashkësi):***

***III. Qëllimi:***

***IV. Qëllime specifike:***

***V. Tema kryesore me theks në katastrofën:***

***VI. Publiku primar dhe karakteristikat:***

- Mosha:
- Lokacione ku njerëzit takohen më shpesh:
- Aktivitete kulturore, shoqërore ku njerëzit janë të kyçur: Ku zhvillohen aktivitetet?
- Mënyra të preferuara për marrjen e informacioneve:
- Çka dijnë njerëzit për rreziqet?
- Shkalla e arsimimit:
- Lista e karakteristikave tjera:
- Ku mund të kërkohen dhe nga kush mund të merren më shumë informacione për publikun primar?

## **VII. Ekipi për planifikim**

Numëroni të gjithë njerëzit të cilët mund të jenë të interesuar për planifikimin dhe implementimin e këtij aktiviteti, dhe çfarë roli mund të luajnë ata. Kush duhet t'i kontaktojë dhe ftoni të marrin pjesë në punën e komitetit për planifikim?

## **VIII. Partneritet për bashkëpunim me bashkësinë**

Diskutoni se kush mund të jetë partner potencial. Përdorni tabelë si kjo më poshtë që t'i definoni rolet specifike për secilin partner.

<b>Emri i personave apo organizatave të cilët duhet të kyçen</b>	<b>Cili do të jetë roli i tyre? Çfarë kontributi mund të sigurojnë?</b>	<b>Kur duhet të futen në proces?</b>
Shërbimi zjarrfikës	Fjalime në shkolla, punë treguese me automjetin e shërbimit zjarrfikës para bibliotekës apo objekti tjetër publik	Në faza specifike të procesit të planifikimit dhe gjatë vetë ngjarjes
Mbrojtja civile	Pjesëmarrje në punën e komisionit për planifikim	Gjatë gjithë procesit

## **IX. Media dhe formate për komunikim**

Cilat media do të përdoren për komunikim të porosive për ngritjen e vetëdijes për rreziqe nga katastrofa?

Kush do të kyçet në të kritikuarit dhe sigurimin e informacioneve reciproke për aktivitetin dhe për përgatitjen e materialeve për edukimin e publikut?



## **MODULI PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE GJATË SITUATAVE EMERGJENTE**

### **Hyrje**

Ky modul është një prej dy moduleve të cilat janë përgatitur nga ana e Njesisë për përgatitshmëri gjatë katastrofave të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në Gjenevë. Ky modul mund të përdoret si studim i pavarur, si udhëzim i temës dhe për sigurimin e trajnimit për pjesëmarrës në seminare me temë përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave.

Qëllimi i këtij dokumenti është që ta përdorin planifikuesit dhe profesionistët e sferës së përgatitshmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave dhe situatave emergjente në Federatë dhe në shoqatat nacionale. Këto module gjithashtu mund të jenë interesante edhe për organizatat joqeveritare të interesuara për menaxhim me situata në krizë, komisione lokale për përgatitshmëri gjatë katastrofave dhe njësive për trajnim me temë mbrojtja civile.

Materiali mund të përdoret si:

- Material i përgjithshëm referent për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave
- Për trajnimin e trajnuesve dhe për pjesëmarrës në seminare me temë përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave
- Si mjet për zbatimin e trajnimit orientues për delegatë dhe nëpunës për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave
- Si udhëzim për vlerësim apo planifikim të aftësive për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave.

Ky material bazohet në qasjen për studimin e rreziqeve dhe katastrofave të ndryshme, dhe para se gjithash ka për qëllim të zbatohen në sferën e përmirësimit të përgatitshmërisë gjatë çdo situatë të rrezikshme në krizë. Megjithatë, në secilin vend mund të ketë kontekste të ndryshme specifike prandaj pjesë të ndryshme të moduleve duhet të zbatohen sipas kontekstit specifik dhe situatës në gjendjen e dhënë.

Modulet dhe shënimet për trajnuesit janë dedikuar që të përdoren gjatë zbatimit të trajnimeve dhe seminareve për përgatitshmëri dhe veprim gjatë katastrofave por trajnuesit nxiten që ta përdorin dhe adaptojnë materialin në pajtueshmëri me nevojat lokale në shtetet e tyre.

Dy modulet që e përbëjnë këtë doracak janë:

1. Hyrje në përgatitshmëri gjatë katastrofave
2. Planifikim të aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave
3. Ulje të rreziqeve

4. Ngritje të vetëdijes për katastrofat në bashkësi
5. Vlerësim të nevojave emergjente gjatë katastrofave
6. Informim dhe lajmërim për katastrofa
7. Përmirësim të koordinimit
8. Përmirësim të aftësive elementare për trajnim
9. Planifikim të projekteve

### **Qëllimi dhe grupi qëllimor**

Ky modul i paraqet konceptet dhe qasjet elementare lidhur me situata të ndryshme të katastrofave dhe vlerësimin e nevojave gjatë situatave emergjente dhe i prezanton nevojat për ndihmë pas katastrofës, posaçërisht në bazë të llojeve të ndryshme të katastrofave natyrore. Përsëri ky modul prezanton formate të ndryshme për lajmërimin e shoqatave nacionale në bazë të vlerësimit të katastrofave të cilat mund të përdoren gjatë përgatitjes së raporteve.

Ky modul është adekuat për personelin me përvojë më të vogël gjatë zbatimit të vlerësimit të nevojave gjatë katastrofave apo për plotësimin e apeleve ndërkombëtare pasi të ndodhë katastrofë e caktuar. Ky modul nuk ka për qëllim të identifikojë nevoja detaje të seltoreve – kjo është punë e thjeshtë e specialistëve të sektorëve.

### **Aspekte kryesore**

- Qëllimi i vlerësimit të nevojave gjatë katastrofave
- Lidhja mes vlerësimit të nevojave gjatë katastrofave dhe sjellja e vendimeve për veprim gjatë situatave emergjente.
- Metoda dhe mjete elementare për grumbullimin e informacioneve për vlerësim dhe mënyra për minimalizimin e gabimeve dhe parregullsive gjatë zbatimit të vlerësimit.
- Efekte tipike të padëshirueshme që dalin pasi të ndodhë katastrofa si rezultat i llojeve specifike të rreziqeve
- Format për lajmërim gjatë zbatimit të vlerësimit të nevojave gjatë katastrofave
- Prioritete për veprim gjatë situatave emergjente dhe vlerësim të nevojave
- Shembull format për anketë të nevojave në amvisëri gjatë situatave emergjente

## **1. Shqyrtim i vlerësimit të nevojave në rast të katastrofave**

### **1.1 Roli i shoqatave nacionale në përgatitshmëri gjatë katastrofave**

Në rast të katastrofës e cila shkakton dëm të madh dhe/apo humbje jete të njerëzve, përgjegjësia e shoqatës nacionale në vend është që të sigurojë ndihmë humanitare për njerëzit e goditur nga katastrofa.

Forma e ndihmës e cila do të sigurohet dhe roli i shoqatës nacionale në operacionet për sigurimin e ndihmës humanitare duhet të merret vesh me qeverinë e shtetit para se të ndodhë ndonjë katastrofë dhe atë të inkorporohet në planin e shoqatës nacionale për përgatitshmëri gjatë katastrofave si dhe në planin e qeverisë aty kur ka mundësi.

Shoqata nacionale në operacion të tillë do të veprojë si ndihmës i qeverisë në pajtueshmëri me mandatin dhe parimet elementare të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Pasi të vërtetohet roli i posaçëm i shoqatës nacionale në operacionin për ndihmë humanitare me rëndësi esenciale është që të veprojë shpejtë me implementimin e vet. Vlerësimi i nevojave në rast të katastrofave dukshëm do të ndihmojë në implemetnimin e përgjigjes adekuate pasi të ndodhë katastrofa.

### **1.2 Qëllimi i vlerësimit të nevojave në rast të katastrofave**

Vlerësimi i nevojave në rast të katastrofës do të shërbejë kryesisht të plotësojnë dy qëllime esenciale të shoqatës nacionale. Si e para do të ndihmojë në vërtetimin e prioriteteve dhe planeve për përgjigje të shoqatave nacionale.

Si e dyta mund të shërbejë si përkrahje e apelit ndërkombëtar për sigurimin e ndihmës së jashtme për shoqatën nacionale deri sa vëllimi i katastrofës është aq i madh sa shoqata nacionale nuk ka mundësi t'i plotësojë obligimet e veta humanitare me resurset personale me të cilat disponon.

Formati i cili është i paraqitur në Aneks 1, mund të përdoret për formimin e bazës së apelit ndërkombëtar për ndihmë të koordinuar nëpërmjet federatës, apo mund të përdoret për lehtësimin e zbatimit të vlerësimit të nevojave në rast të katastrofave, edhe kur nuk ka nevojë për apel emergjent.

Në rastin e dytë, vlerësimi i nevojave në rast të katastrofave do t'ju ndihmojë personave përgjegjës në shoqatën nacionale të përcaktojnë dhe implementojnë masa adekuate për përgjigje në situata emergjente. Me qëllim që të planifikohen përgjigje efektive, personat përgjegjës në shoqatën nacionale duhet të njoftohen me gjërat në vijim:

- A ekziston situatë emergjente?
- Të dhëna demografike për popullatën e goditur dhe numrin e popullatës së goditur

- Detaje për situatën emergjente (shkaqe, lokacioni, vëllimi i katastrofës etj.)
- Gjendja e popullatës së goditur (numri i rasteve të vdekjes)
- Kapacitetet dhe resurset të cilat janë në disponim që të sigurohet përgjigje në nivel lokal, kyçur me kapacitetet organizative dhe logjistike
- Shkalla dhe lloji i nevojave dhe prioriteteve të rëndësishme për shpëtimin e jetës së popullatës së goditur
- Mundësi për ndodhjen e problemeve apo nevojave të sërishme

Pika fillestare për secilin vlerësim është identifikimi i përdoruesve të mundshëm të informacioneve dhe nevojave të tyre lidhur me natyrën e informacioneve. Të dhënat të cilat përmbajnë perceptime dhe shqyrtime të caktuara, numra dhe fakte, bëhen informacione të dobishme vetëm kur kanë rëndësinë e tyre, kur janë relevante dhe të kuptueshme në kohë dhe vend të caktuar, për qëllime specifike.

### **1.3 Prioritete lidhur me sigurimin e përgjigjes në situatë emergjente**

Përgjigja e situatës emergjente duhet t'i adresojë nevojat e drejtpërdrejta prioritare të cilat rezultojnë nga katastrofa. Nevojat prioritare pas një katastrofe të caktuar shpesh herë i përmbajnë elementet në vijim:

1. Sigurimi i nevojave elementare për mbijetimin e njerëzve: ujë për pije dhe nevoja higjienike e sanitare, ushqim adekuat, ndihmë adekuate mjekësore, strehimore (vendqëndrim dhe rroba) dhe karburante (për gatim dhe nxemje);
2. Mbrojtje për personat që pësuan nga katastrofa nga dhuna fizike dhe agresioni, posaçërisht gjatë katastrofave ku ka të ikur dhe persona të shpërngulur brenda vendit;
3. Sigurim i përkrahjes psikologjike dhe sociale për persona të cilët kanë përjetuar stres psikologjik dhe social shkaktuar nga katastrofa;

Shoqatat nacionale dhe federata padyshim aktiv në nivelin e parë, kohë pas kohe në nivel të dytë dhe aq më shumë në nivel të tretë. Pasi të plotësohen nevojat elementare për përkrahjen e mirëqenies së njerëzve, vëmendja mund të kahësohet kah nevojat tjera më pak urgjente por të rëndësishme.

## **2. Përgjigje emergjente bazuar në vlerësime emergjente**

Organizatrat të cilat janë të kyçura në sigurimin e përgjigjes për situatën emergjente duhet të bëjnë vlerësim të situatës emergjente dhe t'i zgjedhin qëllimet e tyre para se të implementojnë aktivitete për përgjigje gjatë katastrofave. Organizatat të cilat sigurojnë ndihmë humanitare pa bërë vlerësim paraprak në ndikimin e katastrofave, nevojat të cilat dalin si rezultat i katastrofës, si dhe kapacitetet lokale për përgjigje në katastrofa, me siguri do të

ofrojnë ndihmë e cila nuk është e patjetërsueshme dhe do të jetë joadekuate dhe me siguri nuk do të rezultojë në nevojat e popullatës lokale të goditur nga katastrofa.

Në mënyrë ideale përgjigja emergjente duhet të jetë e përbërë nga tre fazat në vijim: vlerësimi i situatës, selektimi i qëllimeve dhe identifikimi i alternativave intervenuese, dhe implementimi i përgjigjes bazuar në qëllimet dhe alternativat.

Vlerësimi i katastrofës duhet të jetë proces i vazhdueshëm dhe përsëritës. Kjo del nga fakti që rrethanat, qasja e informacioneve, dhe nevojat emergjente ndryshohen gjatë kohës. Kur dhe sa shpesh do të zbatohen vlerësimet e ndryshme do të varet nga lloji i katastrofës, resurset e kapshme dhe nevojat specifike informative.

Në mënyrë gjenerale, informacionet duhet të grumbullohen më shpesh gjatë ndryshimit të situatës, dhe kur të ndodhin ngjarje të rëndësishme, siç është për shembull katastrofa sekondare, lëvizja e re e popullatës apo paraqitja e epidemisë. Qëllimet e vlerësimit dhe teknikat për grumbullimin e të dhënave do të ndryshohen me zhvillimin e orvatjeve për sigurimin e përgjigjes adekuate për katastrofën.

Vlerësimet e para mund të jenë të shpejtë dhe jo specifike, por ato duhet të përmirësohen gjatë kohës dhe qasjes më të madhe në informacione.

Është e qartë se intervenimet efektive varen nga koha dhe në masë të madhe mbështeten në resurset tanimë ekzistuese në pjesën e goditur. Shumica e këtyre punëve mund të jenë të planifikuara paraprakisht. Por, menjëherë pasi të ndodhë katastrofa, nuk do të ketë kohë të mjaftueshme për vlerësime më të gjërë apo në detaje dhe organizim të përkrahjes së jashtme më të gjërë.

Tek tërmetet, kërkimi dhe shpëtimi dhe ndihma e parë mjekësore patjetër të mbështeten dukshëm në resurset lokale. Informacionet e sakta dhe të besueshme të cilat u jepen personave të cilët sjellin vendime në bazë të nevojave në teren mundet dukshëm të ndihmojnë në uljen e kompleksitetit të përgjithshëm në përgjigjen logjistike.

## **2.1 Vlerësimi i situatës**

Në fillimin e silësdos situatë emergjente, vlerësimet e para duhet të jenë në kohë dhe tu sigurojnë informacione personave të cilët sigurojnë ndihmë urgjente në bazë të nevojave më urgjente dhe të drejtpërdrejta për shpëtimin e jetës. Gjatë katastrofave – posaçërisht tek katastrofat të cilat ndodhin përnjëherë apo tek lëvizja e popullatës që ka ndodhur përnjëherë – do të ekzistojë pasiguri e madhe në bazë të problemeve aktuale.

Prandaj, liderët të cilët sjellin vendime duhet të përdorin qasje sistematike për vlerësim që të marrin pasqyrëse ku gjenden njerëzit, në çfarë gjendje gjenden ato, çka bëjnë ata, cilat janë nevojat dhe resurset e tyre, dhe cilat shërbime janë të kapshme për këta njerëz. Pas vlerësimit të parë, duhet të zbatohet vlerësim



më i thellënë i nevojave të situatës emergjente që të grumbullohen informacione lidhur me sektorë të rëndësishëm dhe pjesë teknike me interes.

Standardet humanitare minimale për veprim gjatë katastrofave përgatitur në kuadër të Projektit Sfera mund t'ju ndihmojnë organizatave në prioritetizimin e nevojave në bazë të grumbullimit të informacioneve dhe planifikim të përgjigjes adekuate. Është shumë me rëndësi para se të zbatohet vlerësimi në teren, të organizohen punët logjistike lidhur me zbatimin e vlerësimit si dhe standardet të cilat do të përdoren gjatë operacionit dhe për këtë të ekzistojë përgjigje dhe pajtueshmëri nga ana e të gjithë anëtarëve të ekipit për vlerësim.

Duhet të caktohen detyra adekuate lidhur me zbatimin e vlerësimit. Projekti Sfera përmban informacione në sektorët në vijim:

- Furnizim me ujë dhe sanitacion
- Të ushqyerit
- Ndihmë në ushqim
- Strehimore dhe planifikim të lokacionit
- Shërbime shëndetësore

Përskaj këtyre sektorëve, ekipet për vlerësim ndoshta do të kenë dëshirë të grumbullojnë informacione në bazë të nevojave personale dhe nevojave në amvisëri, dëmi që i është shkaktuar bujqësisë, bagëtisë dhe infrastrukturës, dhe situata politike dhe e sigurisë.

## ***2.2 Selektimi i qëllimeve dhe identifikimi i alternativave***

Në mënyrë iniciale, kjo fazë obligon analizë dhe interpretim të të dhënave me theks në identifikimin e rreziqeve për grupe të ndryshme qëllimore. Duhet të ekzistojë tentim të identifikohen alternativa për uljen e rreziqeve të drejtpërdrejta. Është shumë me rëndësi të ketë kuptim detal në rreziqet e përgjithshme të cilat dalin me një lloj të caktuar të situatës emergjente dhe se si ato mund të ndryshohen. Disa rreziqe të përgjithshme të cilat shpesh janë të pranishme në fazën emergjente janë:

- Prania e vazhdueshme e agensëve të rrezikshëm – përmbytje sekondare, zjarre, rrëshqitja e dheut, temperaturat e ulta ekstreme, ndotja kimike etj.
- Humbja e shërbimeve elementare – uji i pastërt, largimi i bërllotut, mbrojtja shëndetësore.
- Furnizimi joadekuat me shërbime shëndetësore.
- Furnizimi joadekuat me ushqim që është me nevojë esenciale për të mbijetuar
- Efekte të situatave serioze klimatike të cilat dalin si rezultat i mungesës së strehimores, rrobave të ngrohta apo derivate për nxemje.

Nëse sigurohen informacione adekuate liderët do të mundën me të drejtë t'i kahëzojnë orvatjet për sigurimin e përgjigjes adekuate në nivel lokal (institucione qeveritare, Kryqi i kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe), dhe do të kenë mundësi në cilën do mënyrë më së miri t'i shfrytëzojnë resurset ekzistuese për sigurimin e përkrahjes emergjente. Përskaj kësaj, do të kenë mundësi t'i përcaktojnë qëllimet dhe alternativat për intervenim për përgjigje në situatën emergjente të agjencionit.

Nëse popullatës së goditur i nevojitet ndihmë në ushqim, agjencioni patjetër të sjellë vendim se si më së shpejti ta sigurojë. A do ta sigurojë ushqimin jashtë pjesës së goditur dhe a do ta transportojë deri aty? A duhet të bëhet orvatje të blihet në tregun lokal? Apo a duhet ushqimi të sigurohet nëpërmjet programeve ndërkombëtare?

Element i dytë i rëndësishëm në këtë fazë është që të bëhen parashikime adekuate – tentim që të parashikohet se si do të jenë nevojat, resurset dhe si do të ndryshojnë rrethanat gjatë kohës. Vlerësuesit duhet të gjykojnë se a do të sigurohen në kohë resurset e nevojshme për menaxhim me probleme të caktuara para se të bëhet më pak e rëndësishme.

Parashikimet posaçërisht janë të rëndësishme në fazën e hershme, kur nevojat ndryshohen shpejtë. Për shembull, vendimet lidhur me sigurimin e kujdesit emergjent mjekësor dhe kërkim e shpëtim gjatë tërmeteve, janë aq shumë të ndjeshëm në bazë kohore që bile edhe disa orë anulim mund të vijë në shkatërrim të tërësishëm të resurseve.

Gjithashtu do të ekzistojnë edhe nevoja në bazë të identifikimit të kërcënimeve sekondare të vërshimeve apo rrëshqitje të dheut, dëmtim të fabrikave kimike4 apo zjarre në depotë për karburante.

### ***2.3 Implementimi i planeve për përgjigje në katastrofa***

Në fazat e hershme të katastrofës aktivitetet për vlerësim iu mundësojnë informacione personave të cilët sjellin vendime në bazë të vërtetimit të qëllimeve dhe politikave për sigurimin e ndihmës emergjente. Përskaj kësaj, informacionet nga vlerësimi iu ndihmojnë liderëve t'i marrin parasysh prioritetet e popullatës së goditur dhe të vendosin se në cilën mënyrë më së miri t'i përdorin resurset ekzistuese për sigurimin e ndihmës dhe rimëkëmbje nga katastrofa.

Planifikimi dhe implementimi i përgjigjes në katastrofa nënkuptojnë alokimin dhe shpërndarjen e resurseve – kyçur edhe njerëzit, pajisje dhe mallëra – për plotësimin e qëllimeve dhe zbatimin e aktiviteteve për rimëkëmbje dhe zhvillim. Gjatë kësaj faze vlerësimet sigurojnë informacionepër përparimin e realizuar, duke theksuar gjithashtu edhe pjesët në të cilat ka nevojë që të përkushtohet analizë dhe intervenime plotësuese.

### **3. Lajmërim për vlerësimin e zbatuar në nevoja gjatë katastrofave**

Edhe pse qasja e saktë për zbatimin e vlerësimit varet nga lloji specifik i rrezikut, diagrami në vijim e ilustron konceptin e zbatimit të vlerësimeve të vazhdueshme dhe të sërishme gjatë të gjitha fazave të katastrofës. Diagrami është i përcjellur me diskutim të thelluar në bazë të llojeve të ndryshme të raporteve lidhur me zbatimin e vlerësimit të nevojave.

#### **TABELA**

##### ***3.1 Parashikim dhe paralajmërim i hershëm***

Në shumë lloje të katastrofave natyrore – përmbytje, fortuna, zjarr në pyje, shpërthim të vullkaneve, cunami – duhet të ketë zbatuar sisteme për parashikim dhe paralajmërim të hershëm dhe komunikime. Vlerësimet për këto sisteme grumbullojnë dhe diseminojnë informacione në bazë të zhvillimit potencial të katastrofës, dhe e vërtetojnë shkallën e suksesit për mbrojtjen e jetës së popullatës dhe pasurinë nga ndikimi i rreziqeve të pritura.

##### ***3.2 Lajmërim i hershëm për katastrofa***

Në disa orët e para pasi të ndodhë katastrofa është e nevojshme që të ndërmerret aksion i vendosur. Tek katastrofat të cilat ndodhin përnjëherë, shërbimet lokale duhet të japin lajmërim preliminar, të hershëm për katastrofën dhe atë menjëherë pasi të ndodhë katastrofa – mundësisht gjatë 10 orëve të para pasi të ndodhë katastrofa.

Ky lajmërim i hershëm e alarmon qendrën deri sa të ndodhë katastrofa dhe jep vlerësim në vëllimin dhe lokacionin e katastrofës dhe prioritetet emergjente, siç është kërkimi dhe shpëtimi dhe ndihma e parë për popullatën e goditur.

##### ***3.3 Vlerësimi i nevojave gjatë katastrofave***

Pas lajmërimit të hershëm vijon vlerësim më komplet i nevojave të cilat dali nga katastrofa dhe ajo zakonisht bëhet gjatë 12 deri 36 orëve të para pasi të ndodhë katastrofa. Ky vlerësim do të sigurojë informacione plotësues të përgjithshme për katastrofën: dëmi, nevoja dhe prioritetet emergjente dhe masa të ndërmarrura.

Vlerësimi i nevojave do të azhurohet pasi të sigurohen më shumë informacione edhe me ndryshimin e situatës. Shembull i formularit të tillë të cilin mund ta përdorin shoqatat nacionale sëth ëparaqitur në Aneks 1: formular për dorëzimin e raportit për vlerësimin e zbatuar të nevojave gjatë katastrofave.

Zakonisht në afat prej 36 – 72 orëve pasi të ndodhë katastrofa, ekipi i specialistëve të sektoreve duhet të zbatojë vlerësim të shpejtë por edhe detal për dëmet specifike, resurset, mekanizmat për përgjigje, dhe nevoja precize në sektore të ndryshme: ujë dhe sanitacion, nevoja shëndetësore, ushqim dhe të ushqyerit, strehimore, infrastrukturë dhe komunikim etj.

Puna e tyre do të jetë t'i parashikojnë nevojat e sektoreve për 3 – 7 ditët në vijim, 7 – 28 ditë dhe 28 – 90 ditë. Nëse duket se situata emergjente do të zgjasë disa javë deri në disa muaj, atëherë këta specialistë duhet të ndihmojnë të definohen intervenimet specifike për periudhën që vjen.

### **3.4 Monitoring**

Pas 3 ditëve të para, duhet të planifikohen vlerësimet plotësuese, për shembull cilat duhet të zbatohen në periudhën prej 7 – 15 ditë, 30 – 60 ditë dhe 3 muaj pasi të ndodhë katastrofa. Rrethanat e reja, orvatjet dhe kapacitetet e reja dhe masat zyrtare do të ndikojnë në statusin e situatës emergjente dhe nevojat për përkrahje.

Është me rëndësi të përcjellët situata dhe ndryshimet të cilat ndryshohen gjatë kohës që të bëhet vlerësimi se a ka nevojë për ndihmë plotësuese apo afatgjate. Gjithashtu duhet të vëzhgohet efektiviteti i programit për sigurimin e ndihmës emergjente dhe të bëhen modifikime deri sa ka nevojë.

## **4. Mjete dhe metoda për vlerësim**

Informacionet për raportin e vlerësimit duhet të grumbullohen nga letërsia ekzistuese, materialet relevante historike, të dhëna për gjendjen para katastrofës dhe nga diskutimet dhe intervistat me njerëz adekuat nga shkenca, donatorë, personeli i agjencive të ndryshme, nëpunës qeveritar, specialistë lokal, përfaqësues të organizatave shoqërore, punëtorë në arsim, tregtarë etj.

Ekzistojnë metoda të ndryshme për vlerësim të cilat mund të përdoren për grumbullimin e të dhënave. Disa prej metodave të cilat përdoren më së shumti janë kontrollime vizuale në vendin e ngjarjes, zbatimi i intervistave dhe anketimit.

### **4.1 Kontrollimi vizel në vendin e ngjarjes**

Kontrollimi vizuel është mënyrë e shkëlqyeshme që të hasen informacione për katastrofën. Vëzhguesit me përvojë mundën shpejtë të grumbullojnë informacione nëse e dinë se çka dëshirojnë. Megjithatë, shpesh herë nevojitet kontrollim i mëtutjeshëm, për shkak se disa detaje nuk mundet lehtë të shihen. Në mënyrë të kombinuar me intervistat, kontrollimi vizuel në vendin e ngjarjes është metodë e mirë për vlerësim inicial.

#### **Detyra për zbatimin e kontrollimit vizual në vendin e ngjarjes**

- Vëzhgoeni gjendjen fizike të njerëzve dhe aktiviteteve të tyre
- Parashtroni pyetje
- Vizitoni shtëpitë e njerëzve apo strehimoret, burimet për furnizim me ujë, klinikat, qendrat për shpërndarje
- Vëzhgoni fëmijët, personat e moshuar dhe të sëmurit

- Vëzhgoeni jetën ditore të grave (bëni intervista me gra)
- Vëzhgoni se si zhvillohen shërbimet, komunikacioni dhe sistemi komunal
- Bëni vizatime, fotografoni apo xhironi video. Fotografitë, videot, por edhe vizatimet janë posaçërisht të dobishme në komunikimet me të tjerët në bazë të gjendjes reale në teren

#### **4.2 Intervista**

Teknikat për intervistim mund të ndahen në intervista me individë apo intervista me grupe. Gjithashtu mund të bëhen **intervista më lehtë të strukturuar** me sigures kyç të informacioneve të institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe grupeve të caktuara qëllimore të popullatës së goditur, kyçur: nëpunësit lokal qeveritar, liderët dhe ekspertët lokal, burimet lokale mediale, dhe liderët e grupit qëllimor. Qëllimi është që të sigurohen informacionet faktike të cilat kontrollohen tërthorazi me burimet tjera.

**Intervistat në grupe**, zbatuar me grupe qëllimore, liderët lokal apo organet shtetërore, mund të jenë të dobishëm për kontrollimin e tërthorrt të informacioneve me numër të madh të të anketuarve. Në raste të caktuara intervistat në grupe mund të jenë të rëndësishme që të fitohet pasqyrë për çështje të caktuara të cilat ndikojnë tek të gjithë anëtarët e grupit. Megjithatë nuk guxon shumë të mbështeteni në intervistat në grupe për shkak se mund të shpie në zbrazëtira informative, për shkak se mund të ketë pyetje të cilat nuk diskutohen në grupë apo për shkak se disa njerëz mund të mos jenë të përfaqësuar në grupet publike (posaçërisht kur bëhet fjalë për gratë).

#### **4.3 Shembull reprezentativ**

Shembulli reprezentativ është metodë nëpërmjet së cilës bëhet gjeneralizimi i gjithë popullatës në bazë të karakteristikave (shembulli reprezentativ) të popullatës. Rezultatet llogariten në bazë të proporcionalitetit të popullatës e cila ka kaluar nëpër intervista apo anketa krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullatës. Informacionet të cilat grumbullohen nëpërmjet metodës së kontrollimit të intervistave apo pyetësorëve në formë të shkruar.

Ekzistojnë 2 lloje të teknikave për kontrollim të shembullit: **e mundshme dhe me qëllim**. Shembulli i cili bazohet në mundësi në metoda rigorozë statistikore. Është e shtrenjtë, dhe duhet shumë kohë për tu implementuar si dhe trajnim special që të mund të zbatohet me saktësi. Metodatat tjera më së shumti përdoren për zbatimin e intervistave me ato të cilat janë më tërë kapshme (shembull i kapshëm) apo me individë të besohet se e përfaqësojnë popullatën e cila është pjesë e interesit (shembull me qëllim/qëllimor).

#### **4.4 Mbështetje në burime sekondare**

Shoqatat nacionale ndonjëherë varen nga marja e informacioneve nga agjencitë qeveritare, organizatat joqeveritare apo grupet në bashkësi. Kur mbështetemi në informacione të agjencive tjera, është me rëndësi që ato

informacione të kontrollohen se a janë të sakta dhe një burim i caktuar i informacioneve a është në kontradiktë me burim tjetër të informacioneve. Posaçërisht kur gjërat me të dhëna sekondare, nëse ka mundësi kontrollohet konsistencën mes dy burimeve me të dhëna të ngjajshme. Kur evaluohen informacione për kryerjen e vlerësimit, merrni parasysh gjërat në vijim:

- Kush e ka bërë vlerësimin? Çfarë përvojë/ekspertizë kanë ato në këtë fushë?
- Sa kohë ka shpenzuar ekipi për vlerësim në punën në teren? A e kanë vizituar ata lokacionin në vendin e ngjarjes?
- Kush është intervistuar nga ana e ekipit për vlerësim? Cilat grupe të rëndësishme përdoruese janë lëshuar gjatë zbatimit të vlerësimit?
- Nëse raporti i vlerësimit përmban të dhëna statistikore, a janë ato të dhëna primare apo sekondare? Nëse janë të dhëna sekondare cila është zgjedhja origjinale? A është ekipi profesional të vendosë validitetin e informacioneve statistikore? Nëse nuk është, cilët ekspertë duhet të konsultohen?
- Cila është mundësia se një segment i caktuar i popullatës (për shembull: grupi etnik, grupi klasor, nacionaliteti, grupi gjeografik, grupi fetar apo i mjeruar), të mos jetë i vlerësuar në mënyrë adekuate?
- Duke marrë parasysh burimin e informacioneve çfarë parregullsi mund të jenë të pranishme në udhëzimet e vlerësimit?
- A kanë interesim që disa organizata joqeveritare apo qeveria të tregojnë informacione të anueshme?
- Cilat janë interesat qeveritare për paraqitjen e informacioneve të anueshme? A mundet informacionet qeveritare të na çojnë në drejtim të gabueshëm?

## **5. Minimizimi i parregullsive në vlerësim**

Të gjitha metodat për grumbullimin e të dhënave ndeshen me problemin e animit. Animi çon kah interpretimi i gabueshëm i përgjigjeve apo analiza të gabueshme që çon kah konkluzat të cilat nuk i paraqesin rezultatet e sakta, gjegjësisht pikëpamje të popullatës së goditur/qëllimore. Në rast më të keq, programet të cilat bazohen në informacione të anueshme mund të shkaktojnë dëm të popullatës e cila është dashur të ndihmohet dhe të sjellë në reputacionin negativ të agjencionit që siguron përrkahje.

Animi mund të paraqitet si rezultat i pyetjeve detyrimore (pyetje të cilat të detyrojnë në përgjigje), pyetje që nuk kuptohen, teknika të dobta për zgjedhjen e shembullit reprezentativ apo anim tjetër të caktuar të vlerësuesve. Forma speciale të anshmërisë mund të jenë:

### ***Anim hapësinor***

Ndonjëherë vlerësuesit e cërtetojnë pozitën e vlerësimit që t'ju jetë atyre më lehtë i kapshëm dhe komod. Në vend se të udhëtojnë në pjesën ku ka nevojë, vlerësuesit e bëjnë vlerësimin nga automjeti i tyre pa dalë nga automjeti.

### ***Anim i paraparë***

Vlerësuesi shkon në lokalitete ku tani më ka kontakte dhe informacione të kapshme dhe ku vlerësimin tani më e ka zbatuar dikush tjetër.

### ***Anim personal***

Informatorët kyç kanë tendencë të jenë persona të cilët janë në pozita të larta dhe kanë aftësi të komunikojnë në gjuhën e njohur të vlerësuesit. Ato mundet por nuk e kanë patjetër të jenë të njoftuar apo të respektuar me personat të cilët kanë tendencë t'i përfaqësojnë.

### ***Anim sezonal***

Vlerësimi zbatohet gjatë periudhave kur ka kohë të mirë gjegjësisht pjesët ku koha nuk është e mirë, anashkalohen. Në këtë mënyrë, shumë probleme tipike ngelin të pavërejtura.

### ***Anim i specializuar***

Specializimi i vlerësuesit e verbon dhe kufizon në shqyrtimin e nevojave jashtë specializimit të tij/saj/. Për shembull, specialist për strehimore në mënyrë primare mund të bëjë vlerësim vetëm në nevojat lidhur me strehimoren, duke lënë pas nevojat në bazë të ushqimit dhe ujit.

### ***Anim politik***

Informatorët prezantojnë informacione të cilat janë të afërta në agjendën e tyre politike. Vlerësuesit kërkojnë informacione të cilat përshtaten me agjendën e tyre politike apo personale.

### ***Anim kulturor***

Bëhen supozime të pasakta në bazë të normave personale kulturore. Vlerësuesit nuk i kuptojnë praksat kulturore të popullatës së goditur.

### ***Anim klasor, etnik***

Nevojat dhe resurset e klasave të ndryshme të njerëzve apo grupeve të ndryshme etnike nuk kyçen në vlerësim. Vlerësuesit lokal mund të kenë anim të tillë etnik, apo siguresit kyç të informacioneve mund të vijnë nga rradhët e vetëm të një klase të caktuar shoqërore apo grupi etnik.



### ***Person i cili zbaton intervista apo hetim***

Vlerësuesit mund të jenë tendencioz në bazë të koncentrimit të informacioneve të cilat bëjnë pjesë me pikëpamjet dhe supozimet që shpie të kërkojnë konsistencë në segmente të caktuara që në fazën më të hershme, që mundet t'ju pengojë të mos vërejnë dëshmi të cilat janë në kundërshtim me udhëzimet e para. Vlerësuesit gjithashtu mund të mbeten më të anshëm deri në mendimin e siguruesve të informacioneve të caktuar elit, kyç.

### ***Anim kah siguruesit kyç të informacioneve***

Animi kah siguruesit kyç të informacioneve futet në rezultatet e vlerësimit.

### ***Anim gjinor***

Vlerësuesit flasin vetëm me meshkuj apo me zbatues meshkuj të intervistave, intervistojnë vetëm gra apo në të kundërtën.

### ***Periudha gjatë ditës apo orari kohor?***

Vlerësimi zbatohet në periudhën gjatë ditës kur një segment i caktuar i popullatës nuk është i përfaqësuar aq sa duhet apo së tepërmi.

### ***Anim kah shembulli reprezentativ***

Anketuesit nuk janë përfaqësues të grupit qëllimor. Është mirë të njihen llojet e ndryshme të anshmërisë e që ky është hapi i parë që të minimalizohet ndikimi i animit në vlerësimin tuaj.

## ***5.1 Triangulacion***

Triangulacioni është metodë për minimizimin e animit që i detyron zbatuesit e vlerësimit të kërkojnë, zbatojnë dhe lidhin më shumë burime të informacioneve. Triangulacioni bazohet në parimin se të dhënat patjetër të meren së paku prej 2 burimeve tjera të njohura të informacioneve. Shiko fotografinë më poshtë. Informacionet për vlerësime emergjente patjetër të vijnë nga burime të ndryshme me qëllim që të sigurohet vlerësim relativisht i saktë i situatës.

### ***Слика***

Triangulacioni mund të realizohet nëpërmjet përdorimit të teknikave apo qasjeve të ndryshme për vlerësim apo nëpërmjet përdorimit të treguesve të ndryshëm për fenomenin e njëjtë dhe konsultim të burimeve të ndryshme. Qasjet apo treguesit e ndryshëm mund të zbatohen me dy shigjetat e paraqitura në diagramin më lartë. Çelësi në përdorimin e qasjeve të ndryshme është që të gjenden metoda apo teknika të ndryshme që nuk janë pjesë e llojit të njëjtë të anshmërisë.



Mos u mbështetni në metodën e vetme apo në masën e vetme në bazë të problemit. Triangulacioni mund të zbatohet pothuajse në të gjitha aspektet e përgatitjes dhe implementimit të vlerësimit emergjent.

## **5.2 Vlerësime ekipore apo të përbashkëta**

Përdorimi i qasjes së ekipit në vlerësime, dhe përkushtimi i vëmendjes në përbërjen e ekipit për vlerësim është edhe një mënyrë që ndihmon në uljen e anshmërisë. Nëpërmjet kyçjes në lloje të ndryshme të specialistëve dhe gjeneralistëve në ekipë dhe nëpërmjet përfaqësimit të barabartë gjinor, mund të tejkalohen shumë lloje të anshmërisë. Shembulli në vijim siguron shqyrtimin dhe kompetencat të cilat mund të merren parasysh kur ta krijoni ekipin për vlerësim.

### **Ekipi për vlerësim**

- Koordinator i ekipit
- Specialist për logjistikë
- Epidemiolog për shëndet publik
- Specialist për ushqim dhe të ushqyerit
- Specialist për strehimore
- Specialist për mbrojtjen e mjedisit jetësor
- Specialist për ujë dhe kanalizim

Që të shtohen edhe pikëpamje tjera dhe kuptime të ndryshme në ekipë, në të mund të kyçen edhe anëtarë të ndryshëm lokal dhe të jashtëm të ekipit. Njerëzit lokal mund të jenë mirë të njoftuar me situatën dhe zakonet lokale, por ato mund të sjellin edhe lloje të caktuara të anshmërisë lokale dhe pikëpamje të kufizuara që mund të jetë i dëmshëm në bazë të saktësisë së vlerësimit. Nga ana tjetër, anëtarët e jashtëm të ekipit do të jenë më pak të njoftuar me situatën, por për këtë do të japin kontribut me ekspertizën e vet dhe pikëpamjet e tyre të paanshme që gjithashtu është në dobi për zbatimin e vlerësimit të suksesshëm.

## **6. Mjete për vlerësim**

Listat për kontrollim, tabelat për identifikim të mangësive dhe pyetësorëve, janë mjete për vlerësim që mund të ndihmojnë në zbatimin e vlerësimit sistematik të nevojave të situatës emergjente.

### **6.1 Lista për kontrollim**

Listat për kontrollim sigurisht janë mjeti më i lehtë dhe më i kompletuar për vlerësim fillestar të shpejtë. Lista për kontrollim paraqet listë të shkurtuar që i ndihmon vlerësuesve t'i mbajnë mend gjërat kyçe dhe të parashtrojnë pyetje të caktuara. Lista për kontrollim gjithashtu mund të jenë të dobi për dokumentimin e përgjigjes së siguruar në katastrofa.

## 6.2 Grafikone për identifikimin e mangësive

Grafikonet për identifikim të mangësive janë paraqitur në diagramin në vijim, dhe përdoren për organizimin e informacioneve dhe për identifikimin e mangësive mes resurseve dhe nevojave ekzistuese dhe të nevojshme të cilat duhet të plotësohen për të siguruar përgjigje në situatën emergjente.

Paraqitje për identifikimin e mangësive gjatë situatave emergjente								
Organizata tjera	Kombet e bashkuara	Ministria e shëndetësisë	Kryqi i kuq	Mbrojtja civile	Qeveria	Vetqeverisja lokale	Popullata e goditur	Nevoja gjatë situatave emergjente
								Nevoja mjekësore
								Shëndeti publik
								Ushqimi
								Strehimore
								Ujë
								Sanitacion
								Rroba

Nevojat për përgjigje në situatën emergjente janë theksuar në kolonën e parë ndërsa vepruesit e ndryshëm të cilët sigurojnë përgjigje në situatën emergjente, popullata lokale janë të cekur në rradhën më të lartë. Tabela plotësohet nëpërmjet identifikimit të resurseve të cilat i siguron popullata lokale dhe qeveria dhe organizatat tjera të cilat veprojnë si përgjigje në situatën emergjente. Përderisa përdoret kjo paraqitje për analizimin e situatës kjo mund t'ju ndihmojë organizatave të cilat sigurojnë përgjigje në situatën emergjente, t'i plotësojnë nevojat emergjente në mënyrë efikase dhe efektive.

### **6.3 Pyetësorë**

Kur bëhen intervista me sigurues individual kyç të informacioneve apo intervista në grupe, vlerësuesi me siguri do të dëshirojë të përgatisë apo të përdorë pyetësorë. Pyetësori paraqet listë të thjeshtë të pyetjeve për individë apo grup njerëzish të cilat duhet të përgjigjen gojarisht apo në formë të shkruar. Përgjigjet e futura më vonë në mënyrë tabelare paraqiten dhe analizohen (shiko Aneksi 3, shembull i pyetjeve për anketë të nevojave familjare).

## **7. Gjetje të planeve të cilat përsëriten gjatë situatave emergjente**

Kur të ndodhë katastrofa puna e parë është që përkrahja të jetë specifike, dhe intervenimet të jenë qartë të targetuara që të parandalohet humbja e jetës së njerëzve. Prandaj me rëndësi është që të vëzhgohen dukuri të caktuara të cilat shpesh janë të ngjajshme për efektet dhe rezultatet si dhe nevojat për popullatën kur të ndodhin katastrofat. Me këtë themi se të gjitha situatat emergjente janë të njëjta për shkak se nuk janë.

Në pjesën që vijon do të sigurojmë paraqitje të efekteve dhe nevojave tipike gjatë katastrofave lidhur me lloje të ndryshme të rreziqeve. Nëse dihen këto informacione atëherë vlerësuesit mundet shumë mirë ta planifikojnë vlerësimin e tyre dhe përgjigjen në katastrofa. Rreziqet të cilat shqyrtohen janë:

- Tërmetet
- Shpërthimet vullkanike
- Tokë jostabile
- Vërshime dhe rreziqe nga uji
- Stuhitë (tajufuni, valët tropikale dhe tornado)
- Thatësira
- Fatkeqësi kimike industriale

Edhe pse nuk është rrezik natyror, lëvizja e madhe e popullatës e cila shpërngulen si rezultat i katastrofës natyrore apo konflikteve qytetare apo luftës gjithashtu paraqet situatë emergjente serioze humanitare prandaj edhe kjo kategori është kyçur në diskutim.

## **7.1 Tërmetet**

### **Karakteristika të përgjithshme**

Dridhja e tokës shkaktuar nga valët në apo mbi sipërfaqe të tokës që shkakton:

- Dridhje të sipërfaqes së tokës;
- Goditje të sërishme;
- Cunami;
- Dridhje, vibracione;
- Rrëshqitje të tokës.

### **Efekte tipike të papërshtatshme**

- *Dëm fizik* – dëm apo humbje të strukturave apo infrastrukturës. Mund të ndodhin zjarre, dëme të pendave, rrëshqitje të tokës dhe vërshime.
- *Të pësuar* – shpesh herë numri i madh i njerëzve të pësuar, posaçërisht afër epiqendrës, në vende me banorë të dendur apo ku ndërtesat nuk janë të ndërtuara në mënyrë solide.
- *Shëndet publik* – thyerjet janë problemi më i shpeshtë.
- *Furnizim me ujë* – janë të mundshme probleme serioze si rezultat i dëmtimit të sistemit për furnizim me ujë, ndotje të puseve të hapura.
- *Kërcënime sekondare* – si rezultat i vërshimeve, ujit të kontaminuar apo funksionimit të shërbimeve komunale.

### **Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave**

Ndikimi i drejtpërdrejtë i tërmetit ndikon në të gjitha sektoret në bashkësi. Pushtetet lokale fillimisht vëmendjen e vet duhet ta drejtojnë në aktivitetet për kërkim dhe shpëtim. Patjetër duhet të sigurohet ndihmë e shpejtë mjekësore, posaçërisht gjatë 72 orëve të para. Vlerësimi i nevojave gjatë situatës emergjente duhet të zbatohet gjatë 36 deri 72 orët e para.

Përfundimisht, të mbijetuarve do t'ju nevojitet ndihmë humanitare siç është ushqimi, uji dhe strehimi urgjent. Duhet të përkushtohet ndikim në meremetimin e infrastrukturës rugore, lidhje të sërishme të komunikacioneve, komunikim me vende të banuara që nuk ka qasje dhe zbatim të vlerësimit në katastrofa.

Në ëfund të periudhës që vjen meremetimi afatgjatë duhet të jetë prioritet kryesor. Periudha pas tërmetit paraqet mundësi për minëvizimin e rreziqeve të mundshme nëpërmjet sjelljes së ligjeve adekuate dhe konrizes normative për ndërtimin e objekteve që do të ndihmojë në procesin e meremetimit të ndërtimeve. Ndikimi duhet të jetë drejtuar kah:

- Meremetimi dhe rikonstruimi i ujësjellësit, kanalizimit, sistemit elektrik dhe infrastrukturës rrugore.

- Ndiurma teknike, materiale dhe financiare për meremetimin dhe rikonstruimin e shtëpive dhe objekteve publike (me inkorporimin e teknikave adekuate për rrezitim nga tërmetet).
- Programe për ripërtrirjen e ekonomisë
- Ndiurma financiare për huazime për individë dhe ndërmarrje për rimëkëmbje ekonomike

## **7.2 Rrjedhja e baltës dhe mbeturinave rrënojave**

### **Karakteristikat e përgjithshme**

Rrjedhja e baltës dhe mbeturinave dhe rrënojave mund të paraqitet si rezultat i stuhive të mëdha, shiut të pandërprerë, rrjedhjeve të liqeneve malore, apo shkrirja e akullit dhe borës në vendet malore. Me këtë proces një sasi e konsiderueshme e baltës mund të rrjedh prej maleve në fshatrat malore.

### **Karakteristikat e përgjithshme**

Rrjedhja e baltës dhe mbeturinave dhe rrënojave mund të paraqitet si rezultat i fortunave, shiut të pandërprerë, rrjedhja e liqeneve malore, apo shkrirja e akullit dhe borës në vendet malore. Me këtë proces sasi e madhe e baltës mund të rrjedhin prej maleve nëpër fshatëra.

Shum shpesh lëvizja e rrënojave e pengon rrjedhjen e ujit në lumenj. Kur kjo ndodh, mund të formohet pendë që mund të rezultojn me vërshime në rrjedhën e epërme të lumit.

### **Efektet tipike të pafavorshme**

- *Dëmtimet fizike* – gjithçka që gjindet në rrugë të rrjedhave të rrënojave zakonisht shkatërohen, si për shembull: rrugë, ura dhe objekte të ndryshme. Shkatërohet sistemi i i ujitjes dhe sipërfaqet bujqësore mbulohen me baltë.
- *Të lënduar* –njerëzit që janë në rrugët rëshqitëse nga balta mund të lëndohen. Gjithashtu, shpesh herë njerëzit mund të humben ose të lëndohen si rezultat i vërshimeve sekondare.

### **Nevojat tipike për ndihmë gjatë katastrofave**

Në vendet të cilët janë të goditura direkt nga rrëshqitja e baltës, ndoshta do të ketë nevojë për kërkim dhe shpëtim të popullatës së lënduar. Në vendet e

izoluara mund të ketë nevojë për shfrytëzimin e pajisjeve speciale. Gjithashtu, sigurisht do të ketë nevojë për strehim të njerëve shtëpitë e të cilëve janë të shkatëruara. Efektet sekondare të rrëshqitjes së baltës mund të jenë vërshimet, për këtë shkak janë të nevojshëm masat për ndihmë plotësuese.

### **7.3 Rrëshqitja e tokës**

#### ***Karakteristikat e përgjithshme***

Rrëshqitja e tokës mund të jetë nga natyra të ndryshme (rrënimi i tokës, rrëshqitja e tokës, rrëshqitja anësore e tokës, lëvizja e tokës). Rrëshqitja e tokës mund të praqitet si rezultat sekondar i stuhisë dhe tërmetit. Rrëshqitja e tokës është dukuri gjeologjike më e pranishme se ndonjë tjetër.

#### ***Efekte tipike të papërshtatshme***

- *Dëmi fizik* – gjithëçka që është në majë apo në rrugën e rrëshqitjes së dheut, do të përjetojë dëm. Rrënojat mund të bllokojnë rrugë, të pengojnë komunikimet apo rrjedhat e lumenjëve. Efektet indirekte mund të jenë humbje e tokës bujqësore apo pyjeve, vërshime dhe vlerë e ulur e pasurisë.
- *Të pësuar* – mund të ketë raste të vdekjeve si rezultat i rrëshqitjes së dheut. Gjithashtu, lëvizja e rrënojave dhe baltës mund të shkaktojë mijëra njerëz të vdekur.

#### ***Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave***

Nevojat në bazë të pjesëve të goditura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga rrëshqitja e dheut mund të jenë patjetërsueshmëri nga pajisjet për kërkim dhe shpëtim dhe personel profesional, dhe pajisje për largimin e dheut. Gjithashtu mund të ketë nevojë edhe për strehimore për njerëzit shtëpitë e të cilëve janë të dëmtuara apo të shkatëruara. Duhet të konsultohen ekspertë për evaluim të rreziqeve nga rrëshqitja e dheut që të vërtetohet se a paraqesin akoma kërcënim rrëshqitjet për shpëtimtarët apo për banorët.

Nëse rrëshqitja e dheut është e lidhur me tërmetin apo vërshimet, atëherë përkrahja për pjesën e goditur nga rrëshqitja e dheut duhet të jetë pjesë e orvatjeve të përgjithshme për sigurimin e ndihmës gjatë katastrofës.

### **7.4 Cunami**

#### ***Karakteristika të përgjithshme***

Cunami është valë që vështirë mund të hetoen në ujëra të thella dhe mund të jenë në largësi prej 160 kilometra mes secilës pikë më të lartë të valëve dhe mund të jetë me shpejtësi prej 800 kilometra në orë në ujërat e thella oqeanike,

por shpejtësia ulet me ardhjen e valëve kah bregu. Cunami zakonisht godet në breg me valë të valëzuara. Se a do të ketë përmbytje varet nga forma e bregut dhe baticës.

### ***Efekte tipike të padëshirueshme***

- *Dëme fizike* – fuqia e ujit mund të shkatërrojë gjithëçka para vetes por dëmi më i madh paraqitet nga përmbytjet. Tërheqja e valës len baltë dhe shtresa që mund të rezultojë me shkatërrimin e porteve dhe ndërtesave dhe shkatërrim të objekteve lundruese.
- *Të pësuarit dhe shëndeti publik* –raste të vdekjeve ka si rezultat i mbytjeve dhe lëndimeve nga rrënojat të cilat i bartë uji.
- *Drithëra dhe ushqim* –Cunami mund të rezultojë me shkatërrimin e arave dhe kullosave, rezervave me ushqim dhe shkatërrim të barkave të peshkatarëve. Toka mund të bëhet jopjellore si rezultat i përmbytjeve nga uji i njelmët.

### ***Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave***

Përgjigja e parë lokale i kyçë aktivitetet në vijim:

- Implementimi i procedurave për paralajmërim dhe evakuim (para ngjarjes)
- Krahasim të aktiviteteve për kërkim dhe shpëtim në fushën e goditur nga katastrofa
- Sigurimi i ndihmës mjekësore
- Zbatimi i vlerësimit të katastrofës dhe vëzhgimi i gjendjes epidemiologjike
- Sigurim afatshkurtë të ushqimit, ujit dhe strehimores

Përgjigja sekondare lokale i kyç aktivitetet në vijim:

- Riparim dhe rikonstruktim të shtëpive dhe ndërtesave
- Sigurim të ndihmës për bujqit

## ***7.5 Thatësira***

### ***Karakteristika të përgjithshme***

Ulja e ujit dhe lagështisë është me rëndësi të posaçme në bazë të më shumë normave lidhur me mirëqenien e njerëzve dhe botës së kafshëve. Thatësira meteorologjike paraqet uljen e të rreshurave, ndërsa thatësira hidrologjike

paraqet uljen e resurseve ujore. Thatësira bujqësore paraqet ndikimin e thatësirës në aktivitetet e njerëzve si rezultat i ndikimit të më shumë faktorëve: prani të sistemeve për ujitje, kapaciteti i tokës për të mbajtur lagështinë, sezonet e shiut dhe sjellja adaptuese e bujqëve.

### ***Efekte tipike të padëshirueshme***

- *Efekte ekonomike* – humbje në prodhimtari të drithërave, prodhimet e qumshqit dhe kafshëve, industrisë së drurit dhe peshkimit, rënie në rritjen nacionale dhe zhvillimin e konomik; humbje në të ardhurat për fermerë dhe kategori tjera të goditura drejtëpërsëdrejti; humbje në turizëm dhe biznesin rekreativ; humbje për industrinë hidro – energjetike dhe çmim i rritur në energji; ulje në prodhimtarinë e ushqimit dhe çmime të rritura të prodhimeve ushqimore; përqindje e rritur e papunësisë si rezultat i uljes së prodhimtarisë nga thatësirat; humbje të të ardhurave për qeverinë dhe shtypje e rritur në institucionet financiare.
- *Efekte të mjedisit jetësor* –dëm në rrethin jetësor të kafshëve dhe peshqive; erozion të tokës si rezultat i erës dhe mungesës së ujit; dëmtim të bimëve; efektet e kualitetit të ujit; efekte të kualitetit të ajrit (pluhur, ndotje, pamje e ulur).
- *Efekte sociale shëndetësore* – efekte si rezultat i mungesës së ushqimit (mosuhqim, uri); humbje të jetës së njerëzve si rezultat i mungesës së ushqimit apo kushteve tjera të cilat janë të lidhura me thatësirat; konflikte për ujë mes përdoruesve të ujit; probleme shëndetësore si rezultat i sasive të ulura të ujit; rënie të standardit jetësor dhe kushte të përkeqësuar për jetë në mjediset rurale; varfëri e rritur, kualitet i ulur i jetës; trazira dhe konflikte sociale; migrimi i popullatës në kërkim të punës apo për shkak të marjes së ndihmave humanitare.

### ***Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave***

Popullatës së goditur nga thatësira do t'i nevojitet ndihmë për kompensimin e mjeteve të humbura gjatë mungesës së ushqimit dhe për kompensimin e bagëtisë së tyre. Serioziteti i episodit me mungesë të ushqimit do ta përcoaktojë natyrën dhe shkallën e nevojave për rehabilitim. Prandaj, nëse vjen deri në migrim të popullatës në kampe apo dukshëm rritet vdekshmëria e popullatës atëherë do të nevojitet që të implementohet program gjithëpërfshirës rehabilitues. Ai mund të jetë i përpiluar nga sigurimi i kujdesit shëndetësor, këshilla, ndihmë për emigrantët që të kthehen në shtëpitë e tyre dhe përkrahje materiale për rehabilitimin e shtëpive dhe për meremtimin e aktiviteteve prodhuese.

Përkrahja mund të jetë e përbërë prej sigurimit të farave, mjeteve, pajisjeve për gatim, batanie dhe përkrahje për rimëkëmbjen e familjeve deri sa nuk kanë mundësi që të mbijetojnë në mënyrë të pavarur. Nëse ndikimi i mungesës së



ushqimit nuk është serioz dhe shumica e familjeve nuk e kanë patur patjetër të shesin patundshmëri atëherë ndoshta edhe nuk do të ketë nevojë për program rehabilitues. Prandaj nevojat rehabilituese duhet me kujdes të vlerësohen dhe intervenimet të planifikohen në pajtueshmëri me secilën situatë individuale.

## **7.6 Përmytje**

### **Karakteristika të përgjithshme**

Ka disa lloje të përmytjeve:

- *Përmytje të rrëmbyeshme* – rritje e rrjedhës së ujit, penda të dëmtuara, shkrirje të akullnajave
- *Përmytje të lumenjëve* – rritje e ngadalshme e nivelit, e thjeshtë sezonale
- *Përmytje bregdetare* –si rezultat i stuhive, cunami valë, ciklone tropikale.

### **Efekte tipike të padëshirueshme**

- *Dëm fizik* – struktura të dëmtuara si rezultat i gjetjes së ujit, rrënim të objekteve, dhe rrënoja të cilat lundrojnë me ujin.
- *Të pësuar dhe shëndet publik* – raste të vdekjes si rezultat i mbytjes në ujë por pa numër të madh të njerëzve të lënduar seriozisht. Paraqitje e mundshme e malaries, diarrea dhe infeksione me virus.
- *Furnizim me ujë* – kontaminim i mundshëm i puseve dhe ujë sipërfaqësore. Mund të ketë ujë të pastërt për pije.
- *Drithëra dhe ushqim* – drithërat dhe rezervat me ushqim mund të humben si rezultat i përmytjeve. Gjithashtu mund të humben edhe kafshë, mjete bujqësore dhe fara.
- Kërcënim sekondar si rezultat i rrëshqitjes së dheut nga shiu apo nga lëvizja e rrënojave me ujin. Dëmi është më i madh në lugina se sa në sipërfaqe të hapura.

### **Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave**

Përgjigja fillestare e pushteteve lokale për përkrahjen e popullatës së goditur nga përmytjet duhet të jetë në formë të aktiviteteve në vijim:

- Kërkim dhe shpëtim
- Ndihmë mjekësore
- Vlerësim i katastrofës

- Sigurim të sasive afatshkurte të ujit dhe ushqimit
- Pastrim i ujit
- Vëzhgim të gjendjes epidemiologjike
- Sigurim të strehimores

## **7.7 Ciklone tropikale**

### **Karakteristika të përgjithshme**

Kur ciklonet do ta godasin tokën, erëra të fuqishme, të rreshura dhe stuhi të jashtëzakonshme, shkaktojnë dëm të përcjellur me përmytje sekondare dhe rrëshqitje të tokës.

### **Efekte tipike të padëshirueshme**

- *Dëm fizik* – objekte të rrënuara dhe të dëmtuara nga fuqia e erës, përmytjet, stuhia dhe rrëshqitja e tokës. Nga përmytjet mund të paraqitet erozion dhe stuhi.
- *Të pësuar dhe shëndeti publik* – në përgjithësi, ka shumë pak raste fatale por mund të ketë shumë të lënduar të cilët kanë nevojë për kujdes spitalor. Stuhitë gjithashtu mund të shkaktojnë shumë raste të vdekjes, por tek të mbijetuarit ka lëndime më të vogla. Lëndimet të cilat ndodhin mund të jenë të shkaktuara nga fluturimi i rrënojave apo nga vërshimet. Kontaminimi i ujit mund të sjellë deri tek sëmundjet viroze dhe malaria.
- *Furnizim me ujë* – pusët e hapura dhe uji sipërfaqësor mund të kontaminohen nga uji i vërshuar dhe nga stuhia. Burimet normale të ujit mund të jenë të pakapshme disa ditë.
- *Kulturat dhe ushqimi* – erërat e fuqishme dhe shiu mund t'i shkatërrojnë kulturat, plantazhet me dru dhe rezervat e ushqimit. Plantazhet me banane dhe kokos janë jashtëzakonisht të mjerueshmenë dukuri të tillë kohore.
- *Komunikime dhe logjistikë* – ka mundësi për çrregullime serioze për shkak se era mund t'i shkatërrojë linjat telefonike, antenat dhe pjatat satelitore. Mund të vijë edhe deri tek shkatërimi i trafikut tokësor.

### **Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave**

Përgjigja fillestare e pushteteve, organizatave dhe popullatës lokale do të përbëhet prej masave në vijim:

- Evakuim dhe sigurim të strehimores emergjente
- Kërkim dhe shpëtim
- Ndihmë mjekësore

- Sigurim të ushqimit dhe ujit
- Pastrimi i ujit
- Përcjellje epidemiologjike të situatës
- Zbatim i sërishëm i rrjeteve logjistike dhe komunikative
- Vlerësimi i katastrofës
- Pastrimi i rrënojave
- Sigurimi i farave për mbjellje

## **7.8 fatkeqësi kimike dhe industriale**

### **Karakteristika të përgjithshme**

Fatkeqësitë kimike dhe industriale rezultojnë me lëshimin e materieve të rrezikshme (toksike) në mjedisin jetësor. Këto fatkeqësi mund të paraqiten kur të ndodhin fatkeqësi hekurudhore të trenave të cilët bartin materie kimike, gjatë rrotullimit të kamionëve, gjatë kërsitjeve të gypave përçues kur vie deri në lirimin e kimikaleve të rrezikshme dhe gazërave në mjedisin jetësor, dhe kur të vie në rrjedhjen apo lirimin e materieve nga substancat kimike apo bërthamore. Substancat e rrezikshme të cilat lirohen në ajër apo ujë mund të arrijnë largë.

### **Efekte tipike të padëshirueshme**

- *Dëmi fizik* – dëm apo shkatërrim mund të paraqiten në strukturë dhe infrastrukturë. Komunikacionet transportuese me automjete të dëmtuara dhe objekte tjera si rezultat i goditjes. Zjarret industriale mund të arrijnë temperatura të larta dhe të godasin pjesë të mëdha.
- *Të pësuar* – shumë njerëz mund të humbin jetën apo të lëndohen dhe të kenë nevojë për kujdes mjekësor.
- *Kultura, kafshë dhe ushqim* – mund të vijë deri në kontaminimin e kulturave, ushqimit dhe helmimin e kafshëve.
- *Dëmi i mjedisit jetësor* – kontaminimi i ujit, ajrit dhe tokës. Fushat mund të bëhen të papërshtatshme për jetë. Mund të vijë deri në çrregullimin e sistemeve ekologjike në nivel global.

### **Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave**

Në rast të katastrofave kimike, ekipet mjekësore dhe ekipet për sigurimin e përkrahjes emergjente duhet t'i bartin personat e lënduar nga vendi i fatkeqësisë. Të gjithë personat duhet ta lëshojnë vendin vetëm nëse nuk janë të mbrojtur me pajisje speciale. Ato duhet të rrinë anash deri sa të vërtetohet dhe shpallet se është e sigurt për njerëzit që të kthehen në atë pjesë. Në rast të kontaminimit të ujit duhet të sigurohen burime alternative për furnizim me ujë.

Pastrimi i terrenit nga efektet e katastrofës mund të shpie nevojë për më shumë resurse se sa që janë të kapshme në mënyrë lokale. Mund të ketë nevojë për

ndihmë emergjente ndërkombëtare. Pjesët e goditura duhet të vëzhgohen vazhdimisht pas ndodhjes së katastrofës. Kontrollim dhe dokumentim rrënjësor të gjendjes emergjente patjetër duhet të bëhet nga personat përgjegjës.

## **7.9 Popullata e ëshpërngulur**

### ***Karakteristika të përgjithshme***

Popullata e shpërngulur mund të jetë e përbërë nga njerëz të cilët janë të vendosur në strehimore të përkohshme apo kampe si rezultat i lëvizjes masive të popullatës. Gjithashtu persona dhe familje të cilat nuk marrin pjesë në konflikt mund të jenë të detyruar t'i lëshojnë shtëpitë e tyre si rezultat i pasojave nga konflikti i caktuar por prapë të mbesin në vendin e njëjtë. Popullatë e shpërngulur mund të jenë edhe njerëz të cilët janë të përzënë apo ikin nga vendi, posaçërisht grupë e caktuar etnike apo nacionale të detyruar për shkak të shkaqeve ekonomike apo politike. Popullata mund të shpërngulet dhe t'i braktisin shtëpitë e veta si rezultat i thatësirave, urisë apo katastrofës tjetër, zakonisht për kërkim të ushqimit.

### ***Efekte tipike të padëshirueshme***

- Humbje e mjeteve për jetesë
- Humbje të burimeve normale për ushqim
- Mungesë e karburanteve për gatim
- Mungesë e ujit për pije
- Sëmundje dhe mbipopullim
- Numër i madh i fëmijëve të pashoqëruar
- Mungesë e strehimores

### ***Nevoja tipike për ndihmë gjatë katastrofave***

Edhe pse nevojat mund të dallohen sipas situatës, në përgjithësi ato do të jenë:

- Furnizim me ujë dhe kanalizim
- Shpërndarje të ushqimit në mënyrë afatshkurte dhe afatgjate
- Vëzhgim i situatës epidemiologjike dhe të ushqyerit
- Strehim emergjent
- Batanie, karburante për amvisëri dhe mallëra tjera, medikamente, vaksina, kujdes shëndetësor
- Shërbime shoqërore dhe sociale, posaçërisht për fëmijë pa shoqërim
- Krijim i lidhjeve familjare, mbrojtje dhe siguri

## **Aneksi 1a – formular për përgatitjen e raportit për vlerësim të nevojave gjatë katastrofave – me udhëzime**

Bazuar në formatin e përgatitur nga ana e zyrës për përgatitshmëri gjatë katastrofave të federatës ndërkombëtare

<b>PËRGATITUR NGA:</b> Emri i personit i cili ka përgatitur raportin	<b>VENDI:</b> Vendi ku ka ndodhur katastrofa	<b>RAJONI:</b> Rajoni ku ka ndodhur katastrofa
<b>ORGANIZATA:</b> Emri i shoqatës nacionale / OKKK	<b>DATA:</b> Data kur është përgatitur raporti	<b>NUMRI I RAPORTIT:</b> Numri i raportit nëse ka nevojë ta përcjellin të tjerët

Kur të përgatitet formulari siguroni informacione të plota dhe më të reja në të cilat keni qasje. Përskaj kësaj theksoni burimin e të dhënave apo të informacioneve. Për shembull, “10.000 persona të vdekur sipas informacioneve të zyrës së kryetarit të qytetit”. Nëse burimi i informacioneve nuk është i njohur, shkruani: “Burimi i informacioneve për momentin nuk është i njohur”.

### **I. Katastrofa**

#### **A. Lloji i katastrofës:**

Theksoni llojin e katastrofës (për shembull: cikloni, tërmeti, vërshimet, zjarret, fatkeqësi kimike etj).

#### **B. Kur ka ndodhur katastrofa?**

Cekni datën e ndodhjes së katastrofës. Cekni “datat” nëse ka pasur më shumë katastrofa të njëpasnjëshme. Për shembull, tërmete, pastaj dridhje të njëpasnjëshme.

### **C. Përshkruani shkurt katastrofën (nëse ka nevojë shtoni fleta shtesë)**

Siguroni përshkrim të shkurtë narativ të katastrofës. Cilat kanë qenë karakteristikat e katastrofës (fuqia e dridhjes, shpejtësia e erës, etj)? Sa është serioz dëmi? Në pjesën narative tregoni se sa kanë qenë humbjet dhe cilat janë nevojat afatshkurte dhe afatgjate. Sa njerëz janë goditur nga katastrofa dhe në sa rajone? Kjo pjesë narative nuk duhet të jetë më e gjatë se 2 deri në 4 pasuse. Thjeshtë qëllimi juaj është të jepni pasqyrë të shpejtë të katastrofës dhe dëmi dhe nevojat të cilat dalin nga katastrofa.

### **Ç. Pjesa e saktë gjeografike dhe lokacioni (rajoni, qytet dhe lokacioni?)**

Përshkruani vëllimin gjeografik të katastrofës, si dhe pjesët e goditura nga katastrofat sekondare (për shembull, stuhia, rrëshqitja e dheut, përmbytjet), emri i rajoneve të goditura, qytetet, fshatrat:

## **II. Ndikimi / efektet e katastrofës**

### **A. Sa njerëz janë goditur nga katastrofa dhe sa përqind e popullatës së përgjithshme është goditur nga katastrofa?**

Shkruani numrin e njerëzve të cilët janë goditur nga katastrofa – numri i të vdekurve, të lënduarve, si dhe numri i shtëpive të dëmtuara dhe të shkatërruara dhe llogaritni se sa përqind e popullatës së përgjithshme është goditur nga katastrofa. Nëse ka mundësi paraqiteni strukturën gjinore, moshën dhe të dhënat demografike të popullatës së goditur.

### **B. Sa raste të të vdekurve ka si rezultat i katastrofës?**

Tregoni sa të vdekur ka si rezultat i kësaj katastrofe. Gjithashtu theksoni burimin e informacionit.

### **C. Sa ka të lënduar si rezultat i katastrofës?**

Nëse ka mundësi, shkruani strukturën gjinore dhe moshën e popullatës së goditur dhe shkaku për lëndimet e tyre.

### **Ç. Sa njerëz janë të shpërngulur apo të evakuuar?**

Gjithashtu identifikoni se ku kanë shkuar njerëzit dhe nëse është e mundshme

tregoni strukturën gjinore, moshën dhe strukturën e familjeve të popullatës së goditur.

**D. Sa familje janë të goditura nga katastrofa?**

Nëse ka mundësi, paraqiteni strukturën gjinore dhe moshën e popullatës së goditur.

**Dh. Sa amvisëri apo vendbanime janë të shkatërruara në tërësi?**

Shkruani më poshtë sa shtëpi dhe vendbanime janë të shkatërruara dhe që nuk mund të meremetohen

**E. Çfarë dëmi fizik dhe/ apo financiar ka në shtëpinë, ndërtesat dhe infrastrukturën e pjesës së goditur?**

Theksoeni vëllimin e dëmit fizik dhe humbjeve financiare për biznesin, institucionet shtetërore dhe patundshmërinë private dhe tregoni se çfarë dëmi ka në infrastrukturë (rrugë, ura, sisteme komunikimi etj).

**Ë. Çfarë dëmi fizik dhe/apo financiar ka në kultura dhe në bagëti?**

Caktoni shumën dhe vëllimin e dëmit fizik dhe financiar të kulturave dhe bagëtive?

**H. Cili është dëmi dhe shpenzimet e pritura financiare të sektorit korporativ në pjesën e goditur?**

Tregoni shumën e dëmit financiar dhe shpenzimet të cilat do t'i përballojë sektori korporativ si rezultat i katastrofës.

### III. Resurse lokale financiare, materiale dhe njerëzore

**A. Me çfarë resurse dhe kapacitete disponon popullata lokale që të përgjigjet në katastrofa, dhe si mund të përdoren ato resurse?**

Paraqiteni atë më poshtë.

KAPACITETE DHE RESURSE LOKALE	PROPOZIME PËR PËRDORIM
Shembull. Grupë / asociacion cullnetar nga fqinjët	Përgatitje dhe shpërndarje të ushqimit për personat e shpërngulur dhe të pastrehurit

**B. Çfarë objekte transporti dhe depoje (komerciale, qeveritare, Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe) janë menjëherë të kapshme në nivel lokal për përdorim?**

Theksoni çfarë kapacitete transportuese dhe depoje mund të futen menjëherë në përdorim për bartjen dhe shpërndarjen e ndihmës humanitare  
 .....

**C. Si është qasja, lokacioni dhe kushtet në rrjetin rrugor, aeroportet, herurudhë?**

Nëse duhet të bartet ndihmë emergjente me kamionë, anije apo tren, me rëndësi është që të theksohet gjendja e rrjetit rrugor, aeroportet, portet dhe hekurudha .....

**Ç. Si është kapaciteti i shoqatës nacionale të Kryqit të kuq për menaxhim me katastrofa?**

Çka ka bërë deri në këtë moment shoqata nacionale për të siguruar ndihmë për popullatën e goditur nga katastrofa. Çka mundet më tej të bëjë?  
 .....



#### IV. Nevoja emergjente

Siguroni përgjigje në pyetjet e parashtruara më poshtë:

**A. A është zbatuar vlerësim detal i nevojave?** Ju lutemi të dorëzoni kopje të rezimesë së përgatitur për nevojat primare.

*Përshkruani nevojat e paplotësuara në bazë të sigurimit të strehimores, ujit, sanitacionit, ushqimit, nevojave për amvisëri (rroba, batanie, enë për gatim, karburante për gatim etj) dhe nevoja shëndetësore (medikamente, pajisje, ente operative për përkrahje). Nevojat paraqitni në sasi dhe me përshkrim në bazë të kualitetit (për shembull, 110 persona të rritur dhe 200 fëmijë kanë nevojë për ushqim dhe ujë për së paku 20 ditë.) Sipas nevojës bashkangjitni edhe fleta plotësuese që të paraqitni bevojat.*

.....

.....

.....

.....

**B. Kush e zbatoi vlerësimin e nevojave?**

.....

.....

**C. Cilat janë nevojat më primare dhe kush do t'i sigurojë? Plotësoni kolonat më poshtë sipas gjendjes.**

DUHET TË SIGUROHET NGA					
PRODHIMI	SASIA E NEVOJSHME	QEVERIA	KRYQI I KUQ	OJQ (theksoni)	TË TJERË (theksoni)

## V. Nevoja afatgjate

Siguroni përgjigje në pyetjet e parashtruara më poshtë:

**Ç. Çka do të nevojitet në plan afatgjat (pas muajit të parë) dhe kush do ta sigurojë atë? Duhet të parashikohen problemet serioze apo nevojat të cilat mund të paraqiten në muajt e ardhshëm si rezultat i katastrofës dhe ngjarjeve të ardhshme potenciale (ardhja e dimrit apo sezonit të shiut etj)**

		DUHET TË SIGUROHET NGA			
PRODHIMI	SASIA E NEVOJSHME	QEVERIA	KRYQI I KUQ	OJQ (theksoni)	TË TJERË (theksoni)

## VI. Puna e shoqatës nacionale

### D. Jepni përshkrim të shkurtë se çka propozon shoqata nacionale që të ndërmerret. (Sipas nevojës bashkangjitni edhe fleta tjera)

*Shkruani çka propozon të bëjë shoqata juaj nacionale / OKKK si përgjigje në situatën emergjente*

.....

### DH. Sa supozohet të zgjatë operacioni i shpqtës nacionale?

*Shkruani sa gjatë pritni ta implementoni operacionin për përgjigje emergjente të shoqatës tuaj*

.....

### E. Cilat grupe i keni zgjedhur të cilat do t'i ndihmoni dhe pse?

*Shkruani se cilat grupe janë caku u intervenimit tuaj dhe sqaroni se pse e keni zgjedhur këtë grupë dhe popullatë përkundër grupeve tjera*

.....

### Ë. Çfarë lloji transporti dhe mjete transportuese do të jenë të nevojshme dhe kush do t'i sigurojë?

*Shkruani për çfarë lloji transporti keni nevojë për përkrahjen e operacionit emergjent për përgjigje në katastrofa. Gjithashtu theksoni se si planifikoni ta përkrahni këtë transport.*

.....

### H. Kush do ta zbatojë operacionin e shoqatës nacionale (të punësuarit, vullnetarët)?

*Shkruani se me çfarë resurse njerëzore dispononi për realizimin e operacionit për përgjigje në katastrofë*

.....

### G. Kush është përgjegjës për përgatitjen e raporteve për donatorë dhe kur duhet të dorëzohen raportet?

*Shkruani se kush do të komunikojë dhe do të dorëzojë raporte tek donatorët. Shkruani sa herë do t'i dorëzoni raportet për përcjelljen e përparimit dhe për realizimin e opracionit.*

.....

## VI. Puna e shoqatës nacionale (vazhdim)

**D. Cilat resurse janë të nevojshme për punën dhe prej ku mund të sigurohen?**

*Plotësoeni formularin më poshtë për secilin prodhim në vete që është i nevojshëm gjatë operacionit për sigurimin e ndihmës për menaxhim me katastrofën.*

PRODHIMI	SASIA E PËRGJITHSHME QË NEVOJITET	NUMËR I KAPSHËM NË VEND	SASIA E NEVOJSHME NGA JASHTË	VENDI MË I AFËRT PREJ KU MUND TË SIGUROHET

## VII. Shënime plotësuese, Kërkesa, apo Informacione

*Në këtë formular lirisht mund të shtojmë informacione plotësuese për të cilat mendoni se janë të rëndësishme për operacionin. Ato mund të jenë lidhur me kontekstin politik, tenzionet lokale etnike, historinë e katastrofave dhe përgjigjen e ndërmarrë në pjesën, dhe faktorë të tjerë të ngjashëm kontekstual. Nëse këtë formular e përdorni për apel ndërkombëtar, siguroni informacione plotësuese në tabelën për buxhet në faqen tjetër.*

## VIII. Buxheti

Plotësoeni formularin buxhetar (sasinë, çmimin dhe shpenzimet e përgjithshme).

Linja buxhetare	Sasia	Çmimi (valuta)	Shpenzime të përgjithshme
Prodhime			
Pajisje			
Transporti			
Resurse njerëzore			
Shpenzime për rrugë			
Shpenzime administrative			
Shpenzime për komunikim			
Shpenzime tjera			
<b>SHPENZIME TË PËRGJITHSHME</b>			

## **Aneksi 1b – Formular për dorëzimin e raportit për vlerësimin e nevojave gjatë katastrofave**

Bazuar në formatin e përgatitur nga ana e zyrës për përgatitshmëri gjatë katastrofave të federatës ndërkombëtare.

<b>PËRGATITUR NGA:</b>	<b>VENDI:</b>	<b>RAJONI:</b>
<b>ORGANIZATA:</b>	<b>DATA:</b>	<b>NUMRI I RAPORTIT:</b>

Kur përgatitet formulari siguroni informacione të plota dhe më të reja të cilat i keni të kapshme. Nëse burimi i informacioneve nuk është i njohur, shkruani, “Nuk dihet burimi i informacioneve për momentin”.

### **I. Katastrofa**

#### **A. Lloji i katastrofës:**

Rrethoni llojin e katastrofës:

- Cikloni,
- Tërmet,
- Përmytje,
- Zjarr,
- Fatkeqësi kimike,
- Tjetër (shkruani \_\_\_\_\_)

#### **B. Kur ka ndodhur katastrofa?**

\_\_\_\_\_.



## II. Ndikimi / efektet e katastrofës

A. Sa njerëz janë goditur nga katastrofa dhe sa përqind e popullatës së përgjithshme është goditur?

---

B. Sa ka raste të vdekjeve si rezultat i katastrofës? Nëse ka mundësi, paraqiteni strukturën gjinore dhe moshën e popullatës së goditur dhe shkakun për lëndimet e tyre.

---

C. Sa ka të lënduar si rezultat i katastrofës? Nëse është e mundshme, paraqiteni strukturën gjinore dhe moshën e popullatës së goditur dhe shkakun për lëndimet e tyre.

---

Ç. Sa njerëz janë të shpërngulur apo të evakuuar? Колку луѓе се раселени или евакуирани? Gjithashtu identifikoni se ku kanë shkuar njerëzit dhe nëse është e mundshme tregoni strukturën gjinore, moshën dhe strukturën e familjeve të popullatës së goditur.

---

D. Sa familje janë të goditura nga katastrofa?

Nëse ka mundësi, paraqiteni strukturën gjinore dhe moshën e popullatës së goditur.

---

Dh. Sa amvisëri apo vendbanime janë të shkatërruara në tërësi?

---

E. Çfarë dëmi fizik dhe/apo financiar ka pëtundshmëria, ndërtesat dhe infrastruktura në pjesën e goditur?

---

Ë. Çfarë dëmi fizik dhe/apo financiar kanë kullosat dhe bagëtia?

---

H. Cili është dëmi dhe shpenzimet e pritura financiare të sektorit korporativ në pjesën e goditur?

---



### III. Resurse lokale financiare, materiale dhe njerëzore

**A. Me çfarë resurse dhe kapacitete disponon popullata lokale që të përgjigjet në katastrofa, dhe si mund të përdoren ato resurse?**

Paraqiteni atë më poshtë.

KAPACITETE DHE RESURSE LOKALE	PROPOZIME PËR PËRDORIM
Shembull. Grupë / asociacion cullnetar nga fqinjët	Përgatitje dhe shpërndarje të ushqimit për personat e shpërngulur dhe të pastrehurit

**B. Çfarë objekte transporti dhe depoje (komerciale, qeveritare, Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe) janë menjëherë të kapshme në nivel lokal për përdorim?**

Theksoni çfarë kapacitete transportuese dhe depoje mund të futen menjëherë në përdorim për bartjen dhe shpërndarjen e ndihmës humanitare  
.....

**C. Si është qasja, lokacioni dhe kushtet në rrjetin rrugor, aeroportet, herurudhë?**

**Ç. Si është kapaciteti i shoqatës nacionale të Kryqit të kuq për menaxhim me katastrofa?**

#### IV. Nevoja emergjente

Siguroni përgjigje në pyetjet e parashtruara më poshtë:

**A. A është zbatuar vlerësim detal për nevojat? Дали е спроведена детална процена на потреби?** Ju lutemi të dorëzoni kopje të rezimesë së përgatitur për nevojat primare.

*Përshkruani nevojat e paplotësuara në bazë të sigurimit të strehimores, ujit, sanitacionit, ushqimit, nevojave për amvisëri (rroba, batanie, enë për gatim, karburante për gatim etj) dhe nevoja shëndetësore (medikamente, pajisje, ente operative për përkrahje). Nevojat paraqitni në sasi dhe me përshkrim në bazë të kualitetit (për shembull, 110 persona të rritur dhe 200 fëmijë kanë nevojë për ushqim dhe ujë për së paku 20 ditë.) Sipas nevojës bashkangjitni edhe fleta plotësuese që të paraqitni bevojat.*

.....

.....

.....

.....

**B. Kush e ka zbatuar vlerësimin për nevojat?**

.....

.....

**C. Cilat janë nevojat më primare dhe kush do t'i sigurojë? Plotësoni kolonat më poshtë sipas gjendjes.**

DUHET TË SIGUROHET NGA					
PRODHIMI	SASIA E NEVOJSHME	PRODHIMI	SASIA E NEVOJSHME	PRODHIMI	SASIA E NEVOJSHME

## V. Nevoja afatgjate

Siguroni përgjigje për pyetjet e parashtruara më poshtë:

**G. Çka do të nevojitet për plan afatgjatë (pas muajit të parë) dhe kush do ta sigurojë atë? Duhet të parashikohen problemet serioze apo nevojat të cilat mund të paraqiten në muajt në vijim si rezultat i katastrofës dhe ngjarjeve të ardhshme potenciale (ardhja e dimrit apo sezoni i shiut, etj.)**

		DUHET TË SIGUROHET NGA			
PRODHIMI	SASIA E NEVOJSHME	QEVERIA	KRYQI I KUQ	OJQ (theksoni)	TË TJERË (theksoni)

## **VI. Puna e shoqatës nacionale**

**D. Jepni përshkrim të shkurtë se çka propozon shoqata nacionale të bëjë. (sipas nevojës bashkangjitni edhe fleta plotësuese)**

.....

.....

.....

**DH. Sa supozohet që do të zgjasë operacioni i shoqatës nacionale?**

.....

.....

.....

**E. Cilat grupe i keni zgjedhur të cilët do t'i ndihmoni dhe pse?**

.....

.....

.....

**Ë. Kush do ta realizojë operacionin e shoqatës nacionale (të punësuarit, vullnetarët)?**

.....

.....

**H. Kush është përgjegjës për përgatitjen e raporteve për donatorë dhe kur duhet të dorëzohen raportet?**

.....

.....

.....

## VI. Puna e shoqatës nacionale (vazhdim)

D. Cilat resurse janë të nevojshme për punën dhe prej ku mund të sigurohen?

PRODHIMI	SASIA E PËRGJITHSHME QË NEVOJITET	NUMËR I KAPSHËM NË VEND	SASIA E NEVOJSHME NGA JASHTË	VENDI MË I AFËRT PREJ KU MUND TË SIGUROHET

## VII. Vërejtje plotësuese, Kërkesa apo Informacione

*Në këtë formular lirisht mund të shtojmë informacione plotësuese për të cilat mendoni se janë të rëndësishme për operacionin. Ato mund të jenë lidhur me kontekstin politik, tenzionet lokale etnike, historinë e katastrofave dhe përgjigjen e ndërmarrë në pjesën, dhe faktorë të tjerë të ngjashëm kontekstual. Nëse këtë formular e përdorni për apel ndërkombëtar, siguroni informacione plotësuese në tabelën për buxhet në faqen tjetër.*

**VIII. Buxheti**

<b>Linja buxhetare</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi (valuta)</b>	<b>Shpenzime të përgjithshme</b>
<b>Prodhimi</b>			
Mbledhja			
<b>Pajisje</b>			
Mbledhja			
<b>Transporti</b>			
Mbledhja			
<b>Resurse njerëzore</b>			
Mbledhja			
<b>Shpenzime për rrugë</b>			
Mbledhja			
<b>Shpenzime administrative</b>			
Mbledhja			
<b>Shpenzime tjera</b>			
<b>SHPENZIME TË PËRGJITHSHME</b>			

## Aneksi 2: Lista për kontrollim për vlerësimin e shpejtë të nevojave

- **Numri i personave të goditur të cilët kanë nevojë për ndihmë.** Ky numër do t'i përcaktojë të gjitha llogaritjet tjera, prandaj nevojat duhet të vërtetohen në mënyrë sa më precize.
- **Nevoja për ujë.** Do të jetë ideale nëse secili person merr nga 15 litra ujë për pije në ditë me çka do të mund t'i mbulojë nevojat për ujë për pije, ujë për gatim dhe ujë për higjienë personale. Për spitalet, norma është 100 litra për person në ditë, për pacientë dhe personelin. Duhet të ketë vend për furnizim me ujë për çdo 250 njerëz ndërsa distanca maksimale nga strehimorja deri në burimin më të afërt me ujë duhet të jetë më së shumti 500 metra. Secila familje duhet të furnizohet me 2 enë për ujë nga 10 – 20 litra, si dhe enë për grumbullimin e ujit prej 20 litra.
- **Nevoja për strehimore.** Nëse përdoren tenda, njëra tendë duhet të jetë për 4 deri 6 persona – në rrethana ideale për familje të njëjtë. Vendosni se a ju duhen tenda për dimër apo për verë. A duhet të jenë rrezistuese ndaj ujit apo të mbështjellura? A mund të përdoren strehimoret lokale për situata emergjente në vend të tendave? A ka nevojë për mbulesë plotësuese për mbrojtje nga i nxehti apo shiu? A duhet të sigurohet mbulesë prej pëlhure? A nevojiten najlona për mbulimin e tendave? Nëse përdoren ndërtesa publike, për secilin person duhet të ndahen 3m<sup>2</sup> hapësirë. A është planifikuar nxemje për strehimoren? Nëse është planifikuar do të ngrohet me trupa për nxemje me kerozinë apo dizel?
- **Nevojë për ushqim.** Në rrethana ideale duhet të sigurohen minimum 2.100 kilo kalori ushqim për person në ditë. Niveli energjik për mbijetesë për të rritur është minimum 1.000 kilo kalori në ditë. Për ushqim plotësues duhet të shtohet ushqim energjik që të arrihet deri në 2.100 kilo kalori në ditë si dhe ushqim special për trajtim të individëve të cilët vuajnë nga mos ushqimi i mjaftueshëm. Këto norma duhet të përcillen në pajtueshmëri me normat e vërtetuara në standarde ndërkombëtare (sfera standarde minimum).
- **Nevoja sanitare.** Maksimum 20 njerëz duhet të përdorin 1 toalet. Toaletet nuk mund të jenë më afër se 50 metra nga vendbanimet apo jo më afër se 1 minutë ecje për tek vendbanimet. Toaletet gjithashtu duhet të jenë të larguara së paku 30 metra nga burimet e ujit sipërfaqësor, ndërsa fundi i toaleteve polake duhet të jetë së paku 1.5 metra mbi nivelin e ujit. Duhet të ekzistojnë kontejnerë apo sisteme për hudhjen e mbeturinave të forta. Një kontejner prej 100 litrave duhet të jetë në dispozicion në çdo 10 familje. Vertetoni nevojën dhe metodat për kontrollim vektorial (miza, minjë, mushkonja etj.).
- **Nevojë për karburante.** Gjatë zbatimit të vlerësimit shpeshherë lihen pas dore nevojat dhe qasja e njerëzve tek drunjët për nxemje, qymyri

apo karburantet. Nuk ekziston rregull e përgjithshme për llogaritjen e nevojave, për shkak se klima, traditat dhe kualiteti i karburantit dallojnë dukshëm. Vlerësimet duhet të përcaktojnë se cili lloj i karburantit është adekuat për nevojat e njerëzve, ku të gjendet, si të transportohet dhe shpërndahet dhe cila është sasia e duhur për kënaqjen e nevojave elementare.

- **Nevoja për kujdes shëndetësor.** Duhet të ketë klinikël të vogël në çdo 10.000 – 35.000 njerëz, si dhe spitale dhe qendër kirurgjike për çdo 250.000 – 500.000 njerëz. Shkalla e vdekshmërisë duhet të përcillet në pajtueshmëri me standardet dhe metodat e përgjithshme të pranuar ndërkombëtare (sfera standarde minimale).



## **Aneksi 3: shembull i listës për kontrollim për vlerësim fillestar shëndetësor (Sfera standarde minimum)**

### **Përgatitje**

- Siguroni informacione të kapshme për popullatën e goditur nga katastrofa dhe resurset nga ministritë dhe organizatat në vend.
- Siguroni harta dhe fotografi të kapshme të fotografuara nga ajri.
- Siguroni të dhëna demografike dhe shëndetësore nga organizatat ndërkombëtare.

### **Vlerësim në teren**

- Vërtetoni numrin e përgjithshëm të popullatës së goditur nga katastrofa dhe krahasimi proporcional i fëmijëve të moshës nën 5 vjet.
- Vërtetoni moshën dhe strukturën gjinore të popullatës.
- Identifikoni grupet të cilat janë të shfaqura në rrezik më të madh.
- Vërtetoni madhësime mesatare të amvisërive dhe numrin e familjeve ku shtylla e familjes është gruaja.

### **Informacione shëndetësore**

- Identifikoni problemet primare shëndetësore nga vendi i ardhjes nëse bëhet fjalë për të ikurit.
- Identifikoni problemet primare shëndetësore në pjesën e goditur nga katastrofa nëse nuk janë në pyetje të ikurit.
- Identifikoni burime paraprake të kujdesit shëndetësor.
- Vërtetoni strukturat ekzistuese sociale, dhe dimensionet psiko – sociale të situatës.
- Vërtetoni anët e fuqishme dhe mbulimin e sistemit lokal publik shëndetësor në vendin e prejardhjes së njerëzve.

### **Statusi i të ushqyerit**

- Vërtetoni prevalencën e mosushqimit proteinor – energjik tek popullata më e re se 5 vjet.
- Kontrolloni statusin e mëparshëm të të ushqyerit të popullatës.
- Vërtetoni praksat klerarkike për shpërndarjen e ushqimit dhe ndikimi i tyre në statusin e të ushqyerit të grave dhe grupeve të ndrrshme sociale dhe të rriturve.

## **Shkalla e vdekshmërisë**

- Llogaritni shkallën e përgjithshme të vdekshmërisë.
- Llogaritni shkallën e vdekshmërisë tek fëmijët nën moshën 5 vjeçare.
- Llogaritni shkallën e vdekshmërisë sipas shkaqeve të cilat e kanë shkaktuar vdekjen.

## **Kushte në mjedisin jetësor**

- Vërtetoni gjendjet klimatike; identifikoni pasqyrimet gjeografike; bëni vlerësimin e qasjes në popullatën e goditur; bëni vlerësimin e nivelit të pasigurisë dhe dhunës.
- Bëni vlerësimin e rezervave lokale, rajonale dhe nacionale me ushqim (kuantitet, kualitet, lloje), sisteme distributive, koordinim dhe shërbime të organizatave ekzistuese, logjistikë të transportit të ushqimit dhe shpërndarjes, programe për të ushqyerit dhe qasje në burimet lokale të ushqimit.
- Bëni vlerësimin e strehimoreve ekzistuese dhe qasje në materiale lokale për strehim, qasje, tokë për ndërtimtari, topografi dhe sisteme për përçim, batanie, rroba, mjete për amvisëri, karburante, mallëra, të holla.
- Identifikoni dhe bëni vlerësimin e burimeve të ujit, kuantitet, kualitet, transport dhe shpërndarje. Bëni vlerësimin e kushteve sanitare.

## **Resurse të kapshme**

- Identifikoni dhe bëni vlerësimin e shërbimeve lokale shëndetësore: qasje në objekte, shëndet personal, përkthyes, ujë, frigoriferë, agregatë në objekte, medikamente dhe vaksina.

## **Logjistikë**

- Bëni vlerësimin e transportit, karburanteve, shpërndarjen e ushqimit, vaksina dhe furnizim, komunikim.





# PARIME THEMELORE TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

## HUMANITET

Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe lindi si rezultat i dëshirës për të ndihmuar të plagosurit në fushën e betejës dhe atë pa asnjë anshmërie, si dhe ta ndalojë dhe ta lehtësojë vuajtjen e njeriut gjithmonë kur ka mundësi. Qëllimi i lëvizjes është që ta mbrojtë jetën dhe shëndetin dhe ta respektojë njeriun. Promovon kuptim të përbashkët, shoqëri, bashkëpunim dhe paqe të përhershme mes të gjithë njerëzve.

## PAANSHMËRI

Nuk bën diskriminim në bazë nacionale, rasore, fetare dhe përkatësi klasore apo bindjes politike. Qëndron t'i lehtësojë vuajtjet e individëve, duke u nisur vetëm nga nevojat e tyre por, duke dhënë prioritet rasteve më emergjente.

## NEUTRALITET

Me qëllim që të kënaqë besimin e të gjithëve, Lëvizja nuk guxon të merr anë gjatë konflikteve apo të merr pjesë në situata kontraverse të natyrës politike, racore, fetare apo ideologjike.

## PAVARSI

Lëvizja është e pavarur. Shoqatat nacionale edhe pse veprojnë si plotësim i shërbimeve humanitare të qeverive dhe janë lëndë e rregullimit të legjislativës nacionale, patjetër ta ruajnë autonominë që të mund të veprojnë në çdo kohë, në pajtueshmëri me parimet e Lëvizjes.

## SHËRBIMI VULLNETAR

Është lëvizje për të dhënë ndihmë vullnetare e cila nuk është e inspiruar nga të mirat materiale.

## BASHKIM

Në një shtet mund të ketë vetëm një shoqatë nacionale të Kryqit të kuq apo Gjysmëhënës së kuqe. Patjetër të jetë e hapur për të gjithë dhe ta kryejë punën e vet humanitare në të gjithë territorin e vendit.

## UNIVERSALITET

Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, ku të gjitha shoqatat që e përbëjnë kanë status të njëjtë, përgjegjësi dhe obligime të njëjta që të ndihmohen në mënyrë reciproke, vepron në të gjithë botën.